

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 413 • PRILL 2025



INTERVISTË EKSKLUZIVE:

DR. HUSEIN EF. KAVAZOVIC
REIS I BI-SË TË BOSNYES DHE HERCEGOVINËS

FAMILJA – BËRTHAMË STABILITETI
E SHOQËRISË

ELEMENTET E RËNIES MORALE
NË DITËN E KAPTINËS HUMEZE

FEJA EDHE BRENDA
RRETHOJAVE TË HEKURTA

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë me rastin e festës së Fitër-Bajramit

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Të dashur qytetarë!

Vetëm edhe pak orë na ndajnë nga festimi i Fitër Bajramit, andaj kam kënaqësinë që sot, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal t'ju drejtohem me përgëzimet dhe urimet më të mira, me bindje dhe shpresë që Bajramin ta ndiejmë, ta presim e ta përjetojmë shpirtërisht me gëzime e përkushtim në ambientet tona të ngrohta familjare dhe shoqërore.

Që sonte kur kemi natën e Bajramit, besimtarët myslimanë hyjnë në atmosferën e festës së Fitër Bajramit, të gëzuar me plotë të drejtë se kanë kryer një ndër urdhrat e Zotit të Madhëruar, agjërimin e muajit Ramazan, ibadet ky që bëhet vetëm për Zotin e Gjithësisë.

Vëllezër dhe motra!

Ceremonia e Fitër Bajrami është moment që bashkon besimtarët në faljen e namazit të Bajramit, që shënon njëkohësisht momentin më të rëndësishëm të kësaj feste, për të vijuar më pas me urimet dhe përgëzimet më të mira e më të sinqerta, si dhe me përqaftimet e ngrohta si për asnjë moment tjetër me familjarët, fëmijët, farefisin, shoqërinë, e për të shijuar më pas aromën dhe nimetet e festës rreth sofrës së Bajramit me më të dashurit tanë.

Zoti i Madhërishtëm thotë: *“Ka shpëtuar ai që është pastruar, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!”* (El Aë'la, 15).

Kjo festë e bekuar, e cila në formën më të mirë përçon porosi dhe mesazhe për paqen, harmoninë, dashurinë, mirësinë dhe gëzimin për besimtarët, është një dhuratë prej Zotit për përkushtimin, devotshmërinë dhe adhurimin e shtuar gjatë muajit të bekuar Ramazan.

Për një muaj me radhë, agjërimi mbushi zemrat dhe shpirtat tanë me një ndjenjë të veçantë paqeje, qetësie, e pse jo edhe krenarie. Andaj festa e Fitër Bajramit është mundësi për të shprehur mirënjohjen dhe gëzimin për arritjen e pastrimit shpirtëror, që është shoqëruar me sakrificë, përkushtim dhe devocion.

Fitër Bajrami është festë përbashkuese për myslimanët në mbarë botën. Festë që simbolizon triumfin shpirtëror, moment gëzimi dhe reflektimi që shpreh faljen, mirësinë dhe bashkimin familjar e shoqëror.

Vlera këto që i japin kuptim të thellë social dhe shoqëror, e gjithësi edhe shpirtëror kësaj feste madhështore.

Fitër Bajrami sjell gëzim e hare në familjet tona, ngase është moment që e bashkon atë, ripërtërin lidhjet familjare dhe shoqërore, kultivon paqen, mirëkuptim, solidaritetin, dashurinë e respektin për tjetrin, si dhe kultivon vëllazërinë dhe harmoninë mes nesh.

Të dashur vëllezër dhe motra!



Gjatë festës së Fitër Bajramit zemrat bashkohen në miqësi, njerëzit bashkohen pas ndarjes duke u përkujdesur që gëzimi për festën e Bajramit të arrijë në çdo shtëpi, si dhe të shpërndahet bekimi i Zotit xh.sh., nëpër çdo familje.

Fëmijët kanë një peshë e kujdes të veçantë në festën e Fitër Bajrami, ngase kjo festë është një mundësi e shkëlqyer për t'iu mësuar atyre vlerat universale dhe porositë fisnike e hyjnore të Fitër Bajramit. Duhet kujdes i veçantë për fëmijët tanë që ta përjetojnë festën e Bajramit, t'i vizitojnë xhamitë me ne, t'i shijojnë dhuratat e veçanta, të marrin mesazhe uruese dhe të jenë pjesë e pritjeve dhe vizitave të familjet, miqësia dhe farefisi që realizohen për Bajram. Në këtë mënyrë fëmijët tanë shijojnë festën, mësojnë traditën tonë pozitive dhe ruajnë kujtime më të bukura nga fëmijëria për këtë festë.

Vëllezër dhe motra!

Festa e Fitër Bajrami të populli ynë në vazhdimësi ka pasur një rëndësi dhe vlerë të posaçme, është festë më popullore dhe më me ndikim në shoqërinë tonë. Si në të kaluarën, ashtu edhe tash, populli ynë e feston Bajramin me shumë gëzim dhe nderim, duke ruajtur traditat dhe duke theksuar vlerat e solidaritetit, respektit dhe mirësisë.

Duke pasur parasysh se namazi i Bajramit është një mundësi reale për të shprehur falënderimin për mundësinë që na e dhuroi Zoti për agjërimin e këtij muaji të bekuar, është momenti kyç për të kërkuar dhe reflektuar paqe dhe lumturi për veten, familjen dhe për besimtarët mbarë, ngase kjo është një formë e thellë e lidhjes shpirtërore me Zotin dhe një shenjë e besimit të vazhdueshëm në Zotin Një.

Urime festa e Fitër Bajramit për të gjithë besimtarët tanë kudo që ata gjenden!

Prishtinë, 29 mars 2025

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

- 2 Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë me rastin e festës së Fitër-Bajramit

EDITORIAL

- 4 Predikimi i Islamit në frymën e inferioritetit

FETARE

- 5 Familja – bërthamë stabiliteti e shoqërisë
Hytbeja e Myftiut për Fitër-Bajram
- 7 Si t'i ruajmë virtytet edhe pas Ramazanit
Mr. Muharrem Bryma
- 10 Çka pas Ramazanit?
Muhammed el Hamud en Nexhdi
- 13 Elementet e rënies morale në dritën e kaptinës Humeze
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 17 Dispozitat dhe rëndësia e xhumasë
Lavdrim Hamja
- 21 Dimensionet e xhihadit dhe abuzimet me të
Hfz. Mehas Alija

INTERVISTË

- 25 Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, boshnjakët dhe shqiptarët, u munduan t'i mbanin sa më larg njëri-tjetrit, mirëpo këtë mision nuk e arritën

FAMILJE & EDUKIM

- 29 Feja edhe brenda rrethojave të hekurta
Granit Sadiku



KULTURË

- 34 Poeti i madh islam me zemër shqiptare
Mr. Besnik Jaha
- 37 Hafëz Ibrahim Dalliu - përkthyes dhe komentues i Kuranit
Dr. Azmir Jusufi
- 40 Fillet dhe tradita e literaturës islame në gjuhën shqipe me shkronja arabe në Kosovë
Mr. Arbin Ahmet
- 42 Kontributi i Ibën Havkalit (? – 980) në zhvillimin e shkencës
Artan S. Mehmet

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 45 Një vështrim historik për vështërsitë e përkthimit të një teksti kuranor në gjuhët prendimore
Hajrudin S. Muja
- 51 Jeta e fakihut të njohur hanefi Imam Serahsiut (v. 483/1090)
Blerton Bahtir

AKTIVITETE

- 55 Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, shtroi iftar për Myftiun Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 413 • viti 38 • Prill 2025
• Sheval 1446
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



“Thuaj: Ai, Allahu është Një. Allahut i drejtohen (gjitha krijesat) për çdo gjë! (Ai) nuk ka lindur prej ndokujt, as nuk ka lindur askënd, dhe askush nuk i ngjason Atij!”.

(El Ihlas, 1-4)

Predikimi i Islamit në frymën e inferioritetit

Myslimanët bashkëkohorë, të gjendur në rrethana tëhuajuese dhe brenda konteksteve gjeografike e kohore, relativisht jokompatibile me mënyrën e jetesës islame, jo rrallëherë mbesin të stepur dhe e humbasin elanin për ta bërë predikimin e Islamit mirëfilli e nga e para. Edhe pse mund të duket një prejjudikim i nxituar, megjithatë vërehet qartë se një pjesë e madhe e predikuesve islamë bien në kurthin e prezantimit të Islamit, jo duke thënë atë se çfarë është në të vërtetë ai, por shterojnë provat për të treguar se çfarë nuk është ai. Në vetvete, ky koncept vuan nga një “sindromë” që i bënë myslimanët të mendojnë se feja e tyre tashmë është vendosur në gjykatore dhe mbi të rëndon barra e të pandehurit. Nuk i kemi të rralla predikimet tona që i fillojmë me sintagmat ‘Islami nuk është fe intolerante’; ‘Islami nuk e nxit ekstremizmin e as dhunën’; ‘Islami nuk shtyp të drejtat e gruas’ e të ngjashme. Asnjëra nga këto slogane nuk shpërfaqin imazhin e bukur të Islamit, dhe në fakt e rrëfejnë të vërtetën rreth tij, veçse që të gjitha shpërfaqin versionin inferior të predikimit të tij. Ky version është narracioni i njerëzve që vuajnë nga kompleksi i inferioritetit. I atyre që kanë filluar të ndihen keq pse i përkasin kësaj feje, dhe që ushqejnë në shpirt ndjenjën e fajësisë, që në rrethana komplekse është vënë në shënjestër të sulmeve të sinkronizuara kundër tij.

Kemi të bëjmë me një mungesë ose thënë më saktë një përmbysje të predikimit reprezentativ të Islamit, dhe atë në favor të versionit që më tepër ka karakter revanshues ndaj kundërshtarëve të tij sesa promovues e afirmues të vlerave ta patundura të tij. Është predikim i dalë nga një frymë e tensionuar, andaj si i tillë s’mund të jetë i ekuilibruar. Rëndom ai del edhe si një ngushëllim i gabuar nga të gjithë ata predikues që bartin mbi supet e veta mëkatën e inferioritetit.

Po të analizonim pak më thellë, kaptinën El Ihlas - si kaptina që në formën më të thuktë e bëri të kristaltë besimin monoteist islam, vërejmë se përgjigjja në dilemën e atyre që pyetën të Dërguarin tonë – Muhamedin a.s., se kush është Zoti i Vërtetë, vije duke u thënë: “Thuaj: Ai, Allahu është Një. Allahut i drejtohen (gjitha krijesat) për çdo gjë! (Ai) nuk ka lindur prej ndokujt, as nuk ka lindur askënd, dhe askush nuk i ngjason Atij!”. Dy ajetet hyrëse, nga katra gjithsejtë sa ka kjo kaptinë përvijuese e monoteizmit islam, bëjnë përshkrimin afirmativ se kush është Zoti i Vërtetë, e tek dy të fundit më pastaj rrëfejnë çfarë nuk është dhe çfarë nuk i përket Madhërisë së Tij, pra përvijojnë negacionin e monoteizmit islam. Pos qartësisë e elokuencës së kësaj kaptine, madhështore në të është edhe forma e narracionit mbresëlënës të saj.

Edhe sqarimet më thelbësore të të Dërguarit a.s. që iu bëri koncepteve më bazike të kësaj feje, pra të islamit, imanit e ihsanit, kur ai i sqaroi para Xhibrilit a.s. dhe sahabëve prezentë - Zoti pastë qenë i kënaqur me ta, vërejmë po të njëjtën metodologji të kristaltë afirmative e promovuese, pa rrokur fare për goje negacionin e tyre. Ai tha për imanin-besimin se është: të besosh Allahun, engjëjt, librat, pejgamberët, ditën e takimin me Të, ringjalljen (në transmetimin tjetër edhe në përcaktimin-kadanë dhe kaderin). Ndërsa për Islamin tha se ai është: dëshmia e shehadetit, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në haxh. Pastaj tha për ihsanin se ai është: ta adhurosh Allahun sikur e sheh ti Atë, ngase edhe nëse nuk e sheh ti Atë, Ai të sheh ty”. (Shih: El Buhari, 4777, e koleksionues të tjerë).

Shikuar në sensin e kësaj trajtese, secila prej këtyre termëve e koncepteve parimore të fesë sonë, i ka edhe negacionet e veta, anën e kundërt nga të cilat duhet kujdesur secili besimtar që të mos bie në to, por i Dërguari ynë - paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, nuk shkoqiti fare asnjërin prej tyre. S’ishte rastësi e as nuk qe e pa synuar kjo. Ai para së gjithash ishte i ngarkuar me mision afirmues e reprezentues të koncepteve themelore të kësaj feje, ngase të kundërtat e tyre, rëndom do të kuptohen pastaj apriori nga secili mendjeshëndoshë. Një predikim i tillë, nuk bën të braktiset as nga ne sot, e sigurisht që duhet ta kuptojmë se ai bartë në vete edhe vullën profetike.

Mr. Driton Arifi

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Fitër Bajramit

Familja – bërthamë stabiliteti e shoqërisë

Të nderuar vëllezër dhe motra!

Festa e Fitër Bajramit, të cilën po e përjetojmë sot, është një nga festat më të rëndësishme për besimtarët myslimanë, e cila vjen pas përfundimit të agjërimit të muajit të bekuar Ramazan. Kjo festë ka një peshë të thellë fetare, shpirtërore dhe sociale, pra është një shpërblim prej Zotit, andaj me të drejtë, këtë moment të veçantë e konsiderojmë moment reflektimi, falënderimi dhe lutjeje, ditë me një domethënie të thellë shpirtërore dhe sociale, duke na rikujtuar rëndësinë e devotshmërisë, mirënjohjes, solidaritetit dhe bashkimit familjar.

Rendi përbrenda familjes, gjithherë sipas normave islame, bazohet në parimet e drejtësisë, dashurisë, përgjegjësisë dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet anëtarëve të familjes. Kjo për faktin se familja është bërthama mbi të cilën ndërtohet jeta jonë, është ajo e cila na ofron dashuri, mbështetje dhe vlera që na shoqërojnë gjatë tërë jetës, duke na mundësuar që të përballemi me sfidat e jetës të çfarëdo natyre qofshin ato.

Normat të cilat burojnë nga Kurani dhe hadithet e Muhamedit a.s., saktësojnë se një qift bashkëshortor – burri dhe gruaja, janë themel i familjes. Po ashtu, prindërit janë edhe edukatorët e parë të fëmijëve, duke i pajisur ata me edukatë dhe moral të lartë, me qëllim që të kemi familje dhe shoqëri të formuar mirë, në rrugën e Zotit dhe në shërbim të familjes, rrethit dhe shoqërisë. Sipas Islamit, fëmijët janë një amanet nga Zoti, e që ne si prindër, e kemi për obligim të kujdesemi, t'i ruajmë, t'i edukojmë, t'i shkollojmë e t'i formojmë si qenie fisnike, duke ua mbjellë në zemrat e tyre dashurinë për njëri-tjetrin, familjen, atdheun dhe shoqërinë.

Zoti xh.sh. në Kuran thotë:

“Ruani veten dhe familjen tuaj nga zjarri” (Et Tahrim, 6).

Përveç kësaj, edhe prindërit janë amanet i fëmijëve, në veçanti atëherë kur ata kanë arritur moshën e pleqërisë, apo kanë kërkesën më të madhe për përkujdesje dhe ndihmë nga ana e fëmijëve të tyre.



Islami urdhëron për ruajtjen e lidhjeve familjare dhe farefisnore, urdhëron për përkujdesje të vazhdueshme dhe të drejtë ndaj prindërve, sidomos kur ata janë në moshë të shtyrë.

Lënia e prindërve pa përkujdesje nga ana e fëmijëve të tyre, sipas fesë sonë është një gjynah i madh, ngase menjëherë pas adhurimit që duhet bërë Zotit xh.sh., jemi të urdhëruar për përkujdesje ndaj prindërve me dashuri dhe respekt. Përkujdesja ndaj prindërve është një rrugë e drejtë, e cila na afron drejt mëshirës së Allahut xh.sh.

Zoti xh.sh. në Kuran thotë: *“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!” , mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.”* (El Isra, 23).

Si është e mundur t'i kthehet shpina e të mos përkujdesemi për nënën, e cila na mbajti me mund dhe vështirësi të mëdha në barkun e saj, e cila na ushqeu me gjirin e saj, u përkujdes për ne që të bëhemi këmbë e duar. Si të mos përkujdesemi për babanë, i cili na mbrojti dhe na e siguroi ekzistencën. Nga



kjo mësojmë se jemi të obliguar që të sigurojmë mirëqenien dhe rehatinë e prindërve duke mos iu munguar asgjë atyre.

Është obligim që të sillemi mirë ndaj prindërve, nënës dhe babait, ngase në Islam, nuk ka koncept “Prindi 1” dhe “Prindi 2” të së njëjtës gjini, e as nënë të marrë me “qira – apo nënë surrogate”.

Pra Islami është kundër modeleve të familjes që devijojnë nga struktura tradicionale dhe parimet islame të burrit dhe gruas. Kjo bazohet në mësimet e qarta të Kuranit dhe Hadithit. Në Islam, koncepti i prindërve është i qartë: Prindërit janë një burrë dhe një grua, babai dhe nëna.

Ndaj nënës dhe babait jemi të urdhëruar për përkujdesje edhe pas vdekjes së tyre, të bëjmë dua – lutje për ta, të japim sadaka – lëmoshë, e t’u ndihmojmë njerëzit në nevojë për shpirtat e tyre.

Zoti xh.sh. në Kuran thotë: *“Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur-edukuar, kur unë isha i vogël!”* (El Isra, 24).

Përkujdesja ndaj prindërve, gjyshërve dhe familjes mbarë, siç po shihet është edhe një mundësi për ta fituar kënaqësinë e Allahut xh.sh. dhe shpërblimet e mëdha prej Tij. A thua se mund të gjendet ndonjë thënie e përafërt me thënien e Muhamedit a.s., se: “Xheneti është nën këmbët e nënës.”

Muhamedi a.s. shumë herë na porositi për përkujdesje, ndihmë dhe mirësjellje ndaj familjes dhe prindërve. Ai me një rast tha: “Më i miri prej jush është ai që është më i miri ndaj familjes së tij, dhe unë jam më i miri ndaj familjes.” (Tirmidhiu).

Fatkeqësisht, sot, pothuajse për çdo ditë kemi shumë prindër të braktisur, të lënë e të harruar nga fëmijët dhe të afërmit e tyre. Ata kanë ngelur pa përkujdesje, gjë e cila po e rëndon jetën e tyre deri në ekstrem. Pse po ndodh kjo? Këtë pyetje duhet bërë vetes dhe shoqërisë sonë këtu në Kosovë dhe kudo që jetojnë vëllezërit dhe motrat tona brenda trojeve tona etnike dhe në mërgatën e largët.

Nuk konsiderohet dhunë vetëm dhuna fizike ndaj prindërve. Mospërkujdesja është një formë dhune ndaj tyre. Ajo mund të jetë edhe dhunë emocionale, psikologjike, ekonomike dhe shpirtërore, duke i lënë ata të vetmuar dhe në kushte të vështira të jetesës e në mungesë respekti ndaj tyre. Andaj, edhe abuzimi me prindër konsiderohet një prej mëkateve të mëdha në Islam dhe në shumicën e feve të tjera. Duke veçuar se sjellja dhe përkujdesja e vazhdueshme ndaj prindërve dhe familjes është një urdhër dhe obligim hyjnor, edhe ndëshkimi ndaj atyre që e lënë familjen, e në veçanti i lënë prindërit pa përkujdesje, do të jetë i rëndë para Zotit xh.sh..

Për të bërë përpjekjet e kthimit dhe përkujdesjen ndaj familjes dhe prindërve, duhet t’u kthehemi vlerave fetare, ta përhapim moralin, ta rikthejmë harmoninë brenda familjes, ta rikthejmë paqen në veten tonë, mëshirën dhe edukimin e shpirtit.

Familja pra është një mburojë e fortë, sepse ajo mbron anëtarët e saj brenda kështjellës së pathyeshme të saj, e gjithashtu vendos edhe burimin e ekzistencës, formimin dhe edukimin e mirëfilltë. Askush nuk ka të drejtë ta braktisë familjen dhe të shkëput marrëdhëniet me familjen dhe farefisën.

Nëse familja është e shëndoshë, e gjithë shoqëria është e shëndoshë, ngase familja është një shtyllë dhe bazë e strukturës sociale për shkak të lidhjeve të saj shpirtërore, fetare, psikologjike e materiale, veçanërisht nëse është një familje kohezive, e cila siguron një atmosferë qëndrueshmërie.

Mund të themi se vlera e besimit është vlera kryesore dhe qendrore në këto vlera familjare, rreth së cilave rrotullohen vlerat e tjera islame, si vlera e ndershmërisë, e drejtësisë, konsultimit, durimit, dashamirësisë, dëlirësisë, bashkëpunimit, solidaritetit, dhe së fundi vlera e dashurisë dhe mëshirës.

Prishtinë, Naim ef. Tërnavë

Myftiu i Kosovës,

30 mars 2025

Si t'i ruajmë virtytet edhe pas Ramazanit

• **Mr. Muharrem Bryma**

Janë shumë motive që më bënë të shkruaj këtë temë të cilën e konsideroj shumë të rëndësishme, e ndër to, do i veçoja dy prej tyre. E para, kuptohet se njeriu është një krijesë që në natyrshmërinë e tij të pastër kërkon gjithmonë avancim dhe përparim, dhe e dyta, Ramazani konsiderohet burim i rëndësishëm i ndryshimit të njeriut nga një gjendje, cilado qoftë ajo, në një gjendje më të mirë, si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në atë fizik e mendor.

Instinkti i avancimit dhe zhvillimit, i vendosur nga Allahu xh.sh. në qenien njeri, ka qenë element kyç për mbijetesën, përparimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njeriut që nga krijimi i njeriut të parë Ademit a.s.. Krahës këtë instinkti, Krijuesi e ndihmoi

krijesën njeri edhe me njohuri elementare dhe orientuese për një avancim solid, triumfues dhe të lakmueshëm që tërheq dhe fiton dhuntinë më madhështore, e ajo është kënaqësia e Allahut xh.sh.. Pra i zbriti shpalljen apo njohuritë, mësimet bazike të jetës së dinjitetshme, avancimit dhe zhvillimit. Allahu xh.sh. thotë: *“Ti nuk ke ditur çka është Libri (Kurani), e as ç’është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve Tanë...”* (Esh Shura, 52). Gjithashtu Allahu kërkoi nga njeriu të veprojë dhe ta praktikojë atë që zbriti duke i thënë: *“Dhe thuaj: “Veproni! Allahu do ta shohë veprën tuaj, e edhe i Dërguari i Tij dhe besimtarët, e më vonë do të ktheheni te Njohësi*

Është e vërtetë se devotshmëria konsiderohet njëra nga objektivat kryesore të agjërimit dhe jo vetëm, mirëpo ajo duhet të jetë objektivë jona gjatë tërë jetës.



i të fshehtës dhe i të dukshmes, e do t'ju njoftojë për atë që vepruat.” (Tevbe, 105).

Gjithsesi këto dy elemente, dija dhe veprimi, janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën për të dhënë rezultat pozitiv, dhe për të ndihmuar njeriun të arrijë synimet e tij, qofshin ato avancim personal, profesional apo shpirtëror. Pa dije, veprimi mund të jetë i dëmshëm, dhe pa veprim, dija nuk jep rezultatin e pritur.

Muaji i bekuar Ramazan në formën më të mirë promovon dijen dhe veprimin brenda personalitetit të besimtarit. Dispozitat detajuese të agjërimit dhe adhurimeve të tjera brenda muajit Ramazan, gjithashtu inkurajimi për veprim dhe angazhim maksimal gjatë këtij muaji ka bërë që besimtari të arrijë një balancë midis dijes dhe veprimit, duke arritur rezultate të pamohueshme. Në bazë të kësaj është bërë rifreskimi i formimit individual të besimtarit, rritja e mundësive për sukses të vazhdueshëm dhe integritet, përmirësimi i përditshmërisë ndoshta monotone, vetëdisiplina dhe vetëkontrolli, perceptim i drejtë i përgjegjësisë, shmangia e gabimeve e shumë mirësi dhe margaritarë të tjerë.

Muaji Ramazan kaloi ndërsa besimtarët gjithandej kanë dy preokupime kryesore, e para; A u angazhova me tërë qenien time në këtë muaj, a e shfrytëzova ashtu si kërkohet? Ndërsa preokupimi i dytë; Si t'i ruajmë dhe t'i

Gjithsesi duhet të vazhdojmë të jemi falënderues e mirënjohës për të Gjithëpushtetshmin, Allahun, për çdo dhunti e mirësi që kemi prej Tij, duke e ditur qartë se numërimi i mirësive që kemi nga Ai është i pamundur.

kultivojmë virtytet pas Ramazanit, e assesi të mos i anashkalojmë që të zhduken nga personaliteti ynë?

Gjatë muajit Ramazan shumë virtyte dhe parime u kultivuan dhe u fituan nga besimtarët. Gjithsesi besimtari duhet të fokusohet në ruajtjen dhe mishërimin e tyre në personalitetin e tij përgjithmonë. E nga këto virtyte që duhet të fokusohemi në ruajtjen e tyre patjetër do të veçoja:

Devotshmërinë, kjo cilësi e lartë shpirtërore të jetë gjithmonë synim yni. Është e vërtetë se devotshmëria konsiderohet njëra nga objektivat kryesore të agjërimit dhe jo vetëm, mirëpo ajo duhet të jetë objektivi jona gjatë tërë jetës. Muhamedi a.s., ka thënë: “Kudo që të jesh, ji i devotshëm- i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ke ndaj Allahut...”¹ (Tirmidhiu, 2102). Nëse posedojmë këtë virtyt, veçse i kemi hapur mirësi të shumta personalitetit tonë, mirësi të cilat vetëm Allahu Fuqplotë ia dhuron të devotshmëve. Allahu thotë: “...e kush u përmbahet dispozitave të Allahut (tregon devotshmëri), atij Ai i hap rrugë dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare...” (Talak, 2-3). Gjithashtu ka thënë: “...e kush i frikësohet Allahut (tregon devotshmëri), Ai atij ia lehtëson punën...” (Talak, 4). E për ta ruajtur këtë virtyt, ne duhet të vazhdojmë me përkushtim ndaj udhëzimit



Ramazani, ky muaj i shenjtë dhe i bekuar, i stërm bushur me mirësi dhe mundësi të tjera krahas këtyre të përmendurave më lartë, na ka vendos në një nivel tjetër të ndjeshmërisë dhe përjetimit të bekimeve, shpërblimeve dhe shpresës në pastrimin e plotë nga mëkatet tona eventuale.

të Allahut, duhet të vazhdojmë me ndërgjegjësim të thellë dhe qëndrim stoik të drejtuar nga frika dhe dashuria ndaj Tij.

Të jemi falënderues – besimtari duhet doemos të cilësohet më këtë cilësi gjatë tërë jetës së tij. E vërteta është se edhe kjo cilësi konsiderohet nga objektivat e agjërimit, e cila qartë është përshkruar në ajetet e agjërimit, ku Allahu thotë: “...që të bëheni falënderues...” (El Bekare, 185). Gjithsesi duhet të vazhdojmë të jemi falënderues e mirënjohës për të Gjithëpushtetshmin, Allahun, për çdo dhunti e mirësi që kemi prej Tij, duke e ditur qartë se numërimi i mirësive që kemi nga Ai është i pamundur. Allahu thotë: “...edhe në qoftë se përpigëni t'i numëroni të mirat e Allahut, nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër) ato...” (Ibrahim, 34). Duhet të vazhdojmë të jemi falënderues e mirënjohës për të gjithë kontribuuesit që sakrifkuan për të mirën e njerëzimit. Duhet të jemi falënderues e mirënjohës për prindërit, mësuesit, intelektualët, e shumë të tjerë që kishim hair prej tyre. Nëse e ruajmë këtë virtut që e përforcojmë gjatë Ramazanit dhe e vazhdojmë edhe pas tij, do të shtohen mirësitë tona, ngase Allahu na ka dhënë këtë ofertë që assesi nuk duhet të shmanget, e ajo është: “...nëse falënderoni, do t'ua shtoj të mirat...” (Ibrahim, 7).

Vizion i qartë – të kemi largpamësi për veprimtarinë tonë, orientimi i duhur për rrugëtimin tonë ka qenë objektivë tjetër e agjërimit. Allahu në ajetet e agjërimit thotë: “...për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen dhe le të më besojnë Mua.” (El Bekare, 186). Përkufizimi i drejtë i qëllimit të jetës dhe udhëzimeve të Allahut dhe përkushtimi i vazhdueshëm në rrugën e drejtë, në rrugën të cilën Allahu është i kënaqur duhet të jetë preokupim yni edhe pas Ramazanit. Në këtë formë do ta ruajmë këtë virtut të fituar gjatë Ramazanit, i cili do të na shërben gjatë tërë jetës.

Durimi është tjetër virtut që kultivuar dhe përsosëm gjatë muajit Ramazan. Ai konsiderohet njëri nga virtutet të cilit Kurani fisnik i kushton kujdes të veçantë. Durimi është karakteristikë njerëzore. Ai është domosdoshmëri dhe nevojë e kësaj bote. Sa më shumë të mishërohem me këtë virtut, aq më të suksesshëm do të jemi. Nuk mund të realizojmë dëshirat dhe synimet tona e as puna nuk mund të jetë e frytshme, përveçse

me durim.² Agjërimi, namazi, syfyri, iftari e shumë adhurime të tjera, duke përfshirë edhe punën dhe angazhimin ditor, të gjitha këto na ndihmuan të cilësohemi me këtë virtut dhe të kalitemi në të. Shpërblimi i durimtarit është madhështor, i vërtetuar me shumë ajete kuranore, e ne kujtojmë fjalën e Allahut: “...dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me Xhenet dhe me petka mëndafshi.” (El Insan, 12). Andaj nga ne kërkohet në vazhdimësi të kultivojmë këtë virtut dhe të mishërohem me të çdoherë e më shumë. Ajo çka na ndihmon në këtë aspekt, është përshkruar shkurt dhe qartë nga dijetari bashkëkohor i ndjeri Jusuf Kardavi ku thotë: “Shpresa është ndihma më e madhe e durimit, ndërsa dëshpërimi pengesa më e madhe e tij.”³

Ramazani, ky muaj i shenjtë dhe i bekuar, i stërm bushur me mirësi dhe mundësi të tjera krahas këtyre të përmendurave më lartë, na ka vendos në një nivel tjetër të ndjeshmërisë dhe përjetimit të bekimeve, shpërblimeve dhe shpresës në pastrimin e plotë nga mëkatet tona eventuale. Gjithsesi se mëshira, falja, përforcimi i lidhjes me Krijuesin, përmirësimi i zemrave dhe moralit tonë, largimi nga mëkatet dhe epshet e dëmshme, disiplina, solidariteti, bashkëpunimi, kultivimi dhe forcimi i lidhjeve familjare, pastrimi i shpirtit e shumë mirësi të përjetuara e gëzime të paharruara kanë ndikuar në personalitetin tonë duke na lënë mbresa të shkëlqyeshme, prandaj pa hezitim angazhohemi ta ruajmë këtë harmoni shpirtërore që përjetuam.

Në përmbyllje, themi se natyrshmëria jonë e pastër kërkon avancim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Ramazani rast ideal për përmirësim të karakterit dhe formim të drejtë të personalitetit tonë. E shfrytëzuam me synim që të rrisim kapacitetin e virtyteve të mira dhe të privojmë veset e liga. Andaj të vazhdojmë me dituri dhe veprim të matur e të bazuar në udhëzimet e Krijuesit! Kjo do na ndihmojë t'i kultivojmë ato mirësi që posedojmë dhe të fitojmë edhe nga ato mirësi që nuk i posedojmë.

1 Tirmidhiu, Ebu Isa Muhamed et Tirmidhi, *El Xhamiu el Kebir - Sunen Tirmidhi*, (Damask, Dar Risala Alemije, 2009), IV/93.

2 Kardavi, Jusuf, Durimi në Kuranin fisnik, (Prishtinë, Shoqata Bamirëse e Katarit, 2002), 5-12.

3 Kardavi, Jusuf, Durimi në Kuranin fisnik, (Prishtinë, Shoqata Bamirëse e Katarit, 2002), 133.

Çka pas Ramazanit?

• **Muhamed el Hamud en Nexhdi**

Edhe pse Ramazani është muaji i Kuranit në të cilin ai është shpallur, dhe myslimanët e shtojnë leximin dhe dëgjimin e tij në ditët dhe netët e tij, besimtari nuk e braktis Librin e Allahut të Lartësuar në kohë të tjera përveç Ramazanit, por ai është Libri i tij i parë, të cilin e lexon natë e ditë, fshehtazi dhe haptazi, në udhëtim dhe në vendbanim, dhe nuk ndahet kurrë prej tij.

Edhe pse muaji i bekuar Ramazan ka përfunduar, puna e myslimanit nuk përfundon përveçse me ndarjen e shpirtit të tij nga trupi i tij. Allahu i Madhërishëm i ka thënë Pejgamberit të Tij a.s.: *“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”* (El Hixhr, 99); dhe i Madhëruari për Isain a.s., ka thënë: *“... Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë.”* (Merjem, 31).

Është përmendur për disa njerëz nga myslimanët e parë, të cilët përpiqeshin në Ramazan, por pastaj, pas tij, e linin atë, kështu që është thënë: Sa njerëz të këqij janë ata që nuk e njohin Allahun e Lartësuar, përveçse në Ramazan!

Nëse agjërimit të detyrueshëm në Ramazan i ka përfunduar koha e tij, Allahu i Madhërishëm për ata që garojnë në të

mira, ka përcaktuar ditë që agjërohen gjatë gjithë vitit, e para prej tyre është agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit. Në *Sahihun* e Muslimit, transmetohet nga hadithi i Ebu Ejub el Ensariut r.a., thuhet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush agjëron Ramazanin, pastaj e pason atë me gjashtë ditë nga Shevali, është si agjërimi i gjithë kohës.”

Agjërimi i të hënave dhe të enjteve, siç qëndron në hadithin e Ebu Hurejres r.a., i cili ka thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut a.s.: “Paraqiten veprat ditën e hënë dhe të enjte, dhe më pëlqen që të paraqitet vepra ime duke qenë unë agjërueshëm.” (Transmeton Tirmidhiu).

Ose agjërimi i tri ditëve nga çdo muaj, dhe më parësore dhe më e mira është që të jenë ditët e bardha, të cilat janë: e trembëdhjeta,



e katërmbëdhjeta dhe e pesëmbëdhjeta e muajit hixhri, sipas hadithit të Ebu Dherrit, i cili ka thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut a.s.: “O Ebu Dherr, nëse agjëron nga tri ditë në muaj, atëherë agjëro të trembëdhjetën, të katërmbëdhjetën dhe të pesëmbëdhjetën.” (Transmetojnë Tirmidhiu dhe Nesaiu).

Ose agjëron nga tri ditë nga çdo muaj, sipas hadithit të Ebu Hurejres, i cili ka thënë: “Më ka porositur i dashuri im a.s. me tri gjëra... dhe të agjëroj tri ditë nga çdo muaj.”

Agjërimi i muajit të shenjtë të Allahut. Në *Sahihun* e Muslimit, transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., se Pejgamberi a.s., u pyet: “Cili agjërim është më i miri pas muajit Ramazan?” Dhe ai u përgjigj: “Agjërimi më i mirë pas muajit Ramazan është agjërimi i muajit të shenjtë Muharrem.”

Agjërimi i Ditës së Arafatit, i cili i shlyen mëkatet e dy viteve: një vit të kaluar dhe një vit të ardhshëm, siç është transmetuar në *Sahihun* e Muslimit.

Agjërimi i Ditës së Ashurës, i cili i shlyen mëkatet e një viti të kaluar, si dhe adhurimet e tjera vullnetare.

Edhe kur të ketë përfunduar namazi i natës (teravitë) në Ramazan, namazi i natës është gjithmonë praktikë e njerëzve të mirë dhe të zgjedhur, siç ka thënë Pejgamberi a.s.: “Ju porosis që ta falni namazin e natës, sepse ai ishte praktikë e njerëzve të mirë para jush, ju afron me Allahun e Madhërishëm, ju ndalon nga mëkatet, jua shlyen të këqijat dhe jua largon sëmundjet nga trupi.” (Hadithin e transmetojnë Ahmedi, Tirmidhiu dhe Hakimi nga Bilali r.a.).

Fjala e Allahut të Plotfuqishëm: “Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.” (Es Sexhde, 16); “Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” - dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë.” (El Furkan, 63-64); “Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).” (Edh Dharijat, 17-18). Këto ajete nuk janë specifike për Ramazanin, por janë një nga karakteristikat dhe cilësitë e besimtarëve të devotshëm.

*“Pesë
namazet
ditore,
xhumaja deri
në tjetrën dhe
Ramazani
deri në tjetrin,
janë shlyese
për mëkatet që
ndodhin mes
tyre, nëse
shmangen
mëkatet e
mëdha.”*

(Muhamedi, a.s.)

Kur Abdullah bin Omeri u përmend para Pejgamberit a.s., ai tha: “Sa njeri i mirë është Abdullahu, sikur të ngrihej e të falej natën.” Pas kësaj, Abdullahu nuk flinte shumë natën. (Transmeton Buhariu). Dhe tha: “Mos u bëj si filani! Ai ngrihej dhe falej natën, por e la.”

Kjo tregon se lënia e ngritjes për namaz në një pjesë të natës është një mangësi në besimin dhe veprën e njeriut. Falja e namazit të natës realizohet edhe me dy rekate pas jacisë, pastaj me një rekat vitër, kurse më e mira është pas gjysmës së natës ose në të tretën e fundit të saj.

Abdullah bin Selami r.a., ka thënë: “Me të vërtetë, Pejgamberi a.s., ka thënë: “O njerëz, përhapni selamin, ushqeni të varfrit, faluni natën gjersa të tjerët flenë, do të hyni në Xhenet me paqe.” (Transmeton Tirmidhiu).

“Pejgamberi ynë a.s., falte aq namaz natën, sa iu ënjtën këmbët.” (Transmeton Buhariu).

Edhe pse Ramazani është muaji i Kuranit në të cilin ai është shpallur, dhe myslimanët e shtojnë leximin dhe dëgjimin e tij në ditët dhe netët e tij, besimtari nuk e braktis Librin e Allahut të Lartësuar në kohë të tjera përveç Ramazanit, por ai është Libri i tij i parë, të cilin e lexon natë e ditë, fshehtazi dhe haptazi, në udhëtim dhe në vendbanim, dhe nuk ndahet kurrë prej tij. Allahu i Plotfuqishëm thotë: “Atyre që ua kemi dhënë Librin dhe e lexojnë ashtu siç është shpallur, ata besojnë vërtet në të...” (El Bekare, 121). Gjithashtu Allahu i Plotfuqishëm thotë: “Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që iu kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë.” (Fatir, 29).

Allahu i Madhërishëm e lavdëroi një grup të ithtarëve të Librit duke thënë: “... Disa nga ithtarët e Librit janë në të drejtën: në orët e natës lexojnë ajetet e Librit të Allahut dhe falin namaz.” (Ali Imran, 113).

Pejgamberi a.s. ka rekomanduar që ne ta ruajmë këndimin dhe mësimin përmendsh të tij, duke thënë: “Këndojeni vazhdimisht Kuranin duke e përsëritur, pasi, për Atë, në Dorë të të Cilit është jeta ime, Kurani largohet (harrohet) më shpejt seç ikin devetë kur zgjidhen nga litarët.” (Muttefekun alejhi).



PHOTO BY: NUJOUID, OTAIBI

Edhe nëse Ramazani është muaji i zekatit për shumicën e myslimanëve, shpenzimi i bamirësve nuk mbaron dhe nuk përfundon, por është i vazhdueshëm dhe i përhershëm, siç ka thënë Allahu i Madhërishëm: *“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”* (El Bekare, 274).

Dhe ka thënë: *“...e që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre - për lypsin dhe për nevojtarin.”* (El Me'arixh, 24-25).

Kjo tregon vazhdimësinë e shpenzimeve të tyre në çdo kohë dhe moment, dhe nuk është specifike për një kohë të caktuar. Sepse nevojat e të varfërve dhe të nevojtarëve janë të vazhdueshme, kështu që myslimani nuk duhet t'i neglizhojë ata gjatë pjesës tjetër të vitit.

Pejgamberi a.s. ishte më bujari në Ramazan, por ishte gjithmonë më bujari i njerëzve, madje siç e përshkruan shokët e tij, ai kur i është kërkuar diçka kurrë nuk ka thënë “Jo!”

Bujaria e tij ishte me të gjitha llojet e bujarisë, me para, me dije, me trup dhe me prestigj.

Edhe nëse muaji i Ramazanit është muaji i ushqimit për të varfrit, të afërmit dhe fqinjët, kjo duhet të vazhdojë, siç i ka thënë Pejgamberi a.s., Ebu Dherrit r.a.: *“O Ebu Dherr, nëse ndonjëri prej jush gatuan një tenxhere (ushqim), le ta shtojë lëngun e saj, pastaj le t'i japë fqinjit të tij prej saj.”* (Transmeton Taberaniu në *Es Sagir*).

Myslimani i vërtetë është ai që ka frikë nga mospranimi i veprave të tij. Allahu i Madhërishëm thotë: *“... Allahu pranon vetëm prej të devotshmit.”* (El Maide, 27).

Myslimanët e parë ishin të zellshëm në plotësimin, përfundimin dhe përsosjen e veprës, pastaj shqetësoheshin për pranimin e tyre. Këta janë ata për të cilët Allahu i Plotfuqishëm thotë: *“... kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë...”* (El Mu'minin, 60).

Kjo vjen nga kujdesi i tyre që vepra të mos ketë mashttrim, sikur kur është për diçë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, ose të mos ketë ndonjë defekt apo mangësi që e prish atë. Transmetohet nga Aliu r.a., se ai në natën e fundit të muajit Ramazan thërriste: *“Ah, sikur ta dija se kush është ai të cilit i është pranuar që ta urojmë? Dhe kush është të cilit i është refuzuar që ta ngushëllojmë?”*

Duhet ditur se shlyerja e mëkateve në Ramazan është e kushtëzuar me largimin nga mëkatet e mëdha, ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut a.s.: *“Pesë namazet ditore, xhumaja deri në tjetrën dhe Ramazani deri në tjetrin, janë shlyese për mëkatet që ndodhin mes tyre, nëse shmangen mëkatet e mëdha.”* (Transmeton Muslimi)

O Allah, të kërkojmë vazhdimësi në bërjen e veprave të mira, në largimin nga të këqijat, në dashurinë për të varfrit! O Allah, kërkojmë që të na falësh, të na mëshirosh dhe të na e pranosh pendimin tonë! E nëse dëshiron t'i sprovosh robërit Tu, na merr pranë Teje pa u futur në sprovë! O Ti që i dëgjon lutjet!

Përktheunga gjuha arabe: Miftar Ajdini
Burimi: <https://islamonline.net/> / ماذا بعد رمضان

Elementet e rënies morale në dritën e kaptinës Humeze

• Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Kurani përmban një sistem të veçantë moralit që është i orientuar rreth besimit (imanit). Ai i kushton një rëndësi të madhe atij, duke e konsideruar si një pjesë të pandashme të fesë dhe për të ka sjellë parime teorike dhe rregulla praktike që formojnë një sistem të plotë moral brenda sistematikës dhe rregullave të tij të veçanta. Megjithatë, pasi çështjet morale janë të shpërndara në të gjithë Kuranin, ndonjëherë mund të studiohen akte morale duke u bazuar në ato që trajtohen në një kaptinë të caktuar. Nisur nga kjo, nëse bazohemi në kaptinën Humeze, shohim që

aty trajtohen lloje të ndryshme të sjelljeve të liga dhe shkatërrimit moral, si dhe shkaqet e tyre. E përbërë nga nëntë ajete, kaptina Humeze është një nga kaptinat e shkurtra të Kuranit, e cila adreson tema të moralit dhe etikës, duke vënë theksin te pasojat negative të përgojimit, shpifjes dhe arrogancës. Kjo kaptinë e përshkruan dënimin e atyre që përhapin fjalë të liga dhe përqeshin të tjerët, duke nxjerrë në pah dëmin që sjell kjo në shoqëri dhe në jetën e individit. Humeze nënvizon se ndjekja e këtyre veprimeve të dëmshme dhe të mangëta nga morali sjell vetëm dënim dhe shkatërrim, si në këtë

Kaptina Humeze është një nga kaptinat e shkurtra të Kuranit, e cila adreson tema të moralit dhe etikës, duke vënë theksin te pasojat negative të përgojimit, shpifjes dhe arrogancës.



botë, ashtu edhe në botën tjetër. Kjo kaptinë ofron mësim të fuqishme mbi rëndësinë e respektit për nderin e të tjerëve dhe mbi parimet e moralit dhe etikës që duhen ndjekur për të arritur një jetë të drejtë dhe të ndershme.

KONTEKSTI I ZBRITJES SË KAPTINËS HUMEZE – KOHA DHE SHKAKU

E zbritur në Meke, pas kaptinës Kijame, dhe para asaj Murselat, sipas mendimit të dijetarëve ajo ka zbritur gjatë vitit të tretë ose të katërt të pejgamberisë së Muhamedit a.s.. Edhe pse është e shkurtër, përçon mesazhe të fuqishme me karakteristika letrare të ngjashme me ato të përdorura në periudhën e Mekës, të cilat mbështesin mendimin se kjo kaptinë është shpallur gjatë periudhës mekase.

Për sa i përket shkakut të shpalljes së kaptinës, ndonëse në tefsire përmenden emra të ndryshëm,¹ duke u bazuar nga mendimi i përgjithshëm i mufesirëve është se, sipas shprehjeve të përdorura në kaptinë, paralajmërimet dhe kërcënimet e saj janë drejtuar për të gjithë ata që bëjnë sjellje të shëmtuara, si përgojimi, ofendimi i nderit të njerëzve, vjedhja me bisht të syrit, ironia, veprime këto të përmendura në kaptinë.² Quhet Suretul Humeze, emërtim ky që rrjedh nga ajeti i parë i kaptinës ku përmendet fjala “humeze”, e cila nënkupton personin që ofendon dhe përqesh njerëzit duke i nënçmuar haptazi: “Mjerë për secilin që ofendon përqesh (njerëzit).”³

Kaptina Humeze, gjegjësisht ajeti i dytë, “që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet”,⁶ vë në pah faktin se tubimi dhe ruajtja e pasurisë nga frika e pakësimit për disa individë bëhet shkaktar i shpifjes, talljes dhe dëshirës për të treguar superioritet duke i përçmuar të tjerët.

NDËRLIDHJA MIDIS KAPTINËS HUMEZE DHE KAPTINËS ASR

Lidhja ndërmjet kaptinës Humeze dhe Asr qëndron në tematikën e përbashkët të humbjes dhe shkatërrimit të njeriut, si dhe përshkrimi i atyre që janë të devijuar nga e vërteta. Në kaptinën Asr, Zoti i Madhërishëm, thekson se të gjithë njerëzit janë në humbje të sigurt, përveç atyre që Ai i ka mbrojtur me dritën e imanit dhe veprojnë vepra të mira. Kjo humbje është një gjendje shpirtërore dhe morale, që lidhet me mungesën e besimit dhe veprave të mira. Ndërsa në kaptinën Humeze, Zoti i Lartësuar, thekson cilësitë e njerëzve të humbur, duke përfshirë përgojimin, përqeshjen dhe ofendimin ndaj të tjerëve. Kjo kaptinë specifikon disa forma të prishjes morale dhe të devijimit nga e vërteta, duke u fokusuar tek ata që janë të humbur për shkak të sjelljeve të këqija dhe pa besim. Pra, lidhja mes dy kaptinave është se të dyja përshkruajnë humbjen e njeriut, ku kaptina Asr e bën një vlerësim të përgjithshëm, ndërsa ajo Humeze i jep shembuj të veçantë të asaj humbjeje, duke i lidhur ato me mangësitë morale dhe shpirtërore të individëve.

RËNIA MORALE NË PERSPEKTIVËN E KAPTINËS HUMEZE

Kaptinat mekase flasin në mënyrë të detajuar për nxitjen e moralit të mirë dhe largimin nga veprat e liga. Madje, mund të thuhet se ajo që Kurani ka dashur të përcjellë për moralin, në masën më të madhe është përmbyllur gjatë periudhës së Mekës, teksa gjatë periudhës së Medinës, nuk ka pasur



shumë shtesa përveç detajeve dhe aplikimeve. Në kaptinë Humeze, e cila është një kaptinë mekase, përmendet dhe kritikohet sjellja e atyre që “që ofendojnë e përqeshin (njerëzit), që kanë tubuar pasuri dhe që atë e ruajnë të mos u pakësohet”, duke u shpjeguar pasojat me të cilat do të përballen. Në kuptim të përgjithshëm, në këtë kaptinë flitet për shpifjen dhe talljen si dy sjellje negative që çojnë në degjenerimin moral të individit dhe të shoqërisë. Kaptina përfundon me faktin se, ata që tallin njerëzit, bëjnë shpifje për ta, i përçmojnë, u thyjnë zemrat, shkatërrojnë shpirtin dhe i trishtojnë thellë, do të ndëshkohen me një dënim të rëndë që depërton thellë në zemra dhe i shkatërron ato (hutame).

SHKAQET KRYESORE TË DEGJENERIMIT MORAL SIPAS KAPTINËS HUMEZE

Njeriu është një qenie e krijuar nga Allahu me një natyrë të përzier, që ka të mira dhe të këqija. Ashtu siç i është dhënë aftësia për të mësuar, për të dashur dhe ndihmuar të tjerët, për të qenë i drejtë dhe i mirë, ai ka dhuratën e arsyes, të diturisë dhe të bashkëpunimit, si dhe mundësinë të zhvillojë virtyte të tilla si durimi, dhembshuria dhe falja. Nga ana tjetër, ai gjithashtu ka prirje për të bërë gabime, për të qenë i dëshpëruar, për të pasur lakmi, egoizëm, dhe për të ndjekur interesa të ngushta. Nisur nga kjo, njeriu mund të bjerë në tundimet e pasionit të trupit, dhe kjo ta çojë atë në gabime dhe mëkate. Në këtë kontekst, Kurani përmend disa faktorë të brendshëm që e çojnë njeriun në shkatërrim si: eposhin, mendjemadhësinë, hipokrizinë, xhelozinë dhe lakminë.⁴ Po ashtu, si faktorë të jashtëm, përmenden shejtani, pasuria dhe fëmijët, të cilët mund ta pengojnë njeriun nga përmendja e Allahut.⁵ Në këtë mënyrë, Kurani ka për qëllim të forcojë besimin në Njeshmërinë e Zotit të Lartësuar dhe në jetën e mëtejme (Ahiret), duke synuar që njeriu, si rezultat të arrijë një pjekuri morale. Për këtë arsye, ai kërkon të largojë nga mendësia e shoqërisë elementet që çojnë në degjenerim. Në këtë kuadër, edhe kaptina Humeze paralajmëron dhe kërcënon ata që, duke u mbështetur në pasurinë e tyre, përdorin shpifjet dhe talljet si formë argëtimi.

a. Tubimi i pasurisë dhe frika nga humbja e saj

Kaptina Humeze, gjegjësisht ajeti i dytë, “që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet”,⁶ vë në pah faktin se tubimi dhe ruajtja e pasurisë nga frika e pakësimit për disa individë bëhet shkaktar i shpifjes, talljes dhe dëshirës për të treguar superioritet duke i përçmuar të tjerët. Tubimi i pasurisë dhe ruajtja e saj janë prej natyrshmërisë së njeriut. Në këtë kontekst në Kuran thuhet: “Dhe ai është që shumë e do pasurinë.”⁷ Po ashtu, i Dërguari i Allahut a.s. ka theksuar të njëjtën çështje, duke thënë: “Nëse biri i Ademit ka dy lugina të mbushura me pasuri, ai do të dëshironte edhe të tretën. Kjo është sepse barku i njeriut mund të mbushet vetëm me dhe. Të penduarit, Allahu ia pranon pendimin.”⁸

Mirëpo dëshira e tepruar e njeriut për të tubuar pasuri vjen nga dashuria e tij e madhe për këtë botë dhe dëshira për amshueshmëri. Mendësia se pasuria është çelësi i nderit dhe krenarisë, e shikon tubimin dhe shpenzimin e saj si qëllimin e jetës, pa marrë parasysh se si dhe nga ku fitohet ajo. Kjo mendësi konsideron se vlera e njeriut rritet varësisht nga rritja e pasurisë së tij. Ai përpaket të tallë dhe përçmojë të tjerët që janë në nivelin e tij, sepse krenaria dhe shfrenimi e kanë bërë të harrojnë vdekjen dhe e kanë errësuar mendimin e tij. Pavarësisht se ka shumë pasuri, ai vazhdon ta ruajë dhe nuk e përdor atë për ndihmë, madje mund të mos shpenzojë as për nevojat e tij më të thjeshta të përditshme nga frika se mos e humbë atë. Ky njeri është padyshim i prekur nga sëmundja e koprracisë. Kjo gjendje e tij e pengon gjithashtu të sillet me dashamirësi, mëshirë, butësi dhe tolerancë ndaj të tjerëve. Ajeti thekson një lidhje të ngushtë mes pasionit për pasurinë dhe sjelljes së individit. Ngase një individ i këtillë ashtu siç është koprrac në pasuri, ai është i njëjtë edhe në shpërndarjen e dashurisë dhe në tregimin e durimit ndaj të tjerëve. Në zemrat e tyre nuk ka shpirt human dhe ata ngritin materialen mbi shpirtëroren. Kjo kategori e njerëzve që haset në çdo kohë dhe në çdo vend të botës, i shikojnë me përbuzje dhe nënçmim njerëzit e vobektë, ndërsa i lavdërojnë ata që janë të ngjashëm me ta ose që kanë më shumë pasuri. I Lartmadhërisë na e tërheqë vëmendjen që të mos merremi me këto vlera të ulëta, pasi është Allahu Ai që i jep dhe ia merr kujt të do. Pasuria që ne kemi nuk është në pronësinë tonë, por ajo na është dhënë në shfrytëzim, si një dhuratë dhe mirësi nga ana e Allahut, i Cili është Bujar dhe Mëshirëplotë. Ky ajet flet pikërisht për ata njerëz të pandërgjegjshëm, të cilët grumbullojnë pasurinë dhe e ruajnë duke mos dhënë asgjë.

b. Iluzioni i jetës së përhershme

Si një shkak tjetër për shpifjen, talljen, tregimin e superioritetit ndaj të tjerëve dhe përçmimin e tyre, në ajetin e tretë të kaptinës Humeze përmendet dhe mendësia e përjetësisë: “E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.”⁹ Pra pasioni i tepruar për këtë botë zgjon te njeriu dëshirën për të qëndruar përjetësisht në të, ose të veprojë sikur të ishte i pavdekshëm. Njeriu në këtë gjendje beson se pasuria do t'i sigurojë atij shpëtim nga vdekja dhe se, për këtë arsye, do të qëndrojë përjetësisht në këtë botë. Ai e përcakton sjelljen e tij sipas këtij besimi dhe nuk beson në një botë tjetër ku do të japë llogari për jetën e tij. Ajeti shpreh se pasuria nuk mund ta bëjë njeriun të pavdekshëm, se miqësitë që lindin për shkak të përfitimeve materiale nuk mund të jenë të përjetshme, dhe se ai që mbledh pasuri me këtë qëllim është në humbje. Pasuria nuk e rrit vlerën e njeriut, as nuk e bën të nevojshëm për të lënduar të tjerët. Pasuria i ka verbuar përfundimisht dhe ata mendojnë se me anë të saj mund të realizojnë çdo gjë. Gjëja që do ta shpëtojë njeriun në këtë botë dhe në botën tjetër nuk është pasuria, por bindja, besimi në Allahun dhe veprat e mira.

FORMAT DHE PASOJAT E RËNIES MORALE TË PËRSHKRUARA NË KAPTINËN HUMEZE



Kaptina fillon me fjalën “vejlun”, që do të thotë “mjerë...”, një shprehje shumë e ashpër, që shpreh qartë hidhërimin e Zotit të Madhërishëm ndaj atyre njerëzve të pandershëm, të cilët përpiqen të përqeshin dhe shpifin për të tjerët, duke përdorur fjalë ofenduese, si kur janë pranë, ashtu edhe kur janë larg. Ata paraqiten si arrogantë, të ashpër dhe të mbushur me mendjemadhësi.¹⁰ Për sa i përket kuptimit të fjalëve “humezetin” dhe “lumezetin”, dijetarët kanë ofruar disa mendime, por të gjitha këto pikëpamje kanë kuptime shumë të ngjashme. Sipas disa dijetarëve¹¹, fjala “humeze” i referohet atij që ofendon dhe përgojon të tjerët me fjalë të rënda, kur ata nuk janë të pranishëm, ndërsa fjala “lumeze” përdoret për të përshkruar atë që bën shenja ironike, siç është shikimi me sy, lëvizja e kokës dhe përdorimi i mimikës së vetullave, për të përqeshur dikë, madje edhe kur ai është i pranishëm. Në këtë ajet kuranor, Allahu xh.sh., i mallkon dhe i kërcënon të gjithë ata individë që ofendojnë të tjerët, përqeshin pas shpine dhe shpifin fjalë që dëmtojnë dinjitetin dhe nderin e njerëzve të pafajshëm, duke prekur moralin dhe virtytet e atyre që janë të pastër dhe të devotshëm.

Allahu i Lartësuar në Kuran e ndalon përgojimin. Në këtë kontekst, në Kuran thuhet: “O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni!”¹² Ky ajet flet për tri veprime që shkelin të drejtat e individit: dyshimi, kërkimi i sekreteve të të tjerëve dhe përgojimi. Çdonjëra nga këto është një çrregullim i veçantë. Ngase dyshimi nxit kuriozitetin, dhe kurioziteti hap rrugën për përgojimin. Të tria këto sjellje janë si një sëmundje që shkakton dëme të mëdha në jetën e individëve dhe të shoqërisë. Më e shëmtuara prej tyre është përgojimi si një sjellje e ulët. Allahu e ka krahasuar këtë shëmtim me të ngrënit e mishit të një të vdekuri. Aq sa është i shëmtuar të hash mishin e një të vdekuri, po aq i shëmtuar është edhe përgojimi.

Rrëfimi në kaptinë vazhdon me përfundimin e të këtillëve ku dëshirat dhe pasionet joreale për përjetësinë në këtë botë, i zhduarit fjala e Allahut: “Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të hidhet në Hutame”¹³, që këta të mos iluzojnë e as të mos mendojnë kështu, sepse këto janë dëshira dhe lakmi të kota, meqë përjetësia dhe amshimi nuk i takon askujt tjetër pos Allahut, Krijuesit të ekzistencës. Përkundrazi, këta njerëz, me nënçmimin më të madh do të përbuzen dhe do të hidhen në humnerat e Xhehenemit. Vendqëndrimi i tyre është Xhehenemi i quajtur “Hutame”, një prej greminave të skëterrës, e cila do t’i gllabërojë në zjarrin e saj përcëllues të gjithë ata gojëkëqij, shpifës dhe përqeshës. Se çfarë është tmerrri i quajtur “Hutame” tregohet në ajetin vijues në të cilat thuhet: “Është zjarri i Allahut i ndezur fort, që depërton deri në brendi të zemrës. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ata janë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme.”¹⁴ Një zjarr i fuqishëm që depërton thellë në zemër, duke arritur kështu në vendin e perceptimit. Në Kuranin fisnik, termi zjarri i Allahut përmendet vetëm në këtë kaptinë, duke u përshkruar si diçka që i përket Krijuesit të Lartësuar. Kjo nuk synon vetëm të tregojë tmerrin e zjarrit, por edhe të theksojë se sa të urryer janë te Zoti i Madhërishëm ata njerëz të pandershëm, të cilët përqeshin dhe shpifin për të tjerët dhe mburren në këtë botë me pasurinë e tyre. Për këtë arsye, Allahu e ka përshkruar këtë zjarr si të Tij. Përshkrimi i Hutames si zjarr që djeg zemrat ka një nuancë tjetër nga aspekti se zemra është pjesa më delikate e trupit, ku njeriu ndien dhimbjen më të madhe. Edhe dhimbja më e vogël ndihet në zemër. Përveç kësaj, zemra është vendi i mendimeve. Një zemër që mban qëllime të këqija, mendime të liga dhe besime boshe, do të digjet nga zjarri i formuar prej këtyre mendimeve që mban, duke theksuar se dënimi do të jetë i ashpër dhe i pashmangshëm. Kjo kaptinë shërben si kujtesë për pasojat e sjelljeve të tilla dhe nxit besimtarët të shmangin këto vese, duke u fokusuar në veprime të drejta dhe përkushtim ndaj Allahut.

1 Në një transmetim nga Sudi, thuhet se kjo kaptinë është shpallur për Ahnes bin Şurekk, ndërsa Mukatil b. Sulejman ka thënë se kaptina është shpallur për Velid bin Mugire. Në një rrëfim tjetër të transmetuar nga Ibën Ishaku nga Ibën Mundhiri, thuhet se Ubej bin Halef, kur e shihte Pejgamberin a.s. e përqeshte duke e tallur me lëvizje të syve dhe fytyrës. Pas kësaj, Allahu zbriti këtë sure për të. Ndërkaq, sipas mendimit të Urves, kjo sure është shpallur për As bin Vail es Sehmi. (Kurtubi, el Xhami’ li Ahkami’l-Kur’an, XX/183.)

2 Taberi, Xhamiu’l-Bejan, XXX/293.

3 Humeze, 104/2.

4 Shiko: Jusuf, 12/53; Shems, 91/7-10; Bekare, 2/34,264.

5 Fexhr, 89/20; Beled, 90/6; Maide, 6/91.

6 Humeze, 104/2.

7 Adijat, 100/8.

8 Buhari, Rikak, 10.

9 Humeze, 104/3.

10 Ebu Hajjan el Endelusi, *El-Bahrul Muhit*, VIII/509.

11 Hasaniti, Muxhahidit dhe Ataut.

12 Huxhurat, 49/12.

13 Humeze, 104/3.

14 Humeze, 104/6-9.

Dispozitat dhe rëndësia e xhumasë

• Lavdrim Hamja

RËNDËSIA E XHUMASË

Të gjitha dispozitat e Allahut, që janë zbritur në Kuranin famëlartë, apo që ia ka shpallur të Dërguarit të Tij, Muhamedit a.s. janë të rëndësishme, të pashmangshme, të patjetërsueshme dhe absolutisht të domosdoshme për jetën e njeriut. Secila prej tyre ka rolin dhe funksionin e saj, individual dhe shoqëror, apo çfarëdo lloj aspekti tjetër të jetës së kësaj bote. Megjithatë, për nga rëndësia, roli, funksioni dhe efikasiteti i saj, padyshim xhumaja, është prej dispozitave më të veçanta dhe më ndikueset tek individi dhe

shoqëria, gjithmonë, nëse arrihet të realizohet e plotë dhe në mënyrën e duhur.

Namazi ka vendin dhe rëndësinë e tij, agjërimi ka vlerën e madhe dhe ndikim të lartë, haxhi është madhështor dhe mbarëbotëror dhe zekati është rregullator i anës financiare të shoqërisë, por xhumaja është e veçantë, sepse përfshin të gjitha dobitë e dispozitave të tjera, është e përjavshme dhe ka parësore hytben, apo ligjërimin javor, ku myslimanët shtjellojnë dhe trajtojnë problematikat e ndryshme, shqetësimet, planet, të ardhmen e afërt dhe të largët, etj.

Për nga rëndësia, roli, funksioni dhe efikasiteti i saj, padyshim xhumaja, është prej dispozitave më të veçanta dhe më ndikueset tek individi dhe shoqëria, gjithmonë, nëse arrihet të realizohet e plotë dhe në mënyrën e duhur.



Për vlerën dhe rëndësinë e saj, Allahu i Madhëruar, jo vetëm ka zbritur një sure me emrin e saj, surja El Xhumua, por ka thënë: *“O ju që keni besuar, kur të thirret për namazin ditën e xhuma, nxitoni për te përmendja e Allahut dhe lini shitblerjen. Kjo është më e mirë për ju, nëse jeni që e dini!”* (El Xhumua, 9).

Xhumaja është dispozitë që ia kalon aparateve më të mëdha të propagandës të cilat ka arritur bota. Nëse myslimanët janë sot një miliard banorë, atëherë supozohet që të mbajnë çdo javë një milion, apo dy milionë hytbe. Del njeriu dhe flet përpara njerëzve me emrin e Allahut, flet atë që ka për të folur e besimtarët heshtin dhe dëgjojnë me vëmendje çfarë thotë. Askush se largon vëmendjen prej tij dhe nuk largohet prej vendit, derisa ta dëgjojë komplet hytben e të falë namazin e xhumasë. Një ymet i tillë me këtë rregull, duhet patjetër të jetë i unifikuar në pamje dhe në formë, të rritet niveli i tij intelektual dhe emocional, e t'i anashkalojë shkaqet e ndarjes dhe të përçarjes.¹

KUR ËSHTË BËRË OBLIGIM XHUMAJA DHE KU ËSHTË FALUR XHUMAJA E PARË NË ISLAM?

Edhe pse surja El Xhumua ka zbritur në Medine, sipas transmetimit të Ibën Abasit r.a., i cili thotë se: “Surja El Xhumua ka zbritur në Medine”², namazi i xhumasë është bërë obligim në Mekë, përpara hixhretit, por për arsye të mos plotësimit të kushteve të saj, numrit të vogël të myslimanëve

Xhumaja e parë, që Pejgamberi a.s. e ka falë, ka qenë pas hixhretit të tij, ku namazi i xhumasë e zuri duke kaluar nga Kubaja në Medine.

dhe persekutimit të tyre, ajo nuk është falur, veçse në Medine. Në librat e historisë transmetohet se sahabiu i nderuar, Esad ibën Zurare, ka qenë personi i parë që ka falë namazin e xhumasë, pas dërgimit nga ana e Pejgamberit a.s. të Musab ibën Umejrit si mëkëmbës në Medine, të cilin e urdhëroi të falte namazin e xhumasë në të. Ai u takua me Esad ibën Zurare dhe i komunikoi urdhrin e Pejgamberit a.s..

Esad ibën Zurare mbledhi 40 burra dhe u falë së bashku me ta në zonën e quajtur El Bejada në Medinën e ndritshme. Ky ka qenë namazi i parë i xhumasë i falur në Islam. Ndërsa, xhumaja e parë, që Pejgamberi a.s. e ka falë, ka qenë pas hixhretit të tij, ku namazi i xhumasë e zuri duke kaluar nga Kubaja në Medine. Ai a.s. mbledhi myslimanët dhe fali së bashku me të xhumanë në kopshtin Esh Sherbetlije, në vendin ku sot është ndërtuar xhamia e njohur, si Xhamia e Xhumasë.³

DETYRIMI I XHUMASË

Të gjithë dijetarët kanë rënë dakord, se namazi i xhumasë është farz ajn (obligimi individual), nëse plotësohen kushtet e saj. Argument për këtë janë: Kurani, Suneti dhe konsensusi i myslimanëve. *“O ju që keni besuar, kur të thirret për namazin ditën e xhuma, nxitoni për te përmendja e Allahut dhe lini shitblerjen. Kjo është më e mirë për ju, nëse jeni që e dini!”* (El Xhumua, 9).

Imam El Begaviu ka thënë: “Dije se, namazi i xhumasë është prej farzeve ajn (obligimeve individuale) dhe është i detyrueshëm për secilin mysliman mashkull, i mençur, i



rritur (balig), i lirë dhe mukim (jo udhëtar)... dhe të gjithë kanë dakord, se gratë nuk e kanë obligim xhumanë.”⁴

Ka hadithe të shumta, që tregojnë për detyrimin e namazit të xhumasë, ndër to përmendim: Ebu Hurejra r.a., transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s., duke thënë: “Ne kemi ardhur të fundit, por do të jemi të parët në ditën e kiametit, megjithëse atyre u është dhënë libri përpara nesh dhe ne na është dhënë pas tyre. Kjo është dita e tyre, që u është bërë obligim, e ata nuk ranë dakord për të, ndërsa ne na udhëzoi Allahu për të. Ata do të na pasojnë në të, jehudët të nesërmen dhe të krishterët të pasnesërmen.”⁵

Ebu Hurejra dhe Hudhejfe r.a., transmetojnë se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Allahu i ka humbur prej xhumasë ata që kanë qenë përpara nesh, kështu që jehudët kishin ditën e shtunë dhe të krishterët kishin ditën e diel. Allahu na solli ne dhe na udhëzoi për ditën e xhuma. Kështu që bëri të xhumanë, të shtunën dhe të dielën. Gjithashtu, ata janë ndjekësit tanë në ditën e kiametit; ne jemi të fundit prej banorëve të dynjasë dhe të parët në ditën e kiametit, që do të gjykojnë përpara krijesave.”⁶

Abdullah ibën Omeri dhe Ebu Hurejra r.a., transmetojnë se e kanë dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Do të ndalen disa njerëz nga lënia e tyre e xhumasë, ose Allahu ka për t'i vulosur zemrat e tyre, pastaj do të bëhen prej të hutuarve!”⁷

Sa për konsensusin, nuk dihet asnjë ndryshim në mesin e dijetarëve, se xhumaja është farz (obligim). Imami hanefi, Ajniu ka thënë: “I gjithë ymeti ka rënë dakord, që nga koha e të Dërguarit të Allahut dhe deri në ditët tona, për obligueshmërinë e xhumasë, pa pasur asnjë mohim prej tyre në këtë gjë!”⁸

KUSH E KA OBLIGIM XHUMANË?

Nuk ka dyshim, që xhumaja, për nga kushtet dhe shartet, është sikur obligimet e tjera, përveçse xhumaja ka disa kushte shtesë, që të arrihet obligueshmëria e saj. Nëse nuk plotësohet ndonjëri prej kushteve, atëherë bie obligueshmëria e xhumasë dhe duhet falur namazi i drekës, si në ditët e tjera.

Kushtet e xhumasë:

1. **Islami** (të qenët mysliman),
2. **Pjekuria** (bulugu),
3. **Mendja** (të kuptuarit),
4. **Mashkullia** (xhumaja është obligim vetëm për meshkujt),
5. **Liria** (të jetë i lirë, jo i burgosur apo skllav),
6. **Qëndrimi** (të mos jetë udhëtar),

Gjatë periudhës së Othman ibën Afanit, me shtimin e njerëzve, ai shtoi edhe një ezan tjetër, ezanin e parë, që thërriste në tregun Zevra. Pas asaj dite, i gjithë ymetit e ka pranuar këtë sunet të Othmanit r.a. dhe vazhdon edhe kësaj dite një traditë e tillë.

7. **Mungesa e pengesave** (të mos ketë pengesa apo arsye të tilla fetare, që e pengojnë nga falja e xhumasë),

8. **Distanca e afërt** (të mos jetë larg qytetit, më shumë se tre milje - afërsisht 5-6 km),

9. **Koha** (Enes ibën Maliku r.a. transmeton, se Pejgamberi a.s. e falte xhumanë, kur anonte dielli⁹),

10. **Xhemati** (nuk ka asnjë ndryshim në mesin e dijetarëve se kusht për xhumanë është xhemati, veçse ata kanë ndryshuar në atë, se sa duhet të jetë minimumi i xhematit),¹⁰

11. **Vendbanimi** (d.m.th, të falet xhumaja në një vend, në të cilin ka ndërtesa dhe njerëzit banojnë në atë vend, në të gjitha stinët),

12. **Qeveria ose mëkëmbësit e saj** (prijësi, gjykatësi apo hatibi. Ky është mendimi i hanefive dhe i malikive),

13. **Leja e përgjithshme** (ky kusht është mendimi vetëm i hanefive),¹¹

14. **Të mos i paraprijë apo të mos falet xhuma tjetër në atë vend**, sado i madh të jetë vendbanimi (Ky është kusht, vetëm i shafive),

15. **Hytbeja përpara namazit** (shumica e dijetarëve janë të mendimit se hytbeja përpara namazit është kusht për saktësinë e xhumasë. Argumenti i tyre është, se nuk ka asnjë transmetim nga Pejgamberi a.s., se ai ka falë xhumanë pa hytbe).

Nëse plotësohen këto kushte, atëherë falja e xhumasë është obligim, përndryshe duhet falur namazi i drekës, si në ditët e tjera. Ky është mendimi i dijetarëve islamë.¹²

SA XHUMA LEJOHEN TË FALEN NË NJË VEND?

Është për t'u habitur, se si për shumë çështje dispozitash të ndryshme, veçanërisht ata të cilët pretendojnë se ndjekin brezat e parë, i quajnë bidate apo shpikje, me pretendimin se këto dispozita nuk kanë qenë në kohën e Profetit a.s., të kalifëve rashidinë apo tre shekujve të parë, kur vjen puna për xhumanë, harrojnë apo nuk marrin parasysh, se në kohën e Profetit a.s., në periudhën e kalifëve rashidinë, në shekullin e parë dhe të dytë, madje deri në gjysmën e shekullit të tretë, është falur vetëm një xhuma, në Medinën e ndritshme.

Çfarë kanë thënë dijetarët e ymetit për faljen e disave xhumave në një vend të vetëm?

Dijetarët nuk janë të një mendimi për lejimin e faljes së më shumë se të një xhumaje në një vend të vetëm, pa qenë nevoja për një gjë të tillë, numri i madhe i njerëzve, mbushja plot e xhamive, saqë nuk i zë njerëzit apo arsye të tjera, që justifikojnë faljen e më shumë se të një xhumaje.

Thënia e parë: Nuk lejohet të falet më shumë se një xhuma, në një vend të vetëm, pa qenë nevoja për diçka të tillë, apo pa pasur justifikim për të. Ky është mendimi i katër medhhebeve. Argumentet e tyre janë të shumta, por i përgjithshmi është se, se në kohën e Profetit a.s., në periudhën e kalifëve rashidinë, në shekullin e parë dhe të dytë, madje deri në gjysmën e shekullit të tretë, është falur vetëm një xhuma.

Imam Neveviu, duke shpjeguar këtë argument thotë: “Argumenti ynë është se në kohën e Profetit a.s., në periudhën e kalifëve rashidinë, shokëve të tjerë pas tyre dhe të tjerët pas tyre, nuk kanë falur më shumë se një xhuma në një vend të vetëm, megjithëse ata kanë falur Bajramin në shkretëtirë dhe në vende të vogla.”¹³

Argument tjetër është se, xhumaja e dytë, pas xhumasë që falej në Xhaminë e Pejgamberit a.s. në Medine ka qenë xhumaja që është në falur në Bahrejn.

Bukejr ibën Eshexh transmeton se: “Në Medine kanë qenë nëntë xhami, së bashku me Xhaminë e Pejgamberit a.s., të gjithë dëgjonin ezanin e Bilalit në kohën e të Dërguarit të Allahut a.s. dhe faleshin në xhamitë e tyre. Më e afërta, ka qenë xhamia Beni Amër ibën Mebdhul nga Beni Nexharët, xhamia Beni Saide, xhamia Beni Ubejd, xhamia Beni Seleme, xhamia Beni Rabih nga Beni Abdul Eshhel, xhamia Beni Zurejk, xhamia Beni Gifar, xhamia Eslem, xhamia Xhuhejne, dhe dyshonte për të nëntën.”¹⁴

Jahja ibën Jahja ka shtuar në transmetimin e tij: “Kur vinte dita e xhuma, të gjithë prezantonin në Xhaminë e të Dërguarit të Allahut a.s.”¹⁵

Ibën Abasi r.a., transmeton, se: “Xhumaja e parë e tubuar, pas xhumasë në Xhaminë e të Dërguarit të Allahut a.s. është në xhaminë Abdulkajs në Xhuvatha, Bahrejn.”¹⁶

Thënia e dytë: Nëse ndodh ndonjë armiqësi aspo ngatërresë në një vend, e myslimanët ndahen në grupe-grupe dhe nëse mblidhen në një xhami të madhe të përbashkët, luftojnë njëri-tjetrin dhe nuk mund t'i ndalojë vendimi i mëkëmbësit nga ky konflikt, atëherë atyre u lejohet të bëjnë një xhami tjetër në anën e tyre dhe të falin xhumanë në të. Nëse largohet konflikti prej tyre, apo mëkëmbësi arrinë t'i ndalojë prej konfliktit, atëherë asnjërit nuk i lejohet xhumaja, përveçse në xhaminë e madhe. Me këtë mendim janë Dusuki, Alish, malikitë e mëvonshëm dhe Ibën Tejmiye nga hanbelitë.¹⁷

Përveç këtyre thënieve dhe argumenteve të tyre, të paraqitura këtu, por edhe shumë të tjerave që nuk janë përmendur, del e qartë, se brezat e parë, që nga koha e Pejgamberit a.s., kalifët rashidinë, madje deri nga gjysma e dytë e shekullit të tretë, nuk është falur xhuma tjetër, përveç xhumasë në Xhaminë e të Dërguarit të Allahut a.s..

Edhe ata dijetarë, të cilët e kanë lejuar të falet më shumë se një xhuma, e kanë lejuar vetëm në rast nevojë, e nëse nuk është nevoja për një gjë të tillë, atëherë nuk lejohet të falet më shumë se një xhuma në një vend të vetëm.

SA EZANE KËNDOHEN NË DITËN E XHUMA?

Në kohën e Pejgamberit a.s., dhe gjatë periudhës së Ebu Bekrit dhe Omerit r.a., ditën e xhuma është thirrur vetëm një ezan, ezani që thërret kur hatibi të hip në minber. Gjatë periudhës së Othman ibën Afanit, me shtimin e njerëzve, ai shtoi edhe një ezan tjetër, ezanin e parë, që thërriste në tregun Zevra. Pas asaj dite, i gjithë ymetit e ka pranuar këtë sunet të Othmanit r.a. dhe vazhdon edhe kësaj dite një traditë e tillë.

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Duhet të pasoni sunetin tim dhe sunetin e kalifëve rashidinë të udhëzuar, kapuni fort për të...”¹⁸

Ky sunet i Othmanit r.a., i thirrjes së ezanit ditën e xhuma, nuk është suneti i parë dhe as i vetmi, që ymeti islam ndjek në vargun e suneteve të vendosura pas ndërrimit jetë të Pejgamberit a.s..

1 Muhamed el Gazali, *E vërteta e hidhur* 2, f.88, Shkodër, 2018.

2 Ed Dur'r el Menthur, 8/151.

3 Shih: Menar el Kari', Sherh Mukhtesar Sahihul-Buhari, Hamza M. Kasim, Damask, 1990, sh.b. Darul-Bejan, f.229.

4 El Begaviu, *Mealim et Tenzil*, 8/117.

5 Transmetuar nga Buhariu.

6 Transmetuar nga Muslimi.

7 Transmetuar nga Muslimi.

8 Umdetul Kari - *Sherh Sahihul-Buhari*, 6/162.

9 Buhariu në kapitullin e xhumasë.

10 Hanefitë kanë thënë: Minimumi i xhematit duhet të jetë tre persona, pa imamin. Këtë mendim ka Ebu Hanife dhe Muhamedi. Të tjerët kanë thënë duhet të jenë dy persona, përveç imamit. Ky është mendimi i Ebu Jusufit.

Malikitë kanë thënë se numri duhet të jetë i tillë, sa banorët e një vendi të jenë të panevojshëm për ta, sa që ta largojnë rrezikun pa ta. Ata e kanë llogaritur këtë numër një njëqind persona, ose pesëdhjetë persona, ose tridhjetë persona prej atyre që e kanë obligim xhumanë. Ky është kushti për xhumanë e parë, që falet në atë vend, ndërsa xhumatë e tjera, që mund të falen, ato plotësohen me dymbëdhjetë vetë, përveç imamit. Ky është mendimi kryesor te malikitë.

Medhhebi shafi mendojnë se xhemati i xhumasë duhet të jetë dyzet persona.

Kështu mendojnë edhe hanbelitë.

11 Ibën Abidini ka thënë: “Leja e përgjithshme do të thotë që të hapen dyert e xhamisë dhe njerëzit të lejohen të hyjnë në të. Edhe në qoftë se në xhami mblidhet xhemati dhe mbyllen dyert e xhamisë, nuk pranohet. Nëse udhëheqësi dëshiron të falet në pallatin e tij, hap dyert dhe lejon njerëzit e thjeshtë të futen, atëherë lejohet dhe vlen namazi i xhumasë, por nëse nuk i hap dyert dhe rojet qëndrojnë te dera dhe nuk u lejojnë njerëzit të futen, atëherë namazi i xhumasë nuk është i saktë.

12 Për më tepër, shih: Hashijetu të Ibën Abidin, kapitulli i xhumasë dhe El Mugni të Ibën Kudames, kapitulli i xhumasë.

13 Shih: El Mexhmu sherh el muhedhdeh, 4/591.

14 Transmetuar nga Ebu Davudi në El Merasil dhe Darakutni në Sunenin e tij nga Ebu Davudi, 2/85.

15 Transmetuar nga Bejhakui në Mearifetus Sune vel Athar, 12/509-510.

16 Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

17 Shih: Mukhtesar el Fetava el Misrije, të Ibën Tejmiyes, f.75.

18 Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Tirmidhiu. Hadithi i plotë: “Ju porosis të keni frikë Allahun, të dëgjoni dhe të bindeni, edhe nëse ju udhëheq një skllav, sepse, ai që do të jetojë prej jush, do të shikojë ndryshime të mëdha. Prandaj, duhet të pasoni sunetin tim dhe sunetin e kalifëve rashidinë të udhëzuar, kapuni fort për të. E, mjerë për ju dhe gjërat e shpikura, sepse çdo shpikje është humbje.”

Dimensionet e xhihadt dhe abuzimet me të

• Hfz. Mehas Alija

Islami nuk është vetëm besim, ritual dhe doktrinë, por edhe mënyrë jetese, sistem jete, platformë mbi të cilën formohen njerëzit, sikurse është edhe histori dhe qytetërim. Sikur njeriu ta përqaftonte Islamin siç duhet, si një synim jete, me siguri do të arrinte te rezultati i synuar, pa i cenuar ligjet pozitive të shtetit ku jetohet dhe pa i lëkundur parimet dhe shtyllat kryesore të fesë.

Është fakt, gjithashtu, se Islami nuk e dëshiron luftën dhe as që e kërkon derdhjen e gjakut. Në Kuran thuhet: *“Allahu i kurseu besimtarët nga lufta.”*¹ Kjo pjesë e ajetit tregon qartë dashamirësinë e shpirtit islam dhe diferencimin e tij nga përdorimi i dhunës dhe nga ajo që është tendencioze.



Kjo nuk do të thotë se Islami nuk e mbron të drejtën për luftë dhe të drejtën për t'u mbrojtur. Xhihadi në kuptimin e luftës vije në shprehje vetëm atëherë kur të jenë shterur të gjitha mjetet dhe opsionet e tjera paqësore dhe dialoguese dhe kur armiku i myslimanëve nuk heq dorë nga agresioni dhe ambiciet e tij të rrezikshme.

Në rastet e tjera, lufta e armatosur në emër të xhihadt, do të ishte abuzim dhe keqpërdorim i tij. Lufta assesi nuk mund të jetë identiteti i vetëm i xhihadt.

Se si ka ndodhur të keqkuptohet dhe të keqpërdoret xhihadi sot në botë, apo se si janë justifikuar aktet ekstremiste dhe të dhunshme në emër të tij, do të flitet në rreshtat në vijim të këtij punimi, ku si qëllim tjetër ka edhe të shqyrtojë natyrën dhe llojet e xhihadt, faktorët që ndikuan në abuzimin me të, si dhe implikimet e tij sot në nivelin individual dhe kolektiv.

DEFINICIONI DHE DIMENSIONET E XHIHADIT

Për xhihadin² është shkruar mjaftë, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, dhe ekzistojnë një sërë keqkuptimesh rreth këtij fenomeni, kurse vlerësimet shpesh janë bërë pa njohuri themelore të Islamit. Një fat të këtille nuk e patën vetëm segmente apo postulate të caktuara, por ndonjëherë edhe vetë Islami në tërësi. Vështrimi i njëanshëm i xhihadt ka kontribuar në paraqitjen e Islamit sot në botë si një fe tendencioze dhe militante.³

Vështrimi i njëanshëm i xhihadt ka kontribuar në paraqitjen e Islamit sot në botë si një fe tendencioze dhe militante.

Studiuesit objektiv dhe myslimanët mendjendritur i janë kundërvënë përkufizimit kishtar perëndimor të xhihadit si një “*Luftë e shenjtë*”⁴ (Holy War), duke theksuar qartë se “lufta e shenjtë” nuk ka bazë në Islam, as në Kuran dhe as në hadith.⁵ Në asnjë vend në tekstet fetare islame, Kuran dhe hadith, nuk gjendet shprehja që i jep karakter të shenjtë (*mukaddes*) xhihadit.⁶

Në veprën “Leksioni Islam”, nocioni xhihad është shpjeguar si: “Përpjekje, orvatje e myslimanit në emër të Allahut, për ta plotësuar përgjegjësinë islame, si në veprimet e jashtme, ashtu edhe në përmirësimin e brendshëm të gabimeve personale; xhihad në rrugën e Allahut, xhihadi me dije, me pasuri dhe me jetë në rrugë të Allahut. Përpjekje e brendshme që të ndryshohen shprehitë ose sjelljet e këqija në shoqërinë islame ose tek individët.”⁷

Në kuptimin më të gjerë, xhihadi është mekanizmi që ndihmon në vënien e baraspeshës në jetë me normat islame. Dijetari turk, Ali Bulaç, xhihadin e përkufizon si një “përpjekje për t’i hequr pengesat mes njeriut dhe Zotit.”⁸ Po ashtu është definuar edhe si përpjekje për të eliminuar analfabetizmin nga një pjesë e shoqërisë myslimane.⁹ Do të thotë, xhihad me laps, bojë dhe mjete të tjera teknologjike bashkëkohore.¹⁰ Për Pejgamberin a.s., xhihad ishte edhe: “t’ia thuash të vërtetën në fytyrë një sundimtari tiran.”¹¹

S’do mend se një aspekt tjetër i ngushtë i xhihadit është edhe lufta e armatosur dhe ballafaqimi fizik me armikun, por vetëm me qëllim të mbrojtjes së vendit, lirisë, besimit dhe vlerave të tjera që bota i konsideron si arritje me vlera të larta në histori.¹² Ky lloj xhihadi përdoret vetëm kur nuk gjendet rrugë tjetër për mbrojtje nga kundërshtari, për largimin e okupatorit, si dhe për të vendosur baraspeshë në momentin e caktuar historik.¹³

Nga sa u pa më lartë, xhihadi ka dimensione të ndryshme dhe nuk e posedon assesin si identitet të vetin vetëm luftën si ballafaqim fizik me armikun dhe hiq më hiq nuk e pranon përcaktimin e imponuar kristian si “*luftë e shenjtë*”. Mbase nga këtu fillon edhe shtrembërimi, keqkuptimi dhe keqpërdorimi i xhihadit, sepse është parë vetëm si nocion lufte dhe përdorim shpate.

Tërë kjo që u theksua këtu dhe ajo që është lënë pa u përmendur, shkaku i natyrës

së punimit, në lidhje me dimensionet e xhihadit, mund të përmbledhet në tri pika kryesore:

- Të kuptuarit e xhihadit si një mjet i dhunshëm për të imponuar fenë dhe luftimi i të gjithë atyre që e refuzojnë atë;
- Insistimi në xhihad, si një përpjekje jomilitante, pa përdorim dhune, që ka për synim përmirësimin shpirtëror dhe moral të individit;

- Xhihadi në thelb është një përpjekje që ka për qëllim ringjalljen dhe prosperitetin e shoqërisë në të gjitha fushat.¹⁴

Në vijim do të shihet se deri në çfarë mase mund të përshtaten këto koncepte me frymën e teksteve fetare. Cili lloj i xhihadit u keqpërdor dhe cili lloj i tij duhet sot të promovohet dhe të përdoret?

LLOJET E XHIHADIT

Duke pasur parasysh specifikat e xhihadit, dijetarët myslimanë e kanë ndarë atë në disa lloje. Ibën Kajjim el Xheuzije (1350/751) e ndanë xhihadin në disa nivele: “Katër nivele të xhihadit ndaj vetvetes, dy të xhihadit ndaj djallit, tre

nivele kundër padrejtësive, shthurjes dhe veprave të ulëta në shoqëri, me anë të zemrës, gjuhës dhe duarve, si dhe katër nivele të xhihadit që ushtrohen ndaj keqbërësve, mohuesve dhe hipokritëve, duke vënë në funksion fjalën, forcën dhe pasurinë.”¹⁵

Përveç kësaj ndarjeje, ne do të ndalemi te disa aspekte më të veçanta dhe më elementare, siç është xhihadi me vetveten, xhihadi pasiv, xhihadi aktiv dhe xhihadi medial.

a) Xhihadi me vetveten

Një lloj i rëndësishëm i xhihadit dhe që përbën instancën themelore të tij është edhe xhihadi me vetveten. Kjo paraqet luftën për ta aftësuar njeriun kulturalisht, profesionalisht, teknikisht dhe shkencërisht, si dhe për të formuar një personalitet të shëndosh e të fortë shpirtërisht e moralisht.¹⁶ Në një rast, Muhamedi a.s., duke u kthyer nga një ekspeditë luftarake, u tha shokëve të tij pjesëmarrës: “*Kthehemi nga xhihadi i vogël (xhihadu-l-esgar) në xhihadin e madh (xhihadu-l-ekber)*. Dikush e pyeti se ç’kuptohet me xhihadin e madh? Muhamedi a.s. u përgjigj: “*Xhihadi me vetveten (xhihadu-n-nefs)*.”¹⁷ Në një hadith tjetër thuhet: “Lufta më e mirë është lufta kundër shpirtit tënd dhe pasioneve tua në rrugën e Zotit.”¹⁸

Një lloj i rëndësishëm i xhihadit dhe që përbën instancën themelore të tij është edhe xhihadi me vetveten. Kjo paraqet luftën për ta aftësuar njeriun kulturalisht, profesionalisht, teknikisht dhe shkencërisht, si dhe për të formuar një personalitet të shëndosh e të fortë shpirtërisht e moralisht.

Siç vërehet, ky është xhihadi më i rëndë, për arsye se ta njohësh vetveten dhe të zhvillosh një personalitet pozitiv, human dhe kreativ është manifestimi më i lartë i luftës me vetveten. Kjo është edhe një arsye tjetër se pse u shtrembërua koncepti i xhihadi, pasi është më lehtë të shkatërrosh tjetrin sesa ta ndërtosh veten.

b) Xhihadi pasiv

Ky është xhihadi që, fillimisht, u praktikua nga Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij në Mekë. Është fjala për durimin dhe qëndrueshmërinë para së keqes, kërcënimit dhe presionit që vinte nga forca e politeistëve mekasë paganë.¹⁹ Ky lloj xhihadi vije në shprehje kur myslimanët janë të dobët dhe minoritet.²⁰ Allahu xh.sh. i drejtohet Muhamedit a.s. në këtë mënyrë: “Ti merri me të mirë. Urdhëro për vepra të mira dhe hiq nga injorantët.”²¹ “Pra ju lini dhe largohuni prej tyre derisa Allahu ta sjellë urdhrin e vet. Allahu ka mundësi për çdo send.”²²

Në këtë fazë të hershme të zhvillimit të xhihadi në Mekë, Allahu xh.sh. kërkon nga Pejgamberi a.s. që ai të ftojë në Islam me metoda paqësore, me urtësi dhe këshilla të bukura: “Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillime të mira dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë.”²³

Me këto parime Muhamedi a.s., në periudhën mekase bëri xhihad që rezultoi në formimin e njeriut dhe themelet e shoqërisë së re. Ky lloj xhihadi nuk ka përmbajtur në vete kurrfarë elemente të forcës, dhunës, e as të ndonjëfarë shtypjeje.²⁴

c) Xhihadi aktiv

Në situatën kur myslimanët kërcënohen apo të jenë të sulmuar, kur armiku fillon t'i përdhos shenjtëritë e tyre, të pushtojë tokat e tyre dhe të njollosoj dinjitetin e myslimanit, në këtë rast myslimanëve u lejohet të ndërmarrin masat vetëmbrojtëse dhe të japin pasuritë dhe jetët e tyre në zmbarsjen e armikut.²⁵ Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: “Përse të mos e luftoni një popull që thyen zotimet e veta dhe tentuan ta dëbojnë të dërguarin? Në të vërtetë ata ua filluan të parët luftën. A u frikësoheni atyre? Më e drejtë është t'i frikësoheni Allahut, nëse jeni besimtarë.”²⁶ “Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që u sulmojnë e mos e teproni,



se Allahu nuk i do ata që e teprojnë.”²⁷

Ky aspekt i xhihadi, pra ana luftarake e tij, është vetëm i natyrës mbrojtëse dhe jo ofensive.²⁸ Edhe në këtë rast, detyrimi për të dalë në luftë, nuk duhet që të ndikojë që aspekti ushtarak i xhihadi të mos jetë i limituar.²⁹

Pavarësisht kësaj, nëse ndodh që të ndryshojnë rrethanat për të mirë dhe armiku të tërhiqet apo të kërkojë pajtimin, Islami nuk e mbyll derën përpara mundësisë së përmirësimit të marrëdhënieve. Allahu xh.sh. thotë: “Në qoftë se ata anojnë kah paqja, ano edhe ti

kah ajo e mbështetu në Allahun. Ai është që dëgjon dhe di.”³⁰

Për të tilla luftëra, sot shumë shtete në botë shënojnë dhe kujtojnë me krenari Luftërat Kombëtare dhe Çlirimtare, të cilat u zhvilluan për të mbrojtur ekzistencën e vatanit, lirisë dhe popullit.

d) Xhihadi medial

Në kohën moderne, ku njerëzimi flet me gjuhën e internetit dhe të teknologjisë, përdorimi i institucionit të xhihadi paraqet sfidë në vete. Shfrytëzimi dhe përdorimi i drejtë i këtij kanali bashkëkohor për promovimin dhe përhapjen e mesimeve islame dhe të luftimit të së keqes, propagandës antiislame, është një shërbim intelektual shumë më efikas që mund t'i bëhet Islamit, sesa xhihadi ushtarak. Sot, ky lloj i xhihadi, ku përfshihet fjala, lapsi, letra, media, interneti, rrjetet sociale, libri, televizioni, është xhihadi që ua kalon për nga pesha dhe ka të drejtë përparësie ndaj të gjitha llojeve të tjera të tij. Madje Kurani e konsideron xhihadin e këtillë, në thirrje, predikim dhe propagandë pozitive mediatike, si xhihad të madh, sikurse Allahu xh.sh. në suren El Furkan thotë: “Po ti mos i dëgjo jobesimtarët, e luftoi ata me të (me Kuranin), me një luftë të madhe.”³¹

Nga ana tjetër, duhet pranuar se shkenca dhe teknologjia në botën e sotme nuk janë neutrale dhe nuk janë të ruajtura nga vlerat ideologjike³² dhe nga keqpërdorimet e mundshme. Propaganda devijante dhe rekrutimi i të tjerëve për qëllime ideologjike paraqet një front të ri në internet për ata që deri më tani e keqpërdorën xhihadin në forma të tjera.

Mediat sociale janë një mjet shumë efektiv dhe emocional për të përhapur një mesazh apo një propagandë ekstremiste.³³ Platformat si Facebook, Twitter, Instagram, Tiktok dhe Telegram, janë përdorur për të ndërtuar komunitete të radikalizuara dhe për të ndarë materialet propagandistike, udhëzimet për veprimet terroriste dhe mesazhet e urrejtjes.³⁴

ABUZIMI ME XHIHADIN

Me xhihadin si nocion, fenomen dhe institucion, jo gjithëherë gjatë historisë është punuar në mënyrën adekuate dhe të barasvlershme me nevojat kontekstuale dhe kohore. Interpretimet e shtrembëruara dhe qasjet e gabuara ndaj Islamit në përgjithësi dhe ndaj xhihadit në veçanti, përpara se të arsyetohen, duhet të gjykohen drejt dhe me objektivizëm. Në raport me xhihadin, kryesisht mund t'i veçojmë tri keqinterpretime:

1. Barazimi i shpeshtë i nocionit xhihad me konceptin e luftës nga ana e dijetarëve klasik myslimanë³⁵;

2. Konceptimi i xhihadit si luftë e shenjtë nga ana e jomyslimanëve, perëndimorëve dhe orientalistëve³⁶;

3. Lëvizjet bashkëkohore ideologjike ekstremiste, sikur që janë Al Kaida, ISIS, etj.³⁷

Grupet islame të cilat me armë, në emër të Islamit dhe të mbrojtës së tij, luftojnë si brenda, ashtu edhe jashtë botës islame, si me myslimanë, ashtu edhe me jomyslimanë, abuzojnë me xhihadin. Për shkak të kësaj, kanë ndodhur ngjarje të përgjakshme në një sërë vendesh myslimane, ku është derdhur gjaku, është bërë terror mbi trashëgiminë islame, janë dhunuar të drejta njerëzore dhe janë prishur shtete.³⁸ Kërkj kjo në emër të xhihadit!

Ndërkohë që historia na mëson se Pejgamberi a.s., para çdo beteje apo lufte, shfaqte humanitetin dhe korrektësinë ndaj robërve të luftës, pleqve, femrave dhe fëmijëve, ndaj manastireve dhe priftërinjve. Po kështu njëjtë vepruan edhe katër kalifët e drejtë, Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r. anhum.³⁹

Prandaj, duket se ka ardhur momenti që kokat dhe strukturat intelektuale mendjendritura të botës myslimane dhe jashtë saj, më në fund, të kuptojnë se janë para një përgjegjësie të madhe për të ridimensionuar konceptin e xhihadit dhe të demaskimit të të gjithë atyre që abuzojnë pamëshirshëm me të.

Dhe në fund, xhihadi më shumë paraqet një emër për paqen sesa për luftën, e nëse duhet luftuar, atëherë lufta bëhet në emër të së drejtës për t'u vetëmbrojtur.

Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të të gjithë botëve!

1 El Ahzab, 25. Sipas: Sherif Ahmetit, *Kur'ani – përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, versioni elektronik: <https://kuran-index.com/>.

2 Fjala xhihad rrjedh nga folja “xhehede-jehxhedu”, që domethënë të orvatesh, të kontribuosh, të përpiqesh, etj. Shih më gjerësisht mbi domethënien e fjalës xhihad dhe luftë e shenjtë në: Ghazi bin Muhamad, Ibrahim Kalin dhe Muhamad Hashim Kamali, *Lufta dhe paqja në Islam*, Logos-A, Shkup, 2015, fq. 18-19.

3 Hasan Sušić, *Dimenzije džihada*, Znakovi vremena - Časopis za filozofiju, religiju, znanost

i društvenu praksu, nr. 26-27, Sarajevë, 2005, fq. 22.

4 John L. Esposito, Von Kopftuch bis Scharia, Reclam, Stuttgart, 2009, fq. 145; Po ashtu: “Lufta dhe paqja në Islam”, op.cit., 116.

5 Nexhat Ibrahim, *Fjalë pas fjale – për islamit dhe myslimanët*, Logos-A, Shkup, 2016, fq. 424.

6 Hasan Sušić, op.cit., fq. 23.

7 Nexhat Ibrahim, *Leksikoni islam*, Logos-A, Shkup, 2012, fq. 331-332.

8 Ibid., fq. 331-332.

9 Ziauddin Sardar, *Fytyra të Islamit – biseda për probleme bashkëkohore*, Logos-A, Shkup, 2017, fq. 166.

10 Më gjerësisht: Reshid Hafizofiq, *Shtyllat e Islamit dhe xhihadi*, Logos-A, Shkup, 2022, fq. 247-257.

11 Ibën Maxhe dhe Tirmidhiu, cituar sipas: Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, botuar nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Shkup, fq. 487.

12 Husein Gjozo, *Islami në kohë*, Meshihati i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Shkup, 1993, fq. 160.

13 Për arsyet që e legjitimojnë xhihadin në kuptim të luftës, shih më gjerësisht: *Islamska Povelja*, Unioni i dijetarëve myslimanë botëror, El Kalem, Sarajevë, 2010, fq. 90. Gjithashtu: Ahmet Alibashiq dhe Muhamed Jusiq, *Dilemat bashkëkohore muslimane*, Furkan-ISM, Shkup, 2022, fq. 338; Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, Furkan-ISM, Shkup, 2018, fq. 240-241.

14 Hasan Sušić, *Dimenzije džihada*, op.cit., fq. 23.

15 Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, op.cit., 243; Po ashtu: Ghazi bin Muhammad, Ibrahim Kalin dhe Muhammad Hashim Kamali, *Lufta dhe paqja në Islam*, op.cit., fq. 21.

16 Husein Gjozo, *Islami në kohë*, op.cit., fq. 155.

17 E transmeton imam Bejhekiu. Disa dijetar e kanë cilësuar si hadith të dobët. Shih: Nexhat Ibrahim, *Fjalë pas fjale*, op.cit., fq. 426. Ky hadith është shumë popullor në literaturën islame dhe në përdorimin gojor tek ulemaja myslimane. Shih gjithashtu: Husein Gjozo, op.cit., fq. 155.

18 Shih më gjerësisht në: “Lufta dhe paqja në Islam”, op.cit. fq. 121. Po ashtu: Ahmet Alibashiq dhe Muhamed Jusiq, *Dilemat bashkëkohore myslimane*, op.cit., fq. 338-339.

19 Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, op.cit., 245; Husein Gjozo, *Islami në kohë*, op.cit., fq. 156.

20 Nexhat Ibrahim, *Fjalë pas fjale*, op.cit., fq. 427.

21 El A'raf, 199.

22 El Bekare 109.

23 En Nahl, 125.

24 Husein Gjozo, op.cit., fq. 159.

25 *Islamska Povelja*, op.cit., fq. 89

26 Et Teube, 13.

27 El Bekare, 190.

28 Ziauddin Sardar, op.cit., fq. 167.

29 Ibit., 167.

30 El Enfal, 61.

31 El Furkan, 52.

32 Ziauddin Sardar, op.cit., fq. 176.

33 “Xhihadi digjital” në portalin DW: <https://www.dw.com/sq/xhihadi-digjital/a-18537639> (kontrolluar së fundmi më 01.06.2023).

34 Për më shumë lloje të tjera të xhihadit, shih: “Vrste džihada”, <https://znaci.ba/tekstovi/vrste-dzhihada>. (Kontrolluar më 01.06.2023)

35 Louay M. Safi, *Mir i granice rata: prevladavanje klasične koncepcije džihada*, CNS, Sarajevë, 2018, fq. 14.

36 Hasan Sušić, op.cit., fq. 24; Po ashtu: Husein Gjozo, op.cit., fq. 164-165.

37 Se si u deformua dhe se si u dhunua ligji islam i luftës, shih më gjerësisht: “Lufta dhe paqja në Islam”, op.cit., fq. 158-166.

38 Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë...*, op.cit., 253.

39 Jusuf Ramić, *Džihad i njegova zloupotreba*, në: Zbornik Radova, FIN, Sarajevë, 2004, fq. 173.

Intervistë me reisin e Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazoviq

Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, boshnjakët dhe shqiptarët, u munduan t'i mbanin sa më larg njëri-tjetrit, mirëpo këtë mision nuk e arritën

Sa është e theksuar ndjesia e besimeve në shoqërinë e Bosnjë dhe Hercegovinës?

Dr. Husein ef. Kavazoviq: Më lejoni, natyrisht, t'ju përsëjndes ju, vëllezër nga Kosova, që keni ardhur këtu në Bosnje dhe Hercegovinë, për të na vizituar. Dua t'i përsëjndes të gjithë vëllezërit dhe motrat tona, shqiptarë dhe boshnjakë, që jetojnë në Kosovë.


Kjo është me të vërtetë një mundësi e mirë për t'i thënë disa fjalë dhe për të shprehur kënaqësinë time, që dy bashkësitë tona po bashkëpunojnë mirë, për kënaqësinë tonë reciproke, ashtu të themi.

Kur bëhet fjalë për praninë e fesë, pra, në shoqërinë boshnjako-hercegovase, mund t'ju them se bashkësitë fetare janë para së gjithash, pra flasim për Bashkësinë Islame, Kishën Katolike, Kishën Ortodokse dhe, mund të themi, komunitetin hebre gjithashtu, komunitetet e lira që shprehin lirisht ndjenjat e tyre fetare.

Disa hulumtime tregojnë se feja është shumë e përfaqësuar në shoqërinë boshnjako-hercegovase, se ata janë në numër të madh, në një përqindje të madhe, natyrisht ata deklarojnë veten si besimtarë, e tash, çfarë është intensiteti i besimit, sa është ai i fortë, ashtu të themi, sa njerëz janë praktikues të asaj që ne myslimanët themi - sa i kryejnë farzet e tyre, e kështu me radhë, kjo është një pyetje tjetër tani, por një numër i madh njerëzish deklarojnë si myslimanë, ne mund të flasim për një përqindje mbi 90% për qind, pra, ata

Reisi i Bashkësisë Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë Huesin ef. (Kavazović) Kavazoviq, ekskluzivisht flet për produksionin e BIK-ut për:

- Ndjesinë fetare në shoqërinë e Bosnje dhe Hercegovinës;
- Ndikimi e fesë në Bosnjën e pasluftës;
- Rolin e BI-së në komunitetin boshnjak;
- Funksionimin e BI-së në etnitetin e Republikës Serbe;
- Rolin e Bashkësisë Islame në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit boshnjak; Raportet dhe marrëdhëniet ndërmjet bashkësive islame të BH dhe Kosovës.



Dr. Husein ef. Kavazoviq

që deklarohen si besimtarë, që thonë për vete se besojnë në Zot dhe se Islami është feja e tyre, dhe se i përkasin traditës myslimane si njerëz.

Çfarë roli ka ndjesia fetare në një vend që para tri dekadave ka përjetuar luftë të tmerrshme?

Dr. Husein ef. Kavazoviq: Feja luajti një rol shumë të rëndësishëm, prandaj, mund të themi se në shoqërinë e pas-konfliktit, të dalë nga lufta - agresioni kundër Bosnje dhe Hercegovinës, ajo luajti një rol të madh në ruajtjen e shëndetit mendor, të themi ashtu, në mesin e myslimanëve boshnjako-hercegovas.

Prandaj, ne e pranuar para së gjithash sprovën që na goditi, si diçka që duhej ta kalonim. Ju e dini shumë mirë se agresioni kundër Bosnjë dhe Hercegovinës ishte aq i dhunshëm sa ata kryen krime të tmerrshme kundër myslimanëve boshnjako-hercegovas, si dhe kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, madje edhe gjenocidi që ndodhi në Srebrenicë, pavarësisht kësaj, ne e dimë dhe theksojmë, se myslimanët boshnjako-hercegovas nuk kanë kryer krime. Mund të ketë pasur krime individuale, pra gjatë agresionit, por nuk pati krime masive nga myslimanët boshnjako-hercegovas. Ne besojmë se Bashkësia Islame ka luajtur këtu rol kyç, duke insistuar se përgjegjësia është individuale, siç thotë edhe Kurani: ***Ve la teziru vazireten vizre uhra*** (askush nuk mund të mbajë barrën e askujt). Pra, duke këmbëngulur në përgjegjësinë individuale, ne konsiderojmë se Islami luajti një rol kyç në mënyrë që myslimanët boshnjako-hercegovas të mos kryenin krime kundër popullsisë serbe, sikur që serbët kryen krime masive, etj.

Bashkësia Islame në Bosnje dhe Hercegovinë është një ndër institucionet më të vjetra e më të organizuara, cili është ndikimi i saj në komunitetin boshnjak si këtu në Bosnje, ashtu edhe në diasporë?

Dr. Husein ef. Kavazović: Bashkësia Islame në Bosnje dhe Hercegovinë, sikurse edhe Bashkësia Islame në Kosovë, është

Pas agresionit kundër Bosnjë dhe Hercegovinës dhe pasi popullsia u dëbua nga këto zona të Republikës Serbe dhe xhamitë u shkatërruan (614 xhami në Republikën Serbe u shkatërruan në themel, i shkatërruan të gjitha), arritëm t'i rindërtonim ato xhami dhe arritëm të kthejmë një pjesë të popullsisë.

organizata më e vjetër e boshnjakëve, e cila pas largimit të Perandorisë Osmane nga këto rajone, luajti një rol kyç në ruajtjen e identitetit, si fetar, ashtu edhe kombëtar, duke pasur parasysh se pushtetet që vinin nga Austro-Hungaria, Mbretëria e Jugosllavisë, dhe më vonë Jugosllavia Komuniste, mund të themi lirisht këtu, ishin një organ i huaj, ata nuk lejuan boshnjakët të zhvillonin identitetin e tyre kombëtar, por ishin të kufizuar ekskluzivisht në identitetin fetar, kështu që nëpërmjet atij identiteti fetar ne ruajtëm edhe identitetin kombëtar.

Roli i Bashkësisë Islame në ruajtjen e myslimanëve boshnjako-hercegovas është i pamatshëm, lirisht mund të themi se historia e boshnjakëve nga fundi i shekullit XIX dhe i gjithë shekulli XX, është në fakt historia e Bashkësisë Islame, sepse nëpërmjet Bashkësisë Islame është ruajtur ky identitet kulturor, kombëtar dhe fetar, në mënyrë që edhe sot e kësaj dite Bashkësia Islame luan një rol kyç në organizimin e boshnjakëve, si në Bosnje dhe Hercegovinë, ashtu edhe jashtë kufijve të saj.

Si funksion Bashkësia Islame në entitetin e Republikës Serbe?

Reis Kavazović: Po, ne ia dolëm, falë Zotit të Madhëruar, që pas agresionit kundër Bosnjë dhe Hercegovinës dhe pasi popullsia u dëbua nga këto zona të Republikës Serbe dhe xhamitë u shkatërruan (614 xhami në Republikën Serbe u shkatërruan në themel, i shkatërruan të gjitha), arritëm t'i rindërtonim ato xhami dhe arritëm të kthejmë një pjesë të popullsisë. Natyrisht, sot këto nuk janë më komunitetet që ishin para luftës, disa qytete, sidomos në Bosnjën Lindore – kishte qytete me shumicë myslimane pranë Drinës, me një përqindje mbi 80%, prandaj, në ato qytete kishte boshnjakë, se popullsia u reduktua, për fat të keq, në 10-15% të popullsisë boshnjake, por ne arritëm ende të rindërtonim xhamitë në të gjitha këto xhemate, dhe pothuajse në të gjitha ato kemi imamë që punojnë me popullin tonë, kemi mësim fetar atje, kemi një strukturë të zhvilluar islame, kemi arritur ta bëjmë këtë.

Natyrisht, boshnjakët-myslimanë në Republikën Serbe përballen me diskriminim, ai është i pranishëm në institucionet publike, qeverinë, arsimin, shëndetësinë etj., ne e shohim atë të pranishëm në punësim,



ku shumë rrallë një boshnjak mund të gjejë një punë në organet shtetërore.

Roli i Bashkësisë Islame dhe institucioneve të saj në ruajtën dhe kultivimin e identitetet boshnjak?

Dr. Husein ef. Kavazoviq: Po, siç e thashë, roli i Bashkësisë Islame është i madh, është shumë shpesh adresa e vetme në të cilën mund të drejtohen boshnjakët, si në Republikën Serbe ashtu edhe në diasporë, në mënyrë që Bashkësia Islame, nëse mund të them kështu, të ketë këtë mision për të tubuar boshnjakët, për ta pasur pranë, dhe që përmes institucioneve të Bashkësisë Islame të kenë atë kapëse të përhershme me atdheun, domethënë, me Bosnjën dhe Hercegovinën, t'u kujtojmë vazhdimisht nëpërmjet gjuhës e kulturës dhe nëpërmjet islamijetit tonë – identitetit tonë islam, për t'i lidhur me Bosnjën dhe Hercegovinën.

Pas viteve të -90ta të shekulli të kaluar, për shkak të rrethanave nëpër të cilat kanë kaluar popujt e ish-Jugosllavisë, kontaktet dhe bashkëpunimi në mes Kosovës dhe Bosnje dhe Hercegovinës, respektivisht shqiptarëve e boshnjakëve, është vështirësuar në maksimum dhe këtë pa fajin e të dy popujve, shkaqet dihen, a pritet që të tejkalohet kjo gjendje?

Dr. Husein ef. Kavazoviq: Ju keni të drejtë, pra, boshnjakët dhe shqiptarët ishin dy popuj, të cilët në ish-Jugosllavinë Socialiste dhe në Bashkësinë Islame të Jugosllavisë së atëhershme, ishin dy krahët më të rëndësishëm, të themi ashtu, dhe ne i drejtoheshim njëri-tjetrit, pavarësisht nëse ishte Medreseja Gazi Husrev-beut në Sarajevë apo Medreseja Alauddin në Prishtinë, boshnjakët, të diplomuarit e Medresesë Gazi Husrev-beut, mund të regjistroheshin vetëm në Fakultetin në Prishtinë, në studimet e Orientalistikës dhe një numër i madh i të diplomuarve tanë të medresesë së Gazi Husrev-beut ishin regjistruar në Fakultetin në Prishtinë, dhe vëllezërit tanë nga Kosova, natyrisht, erdhën në Fakultetin e Shkencave Islame, pra në Fakultetin Teologjik Islam në Sarajevë në atë kohë.

Më duhet të them se, me shpërbërjen e Jugosllavisë, shumë donin t'i mbanin boshnjakët dhe shqiptarët larg, sa më larg njëri-tjetrit, dhe ne ishim, duhet të themi, në të gjitha pengesat që kishim kur bëhej fjalë për kontaktet tona, ajo lidhje u ruajt. Ne e ruajtëm atë lidhje dhe e mbartëm brenda nesh, sepse e kishim të njëjtin fat në këtë rajon, se shqiptarët dhe boshnjakët janë myslimanë në shumicë, të themi ashtu, dhe se ne i drejtohemi njëri-tjetrit.

Falë Zotit të Madhëruar, mund të themi se pas pavarësisë së Kosovës dhe, natyrisht, Bosnje dhe Hercegov-

Këtu dua të falënderoj kryeministrin e Kosovës që Kosova ka hequr vizat për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ne boshnjakët jemi veçanërisht të lumtur për këtë dhe shpresojmë që edhe Bosnja dhe Hercegovina të përgjigjet me të njëjtën masë.

inës, ne po ndërtojmë institucionet tona, por jemi të vetëdijshëm se duhet të bashkëpunojmë, dhe se është e nevojshme të vendosim marrëdhënie më të ngushta midis dy komuniteteve tona, pra Bashkësisë Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Bashkësisë Islame në Kosovë, sa më shpejtë të jetë e mundur, përmes lidhjeve tona institucionale, natyrisht, kur është në pyetje bashkëpunimi në çështjet fetare, duke pasur parasysh se ne të dy i përkasim, pra, medhhebit hanefi, akaidit maturidij, se kjo trashëgimi është e përbashkët për ne. Bashkësia Islame në Bosnjë e Hercegovinë ka shtëpinë e vet botuese “El Kalem”, Bashkësia Islame në Kosovë ka projekte të rëndësishme botuese, prapa të cilave qëndrojmë, dhe mendoj se mund të vazhdojmë falë Zotit.

Jam i lumtur dhe këtu dua të falënderoj kryeministrin e Kosovës që Kosova ka hequr vizat për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ne boshnjakët jemi veçanërisht të lumtur për këtë dhe shpresojmë që edhe Bosnja dhe Hercegovina të përgjigjet me të njëjtën masë.

Ne po përgatitemi, me dëshirë të Zotit, për të vizituar Kosovën, është dëshira ime të takohem me Myftiun Tërnavë në Prishtinë dhe thjesht të jemi në gjendje të flasim për çështje që janë të përbashkëta për ne.

Reis efendi, në Evropë po edhe në Ballkan, dekadave të fundit ka një fushatë mos durimi ndaj myslimanëve, respektivisht manifestohet ajo që njihet si “islamofobi”, cili është roli i bashkësive islame, prijësve fetarë dhe vetë besimtarëve në demaskimin e kësaj ndjesie?

Dr. Husein ef. Kavazoviq: Po, fatkeqësisht ne jemi, mund të themi, që nga shekulli XIX e tutje, të ekspozuar ndaj islamofobisë në këto rajone këtu, dhe vëllezërve tanë myslimanë shqiptarë dhe boshnjakë si myslimanë, ne e dimë se nga cilat qendra vjen vazhdimisht, pra, është krejtësisht e dukshme për ne, pasojat e kësaj islamofobie – urrejtja ndaj myslimanëve janë të dukshme, krimet që ndodhën këtu gjatë Luftës së Parë Ballkanike dhe Luftës së Dytë Ballkanike, veçanërisht në Kosovë, në mesin e popullsisë shqiptare, pati krime të mëdha që u kryen.

Në Luftën e Parë Botërore dhe Luftën e Dytë Botërore, pati edhe krime të mëdha të kryera edhe në njërin edhe anën tjetër.

Agresioni i fundit kundër Bosnjës dhe Hercegovinës, pastaj agresioni edhe në Kosovë, prandaj pasojat e islamofobisë janë të rënda, të themi ashtu, ajo është ende e pranishme, ne duhet të luftojmë së bashku, të tregojmë



se Islami nuk është kërcënim për askënd në këto rajone, popullsia islame gjithmonë ka siguruar mbrojtje. Osmanët kishin një karakter gjithëpërfshirës, ata përfshinin në shoqërinë e tyre edhe ata që nuk ishin myslimanë, një numër i madh jomyslimanësh mbanin poste në Perandorinë Osmane.

Përpjekja për të na portretizuar këtu si një rrezik për Evropën është ende e pranishme, prandaj është shumë e rëndësishme që shqiptarët dhe boshnjakët si kombe të vjetra evropiane, madje edhe shqiptarët si popull edhe më i vjetër se ata që tani po theksojnë evropianizimin e tyre, për të treguar se trashëgimia jonë është trashëgimi evropiane, se ky është Islami evropian. Islamofobia që po përhapet rreth myslimanëve, në fakt prapa saj janë projekte politike që thjesht do të donin të shihnin boshnjakët, shqiptarët dhe myslimanët e tjerë që janë këtu, t'i shohin kështu. Ne i pamë këto projekte në veprim në vitet e 90-a të shekullit të kaluar, nuk është e përjashtuar se ka plane të tilla edhe sot. Kuvendi gjithë-serb që u mbajt vitin e kaluar në Beograd, është sigurisht në gjurmët e politikës së madhe serbe, e cila është islamofobe në të njëjtën kohë, dhe ne sigurisht duhet ta marrim parasysh këtë, që kjo thjesht të jetë në fokusin tonë dhe në vëmendjen tonë.

Çka i ofrojnë shoqërisë evropiane popujt e vendeve tona, populli boshnjak dhe populli shqiptar?

Dr. Husein ef. Kavazović: Pra, ne vërtet ofrojmë, do të thosha, një kulturë të kthjellët dhe të hapur, e cila është integrative, që përfshin të gjitha ato vlera që erdhën këtu përmes Islamit, por kultura si e boshnjakëve, ashtu edhe e shqiptarëve, nuk është ekskluzivisht islame, edhe atë që ishte paraislame ne e kemi ruajtur, sikur shqiptarët në kulturën e tyre, ashtu edhe boshnjakët në kulturën e tyre, dhe atë e fisnikëruam me Islamit në një mënyrë, dhe treguam atë diversitet të Evropës.

Evropa mund të jetë gjithmonë krenare me myslimanët e saj, me kulturën e tyre, e cila sigurisht është në krye, të themi ashtu, për arritjet kulturore në fushat e këtushme, ashtu që edhe boshnjakët edhe shqiptarët sigurisht se kanë çka për t'i ofruar kulturës evropiane dhe për të zhvilluar më tej

këtë model, modelin mysliman – kulturën myslimane në Evropë, dhe kjo është pastaj një urë për lidhjen me botën myslimane që, disa thonë se sot në botë ka 2 miliardë myslimanë.

Jemi në prag të muajit të madhëruar Ramazan, cili është mesazhi juaj për këtë muaj, edhe për myslimanët në Bosnje, e edhe për myslimanët në Kosovë?

Dr. Husein ef. Kavazović: Ne jemi gjithmonë të lumtur për muajin Ramazan, është muaji i ripërtëritjes sonë shpirtërore, si për boshnjakët ashtu edhe për shqiptarët, është një muaj i shenjtë, pra muaji i shpalljes së Kuranit.

Ramazani na forcon në fenë tonë që më shumë dhe intensivisht të punojmë në qenien tonë shpirtërore, në matricën tonë shpirtërore. Kjo është një mundësi që të ketë një shkëmbim të lexuesve tanë të Kuranit. Ne folëm për këtë pak parëz në takimin tonë të përbashkët. Në të kaluarën, për shembull, hafëzët nga Maqedonia dhe Kosova vinin në Xhaminë e Gazi Husrev-beut, për të lexuar mukabelën në Sarajevë, mendoj se duhet ta rinovojmë këtë traditë. Deri para disa vitesh, në Xhaminë e Gazi Husrev-beut vinte një hafëz nga Maqedonia.

Unë besoj se muaji Ramazan është muaji i lidhjes sonë të ndërsjellë, se vaizët, p.sh. nga Kosova të vijnë në Bosnjë e Hercegovinë për të mbajtur vaze, dhe se vaizët tanë të shkojnë në Kosovë, për të vizituar xhematet, është e gjitha një mundësi për dy bashkësitë tona, dy popujt tanë, për t'u lidhur edhe më shumë dhe për t'u gërshtuar njëri me tjetrin kulturalisht. Mendoj se Ramazani mund të jetë një bazë e mirë për lidhjen tonë të mëtejshme.

Dua të shfrytëzoj rastin për të urrear të gjithë myslimanët në Kosovë për muajin Ramazan. I lutem Zotit të pranojë ibadetet e tyre, agjërimin, sadakatul-fitrin dhe gjithçka që bëjnë myslimanët gjatë Ramazanit dhe që, siç e kam thënë, duke ndarë një fat të përbashkët në tokën evropiane, boshnjakët dhe shqiptarët së bashku të marrin pjesë në ngritjen kulturore të njerëzve në Evropë dhe t'i njoftojnë evropianët me myslimanët e tyre.

Boshnjakët dhe shqiptarët janë myslimanë evropianë, kështu që ata janë pjesë e tokës evropiane, kontinentit evropian dhe ata duhet të kontribuojnë shumë për ta bërë Islamit më afër popullit, për të njohur më nga afër Islamit.

Ju faleminderit për kohën, intervistën dhe për mesazhet që na i dhatë në prag të muajit të madhëruar Ramazan.

Dr. Husein ef. Kavazović: Faleminderit dhe ju uroj gjithë të mirat. Edhe një herë, dua t'i përsërisht të gjithë në udhëheqësi të Bashkësisë Islame në Kosovë.

Faleminderit shumë!

Intervistoi: Ramadan Shkodra

Feja edhe brenda rrethojave të hekurta

• Granit Sadiku

Sa ka nevojë njeriu për fenë? Aq sa ka nevojë për shpirtin. Dhe pa shpirt nuk jetohet, ashtu siç nuk jetohet pa i përkitur dikujt, diçkaje. Parimisht, religjioni ekziston për t'i udhëzuar njerëzit drejt Zotit që ata zgjedhin t'i besojnë. Mirëpo, mundësia e udhëzimit i ka disa kushte preleminare, në të cilat jo çdokush mund të bëjë pjesë. Për shembull, çka do të mund të thoshim për një njeri që lind e rritet në një kulturë religjioze tjetër, ndërsa ai, me kalimin e kohës, nis të besojë diçka tjetër. Shpeshherë pyesim veten: nëse do të kisha lindur në Brazil apo në Vatikan, a do të isha akoma mysliman? Duke qenë besimtarë në "kada dhe kader", ne përgjigjemi: "Ai Zot që më ka bërë mysliman këtu do të më bënte edhe atje, ngase Toka është e Tij". Mirëpo shpesh harrohet se, në fakt, besimi ka të bëjë me vullnetin e lirë të individit, e jo me "përcaktimin". Kësisoj, vullneti i lirë manifestohet nga zemra dhe mendja (dëshira dhe logjika). Jo rastësisht çdo fe i ka predikuesit e saj, klerikët e thirrësit, ngase po të mos ishin ata, njerëzit do ta kishin shumë të vështirë që vetvetiu ta kuptonin realitetin thelbësor të besimit në Zot. Kështu pra, çdo fe, në çdo vend të botës, ka predikuesit e saj që e përhapin atë në format e tyre. Në fenë islame, meqë i Dërguari i fundit në mbarë njerëzimin ishte Muhamedi a.s., ishin dijetarët, daijët (thirrësit), hoxhallarët, etj., ata që e trasuan rrugën e tij në thirrjen islame. Në vendin tonë ka shumë hoxhallarë që e kryejnë misionin e tyre si shërbyes fetarë, dhe njerëzit e kanë shumë më të lehtë praktikimin e fesë duke ndjekur këshillat dhe mësimet e tyre.

Por, çka do të mund të thoshim për një shtresë të caktuar të njerëzve, që jo çdoherë ka mundësi të participojë në rite fetare, kohë namazesh, e manifestime të tjera?! Është fjala pikërisht për ata që i shërbejnë atdheut në shërbimin ushtarak dhe të cilët, siç dihet, ose janë në terrene të jashtme për manovra ushtarake, ose janë brenda në kazermë. Kësisoj, duke qenë se më lart u fol për nevojën e fesë e cila u barazua me nevojën për shpirt, duhet që medoemos të ketë forma adekuate të manifestimit të saj në strukturat e brendshme ushtarake.



Meqë prifti ose hoxha nga jashtë nuk mund të hyjë pa leje të veçantë brenda rrethojave të kazermave, atëherë në ushtri ekziston institucioni i veçantë i shërbesave fetare për ushtarakë, që është kapelania. Të gjithë ata që marrin pjesë funksionalisht në këtë institucion, quhen kapelanë ose ndihmës-kapelanë.

KAPELANIZMI

Dihet që jeta ushtarake dallon dukshëm prej asaj civile. Andaj, termet të cilat përdoren në sistemin e jetës ushtarake nuk mund të hasen të njëjtat edhe jashtë saj. Natyrisht, çdo ushtri e ka për obligim të kujdeset për shëndetin fizik dhe mental të ushtarakëve të saj. Kështu që, si rrjedhojë ushtria duhet të krijojë edhe kujdesin e saj për ushtarakët që janë fetarë dhe duan ta manifestojnë praktikën e tyre fetare. Në ushtri, meqë nuk mund të inkorporohen autoritete nga jeta civile e jashtme, duhet që të ketë autoritete të brendshme përkatëse. Pra, meqë prifti ose hoxha nga jashtë nuk mund të hyjë pa leje të veçantë brenda rrethojave të kazermave, atëherë në ushtri ekziston institucioni i veçantë i shërbesave fetare për ushtarakë, që është kapelania. Të gjithë ata që marrin pjesë funksionalisht në këtë institucion, quhen kapelanë ose ndihmës-kapelanë. Është jetike që çdo ushtarak ta ketë të rregulluar edhe jetën fetare brenda ushtrisë, ngase problemet e përditshme ushtarake janë jo çdoherë të lehta dhe të përshtatshme për t'u përballuar psikikisht. Roli i kapelanit në çdo ushtri vlerësohet shumë.

HISTORIA DHE TERMINOLOGJIA

Kur flasim për historinë e kapelanisë, duhet të nisemi nga legjenda e hershme kur për herë të parë u dëgjua ky term. Emri i perandorit romak, Konstandin i Madh, është i njohur në historinë botërore. Sidomos pjesa e biografemës së tij, që na tregon se gjenealogjia e tij ishte iliro-dardane. Në një nga invadimet ushtarake, njihet historia e një ushtari të tij që quhet Martin (më vonë Shën Martin), i cili shërbente pranë qytetit Amiens, që gjendet në pjesën veriore të Francës. Përgjatë lëvizjeve të tij,

Historikisht, ajo që figuron si fakt i dokumentuar është që kapelanizmi në ushtri fillon që nga data 29 korrik 1775, atëherë kur Kongresi Kontinental kishte caktuar nga një kapelan (përgjegjës për çështje të fesë) në secilin regjiment.

ai e kishte parë një të varfër në rrugë, i cili dridhej nga i ftohti. Dhe duke qenë kështu i prekur nga ajo situatë, ai kishte prerë gjysmën e mantelit të tij (që në latinisht quhej *cappa*) dhe ia kishte dhënë të varfrit që të mbështillej me të. Në mbrëmje, thuhet se kishte parë në ëndërr Jezu Krishtin, i cili i kishte thënë: “Atë që ke bërë për atë të varfër, e ke bërë për mua.”¹ Që nga ai moment, Martini ishte larguar nga ushtria dhe ishte bërë shërbëtor i Zotit. Duke qenë fetar i devotshëm në shërbimin ndaj kishës, ai e kishte fituar titullin “shenjt”. Andaj në histori njihet me emrin “Shën Martini”. Këtu mendohet se është përdorur për herë të parë termi kapelan, që rrjedh nga fjala *cappa*. Pra, sipas legjendës, kapelan quhet ai që e ka ndarë mantelin e vetë përgjysmë dhe ia ka dhënë atij që ka nevojë. Ndonëse si term tani ka tjetër kontekst, qëllimi i një kapelani vazhdon të mbetet i njëjti. Një kapelan duhet që të ndajë copa nga vetja, dhe t’ua dhurojë të tjerëve që kanë nevojë.

Historikisht, ajo që figuron si fakt i dokumentuar është që kapelanizmi në ushtri fillon që nga data 29 korrik 1775, atëherë kur Kongresi Kontinental kishte caktuar nga një kapelan (përgjegjës për çështje të fesë) në secilin regjiment.² Dhe kështu, kapelanët më nuk shiheshin thjesht si shërbyes fetarë, por kishin respektin e njëjtë me atë të gradës së kapitenit. Dhe kjo ndikoi pastaj që ata të mos shiheshin më vetëm si predikues fetarë të

jashtëm, por të ishin të pashkëputshëm nga trupat ushtarake. Dhe, siç mund ta vlerësojmë nga të dhënat historike, në vendin që një vit më vonë do të bëhej shtet i pavarur, ishte formuar instituti i kapelanisë. Pra para se të kishte ushtri të



rregullt në ShBA, u pa e arsyeshme që të rregullohej gjithsesi çështja fetare.

Dhe prej atëherë, nuk mbahet mend të ketë pasur ushtri pa kapelaninë e saj. Roli kyç i kapelanëve, për të cilën ata vlerësohen tej mase, është ndikimi i tyre në aspektin psikologjik të ushtarëve. Kapelanët në kohën e tashme, e kanë për detyrë që të bëjnë ligjërata, evente, bashkëbisedime e ndeja të vazhdueshme me ushtarakët, në mënyrë që t'i njohin nga afër problemet e tyre dhe të kenë mundësi t'i zgjidhin ato. Kështu pra e shohim se dalëngadalë, nga predikuesi fetar, kapelani luan rolin e psikologut. Ushtarakët shkojnë te kapelani, i rrëfejnë atij për problemet e tyre të ndryshme familjare, jetësore, ushtarake, etj., dhe kapelani në rolin e këshilluesit me konfidencialitet besnik, trajton me kujdes problemet e tyre. Jeta ushtarake përfshin aktivitetin fizik, rojën e obliguar në një pikë të caktuar (qoftë rojë statike, apo lëvizëse), trajnimet brenda dhe jashtë vendit, zbarkimet në baza ushtarake të jashtme për muaj të tërë, sforcime të rënda fizike dhe psikike, apo më e keqja në disa ushtri të botës edhe lufta. Dhe këto aktivitete të shumta, herë pas here lënë pasojë në psikikën e ushtarakëve. Statistikat e institucioneve përkatëse për vlerësimin e shëndetit mental të ushtarakëve, tregojnë që numri i vetëvrasje në ushtri të ndryshme të botës rritet sidomos pas kthimit nga zonat e luftës. Në një studim për çështjet që nxisin vetëvrasjet e veteranëve të luftës, thuhet që në bazë të statistikave të vitit 2021, afro 30 mijë e 177 personel aktiv ushtarak që kanë shërbyer në ushtri pas ngjarjes së 11 shtatorit, kanë kryer vetëvrasje.³

Ky fakt, që për të gjitha instancat ushtarake është tejet shqetësues, për kapelanët kthehet në mision të veçantë mbrojtës. Kapelani ka obligim moral që herëpashershem të mbajë ligjërata për mënyrat se si duhet të mbrohet një ushtarak nga rrugët që e çojnë atë në vetëvrasje. Dhe duke e bërë këtë, ai bëhet akter shumë i rëndësishëm i mirëqenies kolektive ushtarake, duke manifestuar perspektivitetin dhe duke anatemuar dhunën psikike që mund të zhvillohet nga jashtë ose nga brenda në personalitetin e ushtarakut.

“TË GJITHË PËR NJË, NJË PËR TË GJITHË”

Më shumë se në ushtri, kjo moto është dëgjuar edhe në shumë vende të tjera, lloj-lloj ambientesh kolektive. Në rastin e kapelanisë, është shumë e rëndësishme të potencohet se kjo moto është vlera e parë qendrore në funksionalizmin e një kapelanie. Zoti i Madhërisëm, në Kuran na e ka paraqitur funksionin e gjallë të kësaj motoje, duke e paraqitur atë në një lloj imperativi të funksionimit të jetës së besimtarëve. Në

Misioni i një kapelani është që asnjëherë të mos e braktisë të dobëtin.

suren El Huxhurat, në ajetin e 10-të, Zoti thotë: “Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër.”

Parimi i unifikimit në Islam afrohet akoma më shumë, pra cilësohet si vëllazërim. Vëllazërimi këtu, siç keqkuptohet shpesh me tendencë, nuk ka të bëjë me aspektin biologjik. Por, është një lloj besëlidhje mes besimtarëve për të qenë “të gjithë për një, një për të gjithë”. Misioni i një kapelani është që asnjëherë të mos e braktisë të dobëtin. Në ushtri hasen njerëz që kanë probleme më të thella psikologjike sesa që mund të hasen jashtë ushtrisë. Për shembull, çka do të mund t'i thoshte një kapelan një ushtaraku që gjendet për nëntë muaj jashtë shtetit në mision paqeruajtës, dhe i drejtohet atij duke i shpërfaqur dyshime se po e tradhton grua! Apo, nëse një tjetër vjen dhe qan me dënësë para tij teksa i tregon se si e ka parë shokun t'i vritet para syve, dhe nuk ka mundur të bëjë asgjë për ta mbrojtur!

Në raste si këto, kapelani vihet në pozitë tejet të vështirë. Po të ishte kapelani një shërbyes fetar i ardhur nga jashtë, do të ulej dukshëm konfidenca e ushtarakëve ndaj tij. Mirëpo, meqenëse kapelani mban të njëjtën uniformë me ushtarakët e tjerë, atëherë ushtarakët ndihen shumë më të lirë për t'i shpalosur problemet e tyre. Në raste të ndjeshme si këto, kur problemi është i theksuar e i shtresuar prej kohësh, duhet që gjithmonë të afrohen ushtarakët me parmin se të gjithë janë njësoj. Askush në botë nuk është pa probleme, pa dyshime, pa mendime të këqija. Mirëpo, Zoti i ka ndarë njerëzit në shtete e kombe të ndryshme për t'u bashkuar. Dhe vetëm duke qenë të bashkuar, krijohet ndjenja e empatisë së përbashkët ushtarake, kur asgjë nuk merret me qëllim të përqeshjes por problemet e ndërsjella trajtohen me butësi e mirësi.

Në raste si këto, kur ushtarakut i duhet pranë vëllai, i gjendet pranë kapelani. Kur i duhet pranë babai, i gjendet kapelani. Kur i duhet miku, fqinji, kushëriri, etj., gjithmonë aty për të do të jetë kapelani. Nëse ushtaraku i përket fesë islame, që është përkatësi dominante në shtetin tonë e si rrjedhojë dominante edhe në ushtri, atëherë kapelani duhet ta këshillojë ushtarakun me këshilla nga ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit, a.s.. Duke ia rikujtuar ngjarjet nga jeta e Muhamedit a.s., dhe duke e këshilluar me këshilla e duhura fetare, kapelani e zëvendëson imamin që ushtaraku do ta ndiqte në kushte normale po të ishte jashtë ushtrisë. Mirëpo, ajo që kërkohet zakonisht në raste të tilla është dëgjimi më shumë sesa këshillimi. Një e tretë e mllëfit apo stresit të akumuluar, nxirret jashtë kur njeriu e plason atë përmes bisedës më dikë. Prandaj, kush e ka thënë bukur e ka thënë që psikoterapeuti më i mirë është ai që, thjesht, di të dëgjojë.

AUTORITETI I KAPELANIT NË MBAJTJEN E INFORMATAVE

Nga se u tha më lart, u pa se kapelanët janë pjesë e strukturave ushtarake. Ata janë të uniformuar, dhe kanë shenja dalluese në mënyrë që të dallohen se janë kapelanë. Grada që zakonisht mban titullin e kapelanit, në ushtrinë amerikane për shembull, është grada major. Duke qenë kapelan, pra duke i përkultur një institucioni të veçantë brenda ushtrisë, një kapelan nuk mund të gradohet më tutje në gradat ushtarake, por kompetencat e tij përfshijnë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me mirëqenien kolektive.

Çdo ushtarak që shfaq para një kapelani problemet e tij, duhet të ndjehet i sigurt se ato informata do të mbeten në konfidencë dhe assesit nuk do të përhapën. Është vetëm një qëllim që arsyetën shpalosjen e informatave të dhëna nga ushtaraku. Në rast se një kapelan e vëren që në bazë të problemeve psikike të një ushtaraku rrezikohet vetëvrasja, atëherë kjo çështje duhet të diskutohet me strukturat përgjegjëse të zinxhirit ushtarak komandues të tij, dhe të merren masa paraprake preventive. Ngase në këtë rast, po të mos zbulohet informata e dhënë ndaj kapelanit, atëherë do të mund të ndodhte më e keqja, dhe kapelani të bënte pjesë në këtë faj.

Për sa u përket aspekteve të tjera, autoriteti i një kapelani në ushtri është i padiskutueshëm. Në asnjë ushtri nuk i lejohet një grade, edhe po të jetë gjeneral ai, që të shpalosë informatat e dhëna e të dokumentuara nga kapelani.⁴ Pikërisht ky tretman që i bëhet një kapelani, e rregullon në të mirë jetën ushtarake. Ngase kështu ushtarakët krijojnë një botë të dytë, një lloj familje ku nuk kërkohet thjesht puna dhe përkushtimi, por jepet hapësira për t'i shpalosur ndjenjat dhe problemet e brendshme.

PSE KAPELANËT JANË USHTARAKË PA ARMË NË LUFTË?!

Kapelanët e kanë të ndaluar bartjen e armëve dhe qasjen në to. Për mbrojtjen e kapelanit zakonisht angazhohet një ndihmës-kapelan, i rangut të nënoficerëve, i cili lejohet që të mbajë armë për rastet kur mund të kanoset rreziku. Ndërsa kapelani, edhe në rast lufte ndalohet që të jetë i armatosur. Arsyeja pse ndodh kjo merret me mend. Duke qenë kapelani shërbyes i Zotit brenda ushtrisë, dhe duke qenë kujdestar i aspektit shpirtëror të besimit të ushtarakëve, do të ishte krejt jopaqësore që ai të bartte armë. Ky është pra njëri aspekt se pse një kapelan nuk duhet të bartë armë brezi, apo krahu, apo çfarëdo lloj arme tjetër.

Si kusht kryesor i një ushtrie që mëton të futet në NATO, është padyshim edhe formimi i institucionit të kapelanisë brenda saj. Një ushtri pa kapelani është një ushtri pa mekanizëm mbrojtës.



Aspekti tjetër është qetësia psikologjike e tij. Një njeri që predikon fenë, duhet që patjetër të jetë shumë i qetë për nga aspekti nervor. Njerëzit neurotikë që nuk mund ta tejkalojnë egon e tyre të dhunës, nuk mundin të jenë interpretues e shpjegues të duhur të fesë. Parafytyrojeni një kapelan që del para ushtarakëve të flasë për kuptimin e emrit islam (që do të thotë paqe) dhe vetë të tregohet i dhunshëm përballë tyre, nga traumat psikologjike që mund t'i ketë fituar në betejat të ndryshme. Prandaj, kapelani i duhet ushtrisë i paimvolved në luftë, ngase roli i tij është mirëqenia psikologjike e atyre që marrin pjesë në të.

Në Konventën e Gjenevës (1949), përcaktohet qartë se vrasja e një kapelani në luftë është e ndaluar. Dhe, brenda Konventës ka nene të veçanta që determinojnë kompetencat e atyre që zënë kapelanë si robër lufte. Kapelanit, edhe si i zënë rob, duhet t'i lejohet këshillimi me ushtarët e tij, t'i lejohet komunikimi në çdo mënyrë, madje edhe përmes dërgimit të letrave.⁵ Liria e besimit nuk mund të kufizohet as atëherë kur kufizohet liria e lëvizjes dhe veprimit.

PSE NJË SHTET LAIK DUHET TË KETË NË USHTRINË E SAJ PATJETËR KAPELANI?

Disa zëra (të parëndësishëm) brenda Kosovës, kanë ngritur së fundmi çështjen se si mund të ekzistojë kapelania brenda një institucioni laik në një shtet laik, kur dihet se cili është qëndrimi i tij përballë fesë. Sipas tyre, që djallëzisht ngritin

“pluhura” të tillë, nëse nuk ka shtet islam atëherë nuk mund të ketë as institucion fetar brenda ushtrisë. Këta njerëz dihet se janë të brumosur me frymën komuniste marksiste-leniniste, e cila fenë e konsideronte opium. Mirëpo, duhet që dikush t’ua japë lajmin e keq (për ta) që Kosova nuk anon nga shtetet komuniste, por është e orientuar drejt Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit në NATO.

Si kusht kryesor i një ushtrie që mëton të futet në NATO, është padyshim edhe formimi i institucionit të kapelanisë brenda saj. Një ushtri pa kapelani është një ushtri pa mekanizëm mbrojtës. Ushtritë e NATO-s, në krye me atë amerikane, e kanë vërejtur qysh herët rëndësinë e posedimit të institucionit të kapelanisë brenda një ushtrie. A nuk e dinë ato domethënien e laicizmit?! A nuk ishin të orientuara qysh para nesh drejt tij?! Laicizmi nuk presupozon ateizëm, por thjesht ndarje të shtetit nga feja. Ndarja nga feja, në mënyrë bazike, nuk ka të bëjë aspak me mospraktikimin e fesë në instancat udhëheqëse. Laicizmi presupozon që akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës të jetë kushtetuta, e jo sheriat. Mirëpo, kjo aspak nuk do të thotë që, ligjërisht, kryeministrit i ndalohej falja e namazit apo agjërimi. Andaj, edhe institucioni i kapelanisë brendapërbrenda ushtrisë nuk do të thotë se kemi të bëjmë me ushtri islame, por do të thotë se kemi të bëjmë me ushtarë myslimanë, apo në qofshin edhe katolikë, ortodoksë e protestanë.

Mllef i ndaj Islamit ka bërë që shpesh emri i tij të inkriminohet në rrethana e histori të caktuara, të cilat kanë qenë jo të lehta për t’u tejkaluar. Kemi provuar propagandën për ISIS-in, kemi provuar propagandën për Al Kaidën më herët, e do të provojmë gjithmonë kesi lloj propagandash me kesi lloj pretendimesh. Mirëpo, asnjëherë nuk do të mund të zbehet kuptimi i parë dhe i vërtetë i emrit Islam, që do të thotë paqe. Dhe me këto pretendime, ka stagnuar gjithmonë themelimi i institucionit të kapelanisë brenda ushtrisë.

Kapelanian ka rol shumë të rëndësishëm, sidomos në një ushtri që i përket orientimit laik. Ngase, është e vetmja formë që ushtarët kanë mundësi ta manifestojnë lirinë e besimit të tyre, dhe ta kenë fare pranë afër predikuesin fetar përkatës. Kapelanët janë prej asaj ushtrie, dhe duhet që secili besim brenda ushtrisë të ketë kapelanët e veçantë. Në këtë formë, duke pasur mundësinë çdo ushtarak që ta ketë afër kapelanin e fesë së tij përkatëse, apo edhe nëse nuk beson fare në Zot, prapë ta ketë mundësinë e këshillimit me kapelanin, jeta ushtarake lehtësohet shumë dhe përmirësohet aspekti psikik i ushtarakëve.

SI DO TË NDIKONTE NDALIMI I FESË NË NJË AMBIENT TË RRETHUAR ME TELA?

Në ushtritë komuniste feja ishte e ndaluar. Asnjë besimtar nuk i lejohej manifestimi i religjionit të tij. Ata që kanë përfunduar shërbimin ushtarak në Shqipëri (me theks të veçantë) dhe Jugosllavi, e dinë se obligoheshin që të pinin ujë gjatë ditëve të muajit Ramazan, vetëm që dhunshëm atyre t’u

prishej agjërimi. Ata proklamoni se “nuk ka Zot brenda kazermës”. Dhe ky mendim, fatkeqësisht evident edhe në ditët e sotme, ka pasur ndikim shumë të keq dhe të rëndë.

Secili ushtarak duhet të jetë i motivuar dhe i gatshëm t’i shërbejë atdheut në çdo kohë. Vetë fryma ushtarake kërkon guxim, vetëbesim e karakter të fortë. Të gjitha këto veçori në i kemi të porositura nga Islami, dhe kështu kapelanët nuk do të kërkonin gjë tjetër pos brumosjen e ushtarakëve me këto parime të shëndosha. Nga historitë që dihen me ish-ushtarakët e vendeve që ishin komuniste, mund të thuhet që ata kanë devijuar më së keqi atëherë kur e kanë braktisur ushtrinë. Qarkullojnë shumë libra, këngë e filma, që tregojnë histori se si ish-ushtaraku bëhet mercenar dhe e jeton jetën e tij deri në fund si kriminel. Karakteri i guximshëm i përket njësoj si një kriminel si një ushtarak apo polici. Ajo që përbën dallim mes tyre është motivi se nga orientohet ai karakter. Përderisa kriminel përdor armën për të bërë krime, polici e ushtari e përdorin armën për t’i ndaluar krimet. Mirëpo, shumë lehtë një ushtarak që nuk e ka formimin e duhur religjioz, besimtar apo thjesht human, mund të kthehet pas mbarimit të karrierës ushtarake në kriminel që i bën dëm interesit shtetëror. Në këtë plan, duhet të themi se është jetike që të funksionojë institucioni i kapelanisë brenda një ushtrie, ngase është mjeti më i fuqishëm sensibilizues i ushtarakëve për të qëndruar një vijën e rendit dhe rregullit.

Ambientet e rrethuara me tela (kazermat ushtarake) krijojnë vetvetiu një zymtësi të izolimit. Duke qenë një ushtarak i izoluar, detyrohet që të udhëhiqet nga motivet e tij të larta për të vazhduar tutje. Për një ushtarak të suksesshëm, motivimi është gjithçka. E po qe se nuk do ta kishte motivimin, atëherë qëndrimi në ushtri nuk do të sillte sukses as për të, as për vendin e tij. Do të bëhej qëndrim torturues. Motivi më i madh që e mban njeriun në jetë përballë sfidave, dhe ushtarakun të motivuar brenda ambientit të rrethuar me tela, është padyshim lidhja vertikale njeri-Zot.

Referenca:

- <https://armyhistory.org/u-s-army-chaplain-corps/>
- <https://missionrollcall.org/veteran-voices/articles/the-state-of-veteran-suicide/>
- <https://ihl-databases.icrc.org/en/ihl-treaties/gcii-1949>
- 1 Referencë marrë nga interneti, linku: <https://armyhistory.org/u-s-army-chaplain-corps/>
- 2 Po aty.
- 3 <https://missionrollcall.org/veteran-voices/articles/the-state-of-veteran-suicide/>
- 4 Përveç rasteve kur është thyer ligji dhe, kuptohet, kapelani obligohet ta paraqesë të vërtetën në shesh. Për shembull, nuk vlen parimi i konfidencialitetit kur një ushtarak mund t’i rrëfëhet kapelanit të tij për ndonjë plagosje apo vrasje që ai mund ta ketë bërë. Ngase vepra e tillë është e dënueshme, dhe po të mos raportohet do të konsiderohej se janë të dy bashkëpunëtorë në krim.
- 5 <https://ihl-databases.icrc.org/en/ihl-treaties/gcii-1949>.



Poeti i madh islam me zemër shqiptare

• Mr.Besnik Jaha

Letërsia nuk është vetëm një art i fjalës së bukur, por është edhe një forcë që e sfidon frikën dhe e nxit ndryshimin. Historia ka njohur shumë shkrimtarë që me veprat e tyre kanë guxuar të prekin tema të ndaluara, ta kritikojnë padrejtësitë dhe të frymëzojnë breza të tërë me mendimin e tyre të lirë e për lirinë.

Jo të gjithë kanë guxim të shkruajnë. Të shkruash është një akt guximi. Shkrimi, veçanërisht letërsia, është një përpjekje për t'i kthyer në mendime të organizuara, në akte veprimi mendimet dhe emocionet, për t'i konkretizuar ato që nuk thuhet lehtë, për t'i sfiduar konvencionet dhe për të lënë një gjurmë në kohë. Ata që shkruajnë nuk janë thjesht kronistë-përshkrues të kohës. Shkrimi është ai që i bën të përtëjkohshëm; të jetojnë edhe pas vdekjes; të përmenden edhe pas gati një shekull kalimi në botën tjetër, siç po bëjmë edhe ne këtu.

Letërsia nuk është vetëm një art i fjalës së bukur, por është edhe një forcë që e sfidon frikën dhe e nxit ndryshimin. Historia ka njohur shumë shkrimtarë që me veprat e tyre kanë guxuar të prekin tema të ndaluara, ta kritikojnë padrejtësitë dhe të frymëzojnë breza të tërë me mendimin e tyre të lirë e për lirinë. Përmes ligjërimit të tyre, kredos së pathyer e stoicizmit shembullor, po edhe vargut të fuqishëm poetik, shumë figura janë bërë frymëzim për sa e sa zemra, për sa e sa kohë. Dhe sidomos poezia, që sikurse e vogla ndikon tek e madhja, sikurse një person që frymëzon masën, ashtu edhe ajo, mrekullisht, me pak fjalë dhe me formë të fuqishme, mund të ngërthejë frymëzim për një revolucion, mund ta bartë peshën e një epoke.

Një shembull i jashtëzakonshëm i guximit, në jetë dhe në letërsi, është edhe Mehmet Akif Ersoy, një poet që me fjalën e tij nuk kërkoj vetëm pasqyrimin e realitetit, por edhe

zgjimin e ndërgjegjes kolektive. Poezia e tij është e mbushur me forcë dhe ndjenjë, ndërsa është e frymëzuar nga ndershmëria, nga atdhedashuria dhe nga përkushtimi ndaj drejtësisë, motive këto që i përshkon fund e krye sidomos te poezia “*Haku triumfon*”.

Në një kohë kur deklarimi i së vërtetës mund të sillte pasoja të rënda, ai e ngriti zërin pa frikë dhe e përdori poezinë si një armë të shpirtit, pavarësisht nga pasojat. Sepse frymëzohej thellë nga besimi në Hakun. Sepse nuk dorëzohej kurrë në



fronti, siç thotë te poezia “Unitet”: *Edhe bota po të shembet krejt (...) ky front nuk njeh dorëzim.*

Po ta lexojmë poezinë e Mehmet Akifit, edhe sot e ndiejmë atë shpirtin e guximshëm dhe revolucionar; atë shpirtin që i rri përballë padrejtësisë deri në vetëmohim. Prandaj edhe sot, poezia e tij ka ndikim dhe është e rëndësishme, pasi na edukon me një frymë guximi dhe qëndrese. Për një istikamllëk të pashembullt. Vargjet e tij nuk janë thjesht kujtime të një kohe të kaluar, por janë mesazhe të fuqishme për kohën kur u shkruan dhe për të ardhmen, sepse na mësojnë se të shkruash është një përgjegjësi dhe një sfidë, dhe se fjalët e kanë atë fuqinë t'i lëkundin edhe malet, t'i ndriçojnë edhe zemrat.

Në fund të fundit, letërsia është një udhëtim kah e panjohura, një përballje me vetveten dhe me shoqërinë. Pra, të shkruash është mos të heshtësh, mos të dorëzohesh përballë errësirës, por të kërkossh dritë në çdo situatë. Të shkruash është të kesh guxim të kërkossh dhe të luftosh për drejtësi, në çdo rrethanë. Pikërisht ky është guximi i vërtetë i letërsisë: ta thuash të vërtetën edhe kur ajo dhemb, të frymëzosh edhe kur shpresa është e zbehtë, të kesh istikam-të qëndrosh besnik dhe i drejtë, siç thotë Mehmet Akifi në poezinë “Dëshmorët e Çanekalasë”, edhe kur *përballë të qëndrojnë shtatë vatrat e dynjasë*¹.

Vepra e Mehmet Akifit në shqip, “Shqipëria po digjet”, është me rëndësi të përmendim se shpreh edhe personalitetin e tij, sidomos polidimensionalitetin e tij, pra, nga polise-mantika që reflekton nga teksti i tij letrar. Sepse, të pakta janë veprat që kaq thellë përmbledhin frymën e shqetësimit kombëtar, reflektimin filozofik, polivalencën sociale dhe thellësinë shpirtërore, pa harruar edhe dhimbjen e një shpirti të mërguar (siç e kuptojmë nga letrat e tij të shkruara nga Egjipti për pjesën e familjes që kishte mbetur në Turqi, e të cilat tashmë mund të lexohen edhe në shqip, në librin “*Letra nga mërgimi*”).

Mehmet Akifi është i njohur kryesisht për veprën e tij monumentale poetike, “Safahat”, e cila përbën një cikël me shtatë libra, 108 poezi apo 11240 vargje, ku ai paraqet realitetin e shoqërisë osmane në kohë krize, shqetësimet morale dhe fetare, si dhe ndjenjat e një atdhetari të përkushtuar. Poetika e Mehmet Akifit karakterizohet nga një gjuhë e fuqishme, me tendencë për të qenë universale, plot ngarkesë emocionale dhe me retorikë të

Leximi i
veprës së
Akifit në
gjuhën shqipe
është edhe një
hap i
rëndësishëm
për njohjen
më të thellë të
trashëgimisë
letrare të
Mehmet Akif
Ersoy-it, të një
eruditi me
gjak shqiptari,
të cilin
shqiptaria nuk
e çmoi kurrë
aq sa e
meritonte.



lartë, që synon jo vetëm pasqyrimin e realitetit, por edhe nxitjen e një reflektimi dhe një angazhimi. Poemat e tij kanë një strukturë narrative të spikatur, ndërsa poeti shpesh përdor edhe një gjuhë të thjeshtë, megjithëse të mbushur me mesazhe të thella etike dhe sociale.

Në përmbledhjen poetike “Shqipëria po digjet” mund të vërejmë se si ndjenja e atdhedashurisë për Shqipërinë është e ndërthurur me dhembjen dhe revoltën për fatin e saj. Akifi e sheh Shqipërinë si një pjesë të pandarë të botës së tij shpirtërore dhe kulturore, dhe vargjet e tij janë të mbushura me një mall të thellë për drejtësinë e munguar për vendlindjen e babait. Në këtë vepër, ai shpreh shqetësimin për degradimin moral dhe politik, krizat e mëdha të fillimshkullit, luftërat në të katër anët dhe padrejtësitë ndaj popullsisë myslimane. Gjithsesi, lapsi i tij i



mprehtë ashpër e godet edhe indiferencën dhe neglizhencës ndaj fateve të kombeve të vogla, padrejtësisë ndaj tyre, dhe sidomos kanunin primitiv që po vendosej në botë, se ligjin e bën vetëm i forti. Në tri pjesët e saj, “Këngë për luftën dhe atdheun”; “Poezi shpirtërore”, dhe; “Fragmente poetike”, lexuesi do ta njohë Akifin në tri pjesët kryesore të jetës dhe të aktivitetit të tij intelektual: si frymëzues dhe atdhetar; si fetar dhe besimtar i devotshëm, dhe; si intelektual aktiv. Të njohura janë shumica e poezive të Akifit që lidhen me okazionalitete, sikurse poezitë nga pjesa e parë: “Kënga e luftës”, që buron nga Luftërat Ballkanike; “Zgjohu”, që buron nga Lufta e Parë Botërore; “Marshi i Pavarësisë”, që buron nga Lufta për Pavarësi etj., apo poezitë me të cilat vajtonte fatin e hidhur të popullit shqiptar, sikurse te poezia “Shqipëria po digjet”, apo “Dëshmorët e Çanekalasë”. Siç theksohet edhe në parathënie, pjesa e parë e librit është me poezitë më të njohura të Akifit, poezitë me motive atdhetare; pjesa e dytë me poezi të motiveve shpirtërore, dhe; pjesa e tretë me poezi të paspecifikuara në temë.

Poezia e Mehmet Akifit, në varg metrikisht të rregullt, kryesisht në *rrubai*-katrenë, dhe kryesisht në 12 ose 16 rrokësh, prerë me cezurë, rregulluar zakonisht në stilin oriental *aruz*, po edhe në *dubejt*-dyvargësh, apo në *musedes-gjashtëvargësh* e *musemen*-tetëvargësh, herë është refleksion narrativ, herë është reflektim didaktik, e herë-herë edhe thumbim i hollë satirik. Në përgjithësi, aspekti figurativ, artistik-letrar dhe leksikor i veprës së Mehmet Akifit janë tiparet më të spikatura të krijimtarisë së tij. Ai përdor metafora të fuqishme dhe simbole për të përçuar ndjenja të thella. Përmes kontrasteve të forta midis dritës dhe errësirës,

të mirës dhe të keqes, Akifi arrin të krijojë një atmosferë të mbushur me dramaticitet dhe patos. Personifikimi është një tjetër figurë stilistike që ai përdor me mjeshtëri, ku atdheu apo kombi shfaqen si qenie të gjalla që ndjejnë dhimbje, derdhin lot dhe pësojnë vuajtje. Gjithashtu, ritmi i vargjeve të tij shpesh është i gjallë dhe ngacmues, duke krijuar një ndjesi urgjence dhe një nevojë për veprim, e që kur lexohet ndihet e gjallë edhe sot, edhe pas një shekulli.

Ndikimi i Mehmet Akifit, edhe në letërsinë shqipe, është i vërejtur, edhe pse jo shumë, për shkak të ndërrimeve politike që ndodhën në Ballkan më vonë. Megjithatë, përkthimi i veprave të tij sjell për lexuesin shqiptar jo vetëm një figurë të rëndësishme të letërsisë turke dhe islame, por edhe një poet me ndjenja të thella për Shqipërinë, po edhe për të gjitha kombet e vuajtura të kohës së tij. Stilistika e tij, që ndërthur narracionin poetik me filozofinë morale, e bën Akifin një poet okazional, që nuk i shmanget realitetit, mirëpo e përballon atë me guxim, ndershmëri dhe stoicizëm.

Leximi i veprës së Akifit në gjuhën shqipe është edhe një hap i rëndësishëm për njohjen më të thellë të trashëgimisë letrare të Mehmet Akif Ersoy-it, të një eruditi me gjak shqiptar, të cilin shqiptaria nuk e çmoi kurrë aq sa e meritonte. Vepra e tij në shqip tanimë sikur na e lidh hallkën e këputur të zinxhirit kulturor të traditës sonë shqiptare dhe asaj osmane, nëpërmjet një poeti që i përket gjithë botës islame, por që në gjoksin e tij ka pasur një zemër shqiptare.

1 Mehmet Akif Ersoy, “Shqipëria po digjet”, A Publishing, Prishtinë, 2024, f. 23.

Hafëz Ibrahim Dalliu - përkthyes dhe komentues i Kuranit

• Dr. Azmir Jusufi

JETËSHKRIM I SHKURTËR I HAFËZ IBRAHIM DALLIUT (1878-1952)

Ibrahim Dalliu lindi në vitin 1878 në një familje tiranase, dhe që në rininë e hershme u dallua për aftësitë e tij intelektuale. I ati i hafëz Ibrahimit, Mustafa, ishte fetar me titullin hoxhë, hafëz, ku qe kujdesur edhe për djemtë e tij që t'i jepte këtë kulturë. Kështu të bijtë, Hysni dhe Aliu kishin marrë titullin haxhi hafëzë të Kuranit.¹

Pasi mbaroi shkollën “Ruzhdije” në vendlindje, në moshën 17 vjeçare shkoi për të vazhduar studimet në Stamboll, ku u pajis me kulturë të gjerë e të gjithanshme.² Ai ishte teolog, përkthyes, poet, publicist, mësues dhe aktivist shqiptar.

Në këtë drejtim, Dalliu mendonte se funksionarët e xhamisë dhe të gjithë besimtarët myslimanë kishin nevojë të menjëhershme për literaturë fetare në gjuhën shqipe, prandaj sapo u kthye në atdhe, mori përsipër detyrën e mësuesit në një nga shkollat e para të Tiranës (1901), së bashku me Filip Ashikun dhe Hoxhë Voglin, me gjithë vështirësitë e shumta e pa u shkëputur nga detyra e imamit në faltet e qytetit, ku më 1908 ai hapi shkollën e vajzave në Tiranë, ku u përgatitën mësueset e para vajza myslimane.³


Hafëz Ibrahim Dalliu lirisht mund të konsiderohet si njëri nga punëtorët shkencor dhe teologët më të njohur të asaj kohe si për

Hafëz Ibrahim Dalliu lirisht mund të konsiderohet si njëri nga punëtorët shkencor dhe teologët më të njohur të asaj kohe si për nga shkrimet, po ashtu edhe për nga ligjërimet e shumta.



nga shkrimet, po ashtu edhe për nga ligjërimet e shumta.⁴

Hafëz Ibrahim Dalliu bën pjesë në plejadën e atyre teologëve shqiptarë, të cilët janë dalluar me punën e tyre të frytshme fetare e kulturore. Nëse i bëjmë një vështrim kohës se kur ka jetuar dhe vepruar ai, mund të vërejmë se në shkrimet e tij ndjehet ndikimi dhe hovi reformator, me çka lirisht mund ta radhisim në mesin e ithtarëve të rrymës reformuese, e cila në literaturën islame njihet me termin “*islah*”. Në botën islame në këtë kohë vërehet veprimtaria e emrave eminentë të historisë islame, siç janë Xhemaludin Afgani, Reshid



Rida, Muhamed Abduhu, Muhamed el Behij, Ahmed Han, Muhamed Vehbi, Mehmet Akif Ersoj, etj., shumica prej të cilëve janë marrë me komentimin e Kuranit. Sa u përket emrave të cilët kanë zënë vend të posaçëm në hapësirën tonë, sidomos në Bosnje dhe të hapësira shqiptare, mund t'i përmendim Shukrija Alagiqin, Muhamed Tufon, Xhemaludin Çausheviqin, Mehmed Hanxhiqin, etj.⁵

HAFËZ IBRAHIM DALLIU SI PËRKTHYES I KURANIT

Kur flasim për përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe dhe për hafëz Ibrahim Dalliu si përkthyes, duhet ta kemi parasysh faktin se ai është shkolluar në shkollat teologjike islame, që d.m.th., ka mësuar arabishten, e natyrisht edhe osmanishten, fakt që dëshmon se ky përkthim është bërë nga origjinali në arabisht.⁶

Dalliu si autor i përkthimit të Kuranit, mbart vlera të veçanta, sepse e botoi në një kohë kur ndjehej mungesa e një përkthimi zyrtar të Kuranit. Ai e gjen edhe miratimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të asaj kohe ku thuhet: “U lexua, u shqyrtua e u pëlqye prej Këshillit të Naltë të Sheriatit”, dhe u botua në shtypshkronjën “Ora” të Shkodrës në vitin 1929.

Hafëz Ibrahim Dalliu, në parathënien e përkthimit dhe interpretimit të Kuranit, ndër të tjerash thotë: “Do ta ndërrojë metodën e

përkthimit vetëm për hir të atyre myslimanëve shqiptarë, të cilët nuk i dinë shkronjat e gjuhës arabe, ashtu që edhe ata të mos mbeten “gojëthatë”, duke filluar të japë dhe transkriptimin e ajeteve me germa shqipe”. Për këtë ai përpiloi dhe njëloj tabele se si lexohen shkronjat kuranore në shqip.⁷

Hafëz Dalliu merr përsipër përkthimin dhe komentimin e Kuranit, ku bëhet vepra e parë e këtij lloji në hapësirën shqiptare. Sipas tij, është detyrë fetare që Kurani t'i përkthehet secilit në gjuhën që flet, e që kjo ka qenë e lejuar qysh në kohën e Muhamedit a.s..

Kurani nuk përkthehet fjalë për fjalë, sepse secila fjalë ka kuptimet e veta të brendshme, si alegori, aludime dhe sinjalizime. Ka fjalë të përbashkëta që kanë shumë kuptime, por përgjithësisht fjalët kuranore përmbajnë mrekulli. Mbi këto baza hafëz Dalliu ka bërë përkthimin dhe interpretimin duke krahasuar kohën në të cilën jetoi me të shkuarën e largët, për të bërë të mundur aktualizimin e problemeve. Ai e ka paraqitur komentimin e Kuranit në bazë të thellimit të problematikës sipas përvojës dhe traditës, t'i përgjigjet logjikës dhe të jetë universale në të vërtetë që përfaqëson historia e interpretimit të Kuranit. Aliu r.a., shprehet: “Feja është mendje dhe mendja është fe”, domethënë, nuk është fe ajo që nuk e pranon mendja, dhe s'është mendje ajo që s'e pranon fenë.”⁸

Hafëz Dalliu merr përsipër përkthimin dhe komentimin e Kuranit, ku bëhet vepra e parë e këtij lloji në hapësirën shqiptare. Sipas tij, është detyrë fetare që Kurani t'i përkthehet secilit në gjuhën që flet, e që kjo ka qenë e lejuar qysh në kohën e Muhamedit a.s..



Edhe komenti
apo
interpretimi i
Dallit ka
specifikën e tij,
i cili me
personalitetin
e gjerë
kulturor ka
bërë përpjekje
për të sqaruar
qëllimin e të
folurit të
Allahut xh.sh.

HAFËZ IBRAHIM DALLIU SI KOMENTUES I KURANIT

Kurani ishte, dhe tani është, subjekt i studimit të disiplinave të ndryshme shkencore. Në mesin e këtyre disiplinave, hyn edhe tefsiri, shkenca rreth komentimit dhe interpretimit të Kuranit. Komentimi i fjalëve të Allahut është imponuar shumë herët.⁹

Tefsiri rrënjët e veta i ka që nga koha e Muhamedit a.s., të cilin edhe e kishte si interpretuesin më të afërt për zemrën, për shkak se ai ishte nën hijen e Zotit. Kjo problematikë gradualisht shndërrohet në disiplinë në vete, e cila ka vend të posaçëm në shkencën e teologjisë islame. Në këtë përpjekje vërehen punime të shumta nga dijetarët e proveniencës islame, të cilët i janë përkushtuar të kuptuarit dhe të interpretuarit sa më të mirë të Fjalës së Zotit.¹⁰

Nuk ka dyshim se të kuptuarit e saktë dhe interpretimi i Librit që ka një rëndësi “të tillë”, është një çështje e një rëndësie të madhe për të gjitha brezat e myslimanëve. Në këtë drejtim ekziston një konsensus i dijetarëve myslimanë se marrja me tefsir (komentimin e Kuranit) është në kategorinë *farz* – *kifajeh* (obligim kolektiv).¹¹

Hafëz Ibrahim Dalliu e përdori interpretimin e Kuranit si burim bazë të shkencave islame ku botoi mbi 15 vepra. Ashtu siç thuhet në Kuran, sure “Hud”, ajeti i 1-rë, ku shprehet: “...i dobishëm i të gjitha çështjeve në hollësi”. Nisur nga ky ajët, hafëz Dalliu përcaktoi se cilësitë e Kuranit janë në qartësinë e ideve dhe evidentimin e problemeve. Ai përdori gjithmonë

në komentin e tij mendime të argumentuara dhe të vërtetuara. Hafëz Dalliu përcaktoi se shkenca më e rëndësishme e Kuranit është komenti i tij, me të cilin kuptojmë qëllimet që ka shtruar Allahu në fjalën e Tij, sipas aftësisë dhe intelektit njerëzor.

Ai është konsultuar me disa vepra të komentimit të Kuranit bazuar nga dijetarë arabë, disa prej të cilave mbështeten në transmetim, dhe janë quajtur tradicional, disa janë mbështetur në të kuptuarit dhe janë quajtur racional, ku dominon më shumë vula personale e autorit dhe mbart me vete karakteristikat e kohës, kulturës dhe masës së madhe të orientimit. Edhe komenti apo interpretimi i Dallit ka specifikën e tij, i cili me personalitetin e gjerë kulturor ka bërë përpjekje për të sqaruar qëllimin e të folurit të Allahut xh.sh.

Te hafëz Dalliu kishte shndritur drita e mësimave të Kuranit, drita e njohurisë së sigurt, zëri i së vërtetës ku shkonte derë më derë me libra në krah dhe ua shpërndante falas besimtarëve myslimanë. Ai u drejtohej besimtarëve me fjalën e Allahut: “O njeri, a dëshiron t’i shtrish duart nga paqja, kah shpëtimi dhe lumturia? A donë të përpiqesh që të bëhesh plotësisht njeri i drejtë? Merri dhuratë këto libra e lexoi, sepse Zoti thotë: *“Ka shpëtuar ai që pastroi veten e ka dështuar ai që poshtëroi veten. Nxirr mësim nga këto libra fetarë...”*”¹²

- 1 Xhemal Balla, “Kontributi i hafiz Ibrahim Dallit në historinë e kulturës dhe shkencës islame”, *URA*, nr. 3, vjeshtë – dimër, organ i “Qendrës Islame për Studime Orientale”, (Tiranë: 2009).
- 2 Lira Musollari, “Hafiz Ibrahim Dalliu, patriot dhe atdhetar”, *Drita Islame*, Bashkësia Fetare Islame në Shqipëri, Tiranë. Ose shiko në ueb-faqe: <http://www.dritaislame.al/hafiz-ibrahim-dalliu-patriot-dhe-atdhetar/>, shikuar më: 10. 10. 2024.
- 3 Ibrahim Dalliu, *Ajka e kuptimeve të Kur’ani Kerijmit*, boton: “Fondacioni i Kur’anit”, (Tiranë: 2012) 9.
- 4 Resul Rexhepi, “Hafiz Ibrahim Dalliu dhe kontributi i tij në fushën e jurisprudencës islame...”, *Zani i Naltë*, Viti II (XVI) 2013, nr. 5. (158), (Tiranë: 2013) 102-109.
- 5 Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu – mufessir shqiptar”... Shiko në ueb-faqe: <https://orientalizmi.wordpress.com/2012/01/08/675/>, shikuar më: 10.10.2024.
- 6 Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur’anore”, (Shkup: Logos – A, 1998) 125.
- 7 Xhemal Balla, “Teologët e traditës dhe interpretimi bashkëkohor i Kur’anit”, shiko në ueb-faqe: <http://www.dritaislame.al/teologjet-e-tradites-dhe-interpretimi-bashkekohor-i-kuranit/>, shikuar më: 10.10.2024.
- 8 Ibid.
- 9 Jusuf Ramić, *Tefsir – tumaçenje i razumije vanje Kur’ana*, (Tuzllë: 1997) 7.
- 10 Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu – mufessir shqiptar”, *op. cit.*
- 11 Safvet Halilović, *Osnovi tefsira*, (Zenicë: 2005) 12.
- 12 Xhemal Balla, “Teologët e traditës dhe interpretimi bashkëkohor i Kuranit”, *op. cit.*

Fillet dhe tradita e literaturës islame në gjuhën shqipe me shkronja arabe në Kosovë

• **Mr.Arbin Ahmet**

Kultura dhe tradita islame në Kosovë mund të themi se qenë të pranishme qysh me kontaktet e para të popullatës së këtyre anëve me fenë islame, e të cilat u intensifikuan sidomos me depërtimin e Perandorisë Osmane në shekullin XV e këndej.

Botimet islame në gjuhën shqipe kanë filluar të shfaqen në dekadën e fundit të shekullit XIX, për t'u intensifikuar dhe për të fituar peshë më të madhe në vitet e para të shekullit XX, e sidomos pas Pavarësisë së Shqipërisë, kurse në mënyrë institucionale pas pavarësimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar më 1921, i cili u zyrtarizua më 1923 në Kongresin, ku u zgjodh edhe

Këshilli Drejtues i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.¹

Në Kosovë ndër të parët që kanë shkruar në gjuhën shqipe me alfabet arab kanë qenë Tahir ef. Boshnjaku, i cili ishte një myderriz nga Gjakova dhe i cili ka jetuar gjatë viteve 1770-1850. Ai ishte nga të parët që ka shkruar me alfabet arab dhe këto shkrime i kishte përgatitur për nevojat e nxënësve të Medresesë në Gjakovë.²

Një figurë tjetër më e shquar e popullit shqiptar që edhe mulla Dervish Peja, vepra e plotë më të cilën njihet është vepra “*Vasij-etname*”, kuptimi i së cilës është: “Libër, testament”.

Për këtë vepër, studiuesi Nehat Krasniqi thotë se është më e vjetra e përmbledhjes së poezisë shqipe të alamiados, e cila që krijuar në Kosovë. Kjo vepër paraqet interes të studiuesit, historianë-letrarë dhe gjuhësor në mënyrë të veçantë. Është një vepër e veçantë ku dëshmon vlerat dialektore të folmes së Pejës dhe më gjerë të fillim shekullit XIX.³

Kjo përmbledhje e poezive të mulla Dervish Pejës ka gjithsej pesë poezi, të cilat quhen “*Nasihat*”, ku përmes poezisë jep këshilla fetare rreth fesë islame. Poezitë e tij i përkasin poezive morale, në to paraqiste të mirën, besnikërinë e nderin, urtësinë e drejtësinë, të gjitha këto paraqesin vlera njerëzore, duke i përvetësuar dhe mësuar te besimtarët. Mirëpo, duhet theksuar edhe një gjë, në poezitë e tij, përveç së mirës, ai tregonte edhe për të ligën, hipokrizinë, padrejtësinë, të ligën, mosbindjen ndaj të mirës; të gjitha këto i tregonte përmes poezisë, të cilat ishin të

Literatura islame në gjuhën shqipe me shkronja arabe, me tema islame nga më të ndryshmet kanë krijuar vargje nga më të bukurat për letërsinë e kombit tonë, ato janë shkruar dhe njëkohësisht i kanë përdorur populli për njohjen e historisë fetare, kulturore e letrare, gjithashtu për t'i kënaqur ndjenjat e popullit.



kundërta me moralin e mirë, ku çdo pasojë, të mirë apo të keqe, e shprehte në vargje të qarta për të gjithë popullin. Ndër vargjet e mulla Dervish Pejës, ku jep edhe porosinë e tij është:

*Medet kaqë teposht vojtëm
Hallall ke s'ke na provojtëm
Si baktija s'e bom kujtim
Edhe mos me na thirr ferjad.*

Nga kjo poezi e tij mund të kuptojmë brengën e Mulla Dervishit, ku e preokuponte indiferenca e besimtarëve, të cilët nuk vepronin sipas rregullit islam.

Të gjithë ata të cilët kanë shkruar në gjuhën shqipe me shkronja arabe, rrallë ndodh të mos e kenë përmendur peshën e dijes, nxënien e diturisë nëpër vargjet e tyre, duke u dhënë këshilla nga më të ndryshmet.

Si shembull kemi Tahir ef. Llukën nga Deçani, i cili këtë e ka shprehur qartë e fuqishëm në vargjet:

*I pa ilm i pa dije xhahil kush ka me kon
I keç ky për gjithkond ka me kon
Pej mosdijes fort me ik per gjithkond duhet me kon
Me ly pilmin dije ti ku ka me kon.*

Natyrisht që Tahir efendi Lluka dhe autorë të tjerë të alamiados shqiptare, për ngritjen e shoqërisë preferonin mësimin dhe arsimimin, duke vënë theksin në rëndësinë e mësimin dhe shkrimit të masave të përgjithshme në gjuhën amtare shqipe. Dhe, siç shprehet ky autor, për këtë arsye, në vitin 1990 e ka hapur mejtepin e tij në Llukë të Deçanit, qysh atëherë e deri më sot na kanë mbetur disa dorëshkrime, njohim tri veprat e tij “Akâidu ‘l-islâm” (Apologjetika islame), “Risâle-i ahlâk” (Broshurë mbi moralin) dhe “Risâle-i hifzije” (Urata e besimtarëve), të cilat i kishte shkruar si tekste mësimi për nxënësit në mejtepin e tij.⁴

Thirrja që vazhdimisht bëhet nga autorë, të cilët kanë shkruar tekstet e tyre në gjuhën shqipe por me shkronja arabe, që thirrje për arsimim dhe kanë treguar se asnjëherë nuk e ndajnë dijen nga feja, e cila është rrugë që të dërgon te Zoti, apo të themi për ta njohur Krijuesin më mirë. Vargjet e tyre gjithmonë thërresin për devotshmëri ndaj çdo gjëje dhe për moral sa më të lartë. Tematikës didaktike-fetare këta i qasen si teologë, si hoxhallarë, dhe është e natyrshme se tekstet e tyre, edhe pse pjesa dërrmuese janë poezi, janë të përshkruara me frikë e përkushtim ndaj Zotit. Sipas tyre, ky është përcaktimi i vetëm i drejtë në jetë. Poezia e tyre didaktike është karakteristike edhe për faktin se përfshihet në konceptin e didaktikës çfarë është në rrethin kulturor islam. Ai mësim a këshillim përfshinë tërë qenien e njeriut, pra gjithë atë që e bën mendimtar dhe përgjegjës në sferën e idesë së fesë, por edhe realitetin më konkret. Aty janë të vendosura idetë universale të së mirës dhe të së keqes, të konkretizuara me urdhra nga Kurani e hadithi. Në përgjithësi,

këto këshilla shkojnë nga edukimi fetar kah kërkesa primare deri tek udhëzimet në sjellje në jetën e përditshme.⁵

Sheh Maliqi, për shembull, në poezitë e “Divanit”⁶ të tij, gjithashtu ka dhënë një kontribut të veçantë në literaturën islame mistike, gjithashtu edhe në bazat e arsimimit, ku në vendlindjen e tij në Rahovec ka mbetur një figurë e denjë e një prijësi shpirtëror dhe religjioz, i cili edhe mund të jetë nga të fundit që e ka begatuar literaturën islame në gjuhën shqipe me shkronja arabe në Kosovë, deri në vitet e tridhjeta të shekullit XX.

Në literaturën islame shqipe të shkruar me shkronja arabe, një vend të veçantë zë poema e quajtur “Mevlud”, të cilën e kanë kultivuar shumë autorë. Mevludi i këndon lindjes së Pejgamberit Muhamed a.s., respektivisht detajeve të jetës së tij: lindjes, jetës, mrekullive të tij, Miraxhit - udhëtimit të tij natën në qiej dhe kalimit në botën tjetër. Mevludi më i përhapur dhe më i pëlqyer në Kosovë dhe në disa vise të tjera rreth Kosovës është Mevludi i Tahir ef. Popovës, në të cilin gjejmë një përshkrim shumë të realizuar artistikisht, ku gjejmë shprehjen edhe vlerat poetike, teksa autori përdor një stil të bukur me krahasime e figura të qëlluara. Gjithashtu Mevludi është më shumë se traditë e thjeshtë, ai është libri më i kënduar fetar islam në gjuhën shqipe, ndërsa të kënduarit e mevludit është i dobishëm, sepse kultivon dashurinë ndaj Allahut e Pejgamberit të Tij, Muhamedit a.s.⁷

Literatura islame në gjuhën shqipe me shkronja arabe, me tema islame nga më të ndryshmet kanë krijuar vargje nga më të bukurat për letërsinë e kombit tonë, ato janë shkruar dhe njëkohësisht i kanë përdorur populli për njohjen e historisë fetare, kulturore e letrare, gjithashtu për t'i kënaqur ndjenjat e popullit. Këto shprehje gjuhësore e letrare, të shqiptarët kanë një traditë disashekullore. Edhe shkrimet e alamiados tregojnë dashurinë që kanë ndaj gjuhës së tyre, dijes dhe atdheut.

- 1 Ramadan Shkodra, “Botimet islame në gjuhën shqipe në Kosovë”, <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=6106>, ora: 13:35, data: 1.11.2023.
- 2 Abdullah Hamiti, “Mbi traditën e literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, të shkruar me grafi arabe”, Literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1957-2017), Fillet, Tradita, Sfidat dhe Sukseset, Përmbledhje kumtesash nga tryeza shkencore (Prishtinë, 27 dhjetor 2017), sh.b.: “Dituria Islame”, Prishtinë, 2019, f. 42.
- 3 Nehat Krasniqi, “Kontribute albanologjike”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 312.
- 4 Abdullah Hamiti, “Mbi traditën e literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, të shkruar me grafi arabe”, f. 44- 45.
- 5 Abdullah Hamiti, “Mbi traditën e literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, të shkruar me grafi arabe”, po aty, f. 42.
- 6 Shejh Maliqi dhe Divani i tij shqip, përgatiti Jahja Hondozi, shtëpia botuese: “Logos-A”, Shkup, 2014, f. 256.
- 7 Abdullah Hamiti, “Mbi traditën e literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, të shkruar me grafi arabe”, f. 46- 47.

Kontributi i Ibën Havkalit (? – 980) në zhvillimin e shkencës

• Artan S. Mehmet

Ibën Havkali shumicën e jetës së tij e kaloi në udhëtime, nëpër vende të ndryshme të botës. Udhëtimet e tij kryesisht janë përqendruar nëpër vendet e botës islame, siç janë vendet e Afrikës Veriore dhe Azisë. Se nga kush është motivuar Ibën Havkali që t'i ndërmarrë këto udhëtime, ka mendime të ndryshme. Ka mendime se ai ka udhëtuar për motive tregtare, ose për të qëndruar larg turbullirave politike të asaj kohe që ishin prezentë në Bagdad, ose për t'i vizituar vendet e lexuara nëpër libra të ndryshëm pasi që ishte i pasionuar pas leximit etj. Si do që të ketë qenë motivi i udhëtimit, studiuesit e ndryshëm, Ibën Havkalin, e fusin në mesin e dijetarëve të shkollës gjeografike klasike myslimane, ku ai shkruan në mënyrën më të

mirë për këto vende, pavarësisht a i ka vizituar të gjitha këto vende a jo.

Informacionet të cilat gjenden në shkrimet e tij, përmbajnë një saktësi të arsyeshme, e veçanërisht ato shënime që kanë të bëjnë me Afrikën e Veriut. Kjo mbase është dëshmuar nga orientalisti rus Kratchkovsky, i cili deklaron se Ibën Havkali ishte një pionier në mesin e dijetarëve klasikë myslimanë të gjeografisë, ku nga studimet e tij për Afrikën, ai fitoi një famë të madhe.

Ibën Havkali ishte pjesë e shkollës së quajtur "Shkolla e gjeografëve të Belhit". Anëtarë të tjerë të shkollës klasike myslimane të gjeografisë janë: El Belhi, El Istahri dhe El Mukaddasi. Të gjitha veprat e këtyre autorëve kanë shumë veçori të përbashkëta, këtyre autorëve u është dhënë emri i përbashkët

Muhamed Ebu'l Kasim ibën Havkali lindi në qytetin Nibis të Mesopotamisë së Epërme, që në kohët moderne ky qytet i takon Turqisë. Ai ishte gjeograf, hartograf, historian, shkrimtar dhe kronist.





Harta e botës myslimane me orientim gjeografikë të Jugut në krye, e punuar nga Ibën Havkali

Një pjesë e hartave që ka mbijetuar deri në ditët tona, nga korpusi i hartografisë islame, janë ato të cilat ndodhën në librin e Ibën Havkalit me titull “Surtu-l-Erd”, ku një dorëshkrim i këtij libri, i punuar në vitin 1086, gjendet në Topkapi Sarayı Müzesi Kutuphanesi në Stamboll.

“Autorët e Atlasit Islamë”. Në grupin e shkri-meve Balhi-Istahri-Ibën Havkal, ekzistojnë katër recensione të dallueshme të asaj që është në thelb një grup hartash, e që J.H. Kramers, ju referohet të katër llojeve si: Istakhri I, Istakhri II, Ibën Havkal I dhe Ibën Havkal III. Sidoqoftë, harta botërore e Ibën Havkal III është aq e ndryshme nga hartat e tjera të botës, saqë kërkon një konsideratë të veçantë.

Dallimi kryesor midis veprës së Ibën Havkalit dhe të autorëve të tjerë myslimanë është në diskutimin e mëhershëm të pjesës perëndimore (dikur bizantine) të botës islame. Ai e trajton Spanjën, Afrikën e Veriut dhe Sicilinë si tre seksione të ndara. Siria dhe Egjipti trajtohen në mënyrë më të detajuar. Është interesant fakti që autorët e mëvonshëm, si Jakut Hameviu, gjatë përshkrimit që ju bëjnë këtyre rajoneve perëndimore të botës islame, gjithmonë e citojnë Ibën Havkalin.


Një pjesë e hartave që ka mbijetuar deri në ditët tona, nga korpusi i hartografisë islame, janë ato të cilat ndodhën në librin e Ibën Havkalit me titull “Surtu-l-Erd”, ku një dorëshkrim i këtij libri, i punuar në vitin 1086, gjendet në Topkapi Sarayı Müzesi Kutuphanesi në Stamboll.

Jetën e Ibën Havkalit, më së miri e njohim përmes librave të tij, siç shkruan edhe vetë ai, ku pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi në

udhëtime. Këto udhëtime, Ibën Havkali i filloi më 15 maj 943 dhe vazhduan deri në vitin 973, kur së fundmi u shfaqë në Sicili. Gjatë këtyre viteve, ai vizitoi shumicën e hapësirës islame të Afrikës së Veriut, si dhe zona të mëdha të Persisë dhe Turkestanit. Ka mundësi që gjatë udhëtimit të tij, Ibën Havkali të këtë bërë edhe tregti, pasi që puna e tij ka shumë fakte me aktivitetin ekonomik.

Në vitin 974, Ibën Havkali kthehet në Bagdad ku përfundoi enciklopedinë e tij, e cila përmbante shumë harta dhe grafikone. Përveç punës së tij të shkurtër në Sicili, ai është i njohur vetëm për librin e tij në gjeografi me titull “Surtu-l-Erd”, gjithashtu i njohur edhe si “El Mesalik ve’l-Memalik”.

Takimi i Ibën Havkalit me El Istahrin ka krijuar huti në mes studiuesve, për arsye se përveç se ishin dijetarë të së njëjtës shkollë, ata kishin përdorur të njëjtin titull për librat e tyre. Megjithatë, dihet se El Istahri ka përfituar jashtëzakonisht shumë nga Ibën Havkali, veçanërisht nga korrigjimet që El Istahri i ka kërkuar Ibën Havkalit për t’ua bërë punimeve të tij, që kanë të bëjnë me Indinë dhe Persinë. Nga këto korrigjime, Ibën Havkali e kuptoi se si mund të shkruante diçka nga ajo që ai e korrigjoi, si dhe e pranon se ka huazuar nga libri i El Istahrit, mirëpo Ibën Havkali thekson se ka shtuar jashtëzakonisht shumë nga vëzhgimet e tij. Megjithatë studiuesit men-



Harta e Detit Kaspik nga shekulli i 10-të nga Ibn Hawqal.

dojnë se Ibën Havkali është shumë borxhli ndaj El Istahrit, nga ajo që Ibën Havkali e pranon në mënyrën se si e shkroi librin, si dhe në mënyrën e vendosjes së të dhënave mbas hartave. Këtë libër ai e plotëson duke shtuar edhe kapituj të tjerë për Gadishullin Arabik, Rajonin e Gjirit, të Huzestanit, Krimanit dhe Sindit, për të cilat Ibën Havkal i ka shtuar edhe disa shtesa.

Në studimet e tij, Ibën Havkali, nuk kufizohet vetëm në të dhëna gjeografike, por ai shtjellon edhe qytetet e mëdha, popullsinë dhe zakonet e tyre, si dhe çdo gjë tjetër të veçantë lidhur më jetën e popullsisë së atij rajoni të cilin e ka marrë në studim. Në vlerësimet e tij për popullsinë, Ibën Havkali është bazuar në numrin e pjesëmarrësve në xhamia dhe kisha. Për të pasur një analizë më të detajuar për popullsinë, ai u takua me popullsinë përkatëse. Në librin e tij, kohë pas kohe, Ibën Havkal bën kritikë për zakonet dhe sjelljet e këtyre popujve, p.sh. mendimet e tij të ashpra rreth sicilianeve, apo kritikave rreth disa zakoneve të caktuara ndërmjet popullsisë berbere.

Gjatë këtij udhëtimi, Ibën Havkali u vendos në rajonet që gëzonin burime të mira të të ardhurave, më qëllim që t'i përshkruaj aktivitetet tregtare dhe produktet bujqësore të secilit rajon. Në këndvështrimin komercial, ai përshkroi taksat tregtare të disa rajoneve, e veçanërisht atë të Marokut, si dhe bëri një shënim për mallrat tregtare që u sollën nga një rajon në tjetrin me çmime shumë fitimprurëse, siç është rasti i një thes kripe e sjellë në Marok, duke e shitur për 200 derhemë si pasojë e mungesës së kripës në këtë vend. Ibën Havkali gjithashtu ka shkruar edhe për bujqësinë e rajonit perëndimor të Marokut, duke u thelluar në kultivimin e perimeve, pemëve, drithërave, si dhe për burimet ujore të çdo qyteti të madh. Në librat e tij, ai përshkruan edhe rrugët e udhëtimit nga një rajon në tjetrin, duke iu shtuar edhe rrugët e tjera më të vogla, të degëzuara nga rrugët kryesore, të cilat dërgonin në fshatrat dhe qytete më të vogla.

Në studimet e tij, Ibën Havkali, nuk kufizohet vetëm në të dhëna gjeografike, por ai shtjellon edhe qytetet e mëdha, popullsinë dhe zakonet e tyre, si dhe çdo gjë tjetër të veçantë lidhur më jetën e popullsisë së atij rajoni të cilin e ka marrë në studim.

Burimet:

1. Prof. dr. Fuat Sezgin, Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë Islame, përktheu nga turqishtja: Altin Qefalio, LOGOS-A, Shkup 2015;
2. Sami Frashëri, Qytetërimi Islam, LOGOS-A, Shkup 2009;
3. Salah Zaimeche, SICILIA, Nga gjuha angleze: Hanife Alija – Dauti, EDUKATA ISLAME, nr. 88, Prishtinë 2009;
4. GERALD R. TIBBETTS, The Balkh School of Geographers; (http://www.press.uchicago.edu/books/HOC/HOC_V2_B1/HOC_VOLUME2_Book1_chapter5.pdf), 21.08.2024; Authors Bevens, Walter Bascom. Publisher The University of Arizona. Al-Yaman and the Hadramawt: Translations from medieval Arabic geographers and analysis, (https://repository.arizona.edu/bitstream/handle/10150/184338/azu_td_8814209_sip1_m.pdf?sequence=1&isAllowed=y), 23.08.2024; https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn_Hawqal, 20.08.2024; <http://islamicencyclopedia.org/islamic-pedia-topic.php?id=388> 20.08.2024; http://cartographic-images.net/Cartographic_Images/213_Ibn_Hawqal.html 22.08.2024;

Një vështrim historik për vështërsitë e përkthimit të një teksti kuranor në gjuhët prendimore

• Hajrudin S. Muja

Në një shkrim të titulluar “*Entuziazmi i hutuar - Historia e vështirë e përkthimit të një teksti të mrekullueshëm*”¹, autori Robyn Creswell ka analizuar dy botime të reja në lidhje me mundësinë dhe pamundësinë e përkthimit të tekstit kuranor.² Creswell e fillon shkrimin me historinë e kalifit të II-të, Omer ibën Hattabit, i cili fillimisht ishte i ashpër kundrejt Profetit Muhamed a.s. deri në vitin e tretë që kishte filluar me thirrjen në Islam. Gjithçka ndryshoi atë natë të vitit 616, kur takoi profetin në namaz pranë Qabesë dhe dëgjoi për herë të parë recitimin e Kuranit, u habit, zemra ju zbut, qau dhe pastaj *Islami hyri në mua*. Flitet për një kohë kur poezia ishte bërë pjesë e kulturës pagane, ndërsa poetët rivalë politik të Muhamedit a.s., të cilët hoqën dorë sapo dëgjuan pjesë të shpalljes. Disa tregime rrëfejnë konvertimin e të krishterëve abisinianë dhe bizantinë, të cilët pranuan mesazhin kuranor edhe pse nuk kuptonin asnjë fjalë arabisht. Disa rrëfime ekstreme, tregojnë se dëgjimi i vargjeve kuranore madje shkaktonte të fikët, tmerr, ekstazë e madje edhe vdekje. Ebu Ishak el Thalabi pati botuar në shekullin X një përmbledhje me tregime të tilla.

Sidoqoftë, në shekullin IX, teologët predikuan se teksti kuranor është një mrekulli, e cila nuk mund të krahasohet me asnjë përpjekje njerëzore, edhe pse nuk i pengoi disa poetë arabë që më kot të provonin. Ky

pretendim zgjoi polemika fetare të krishterëve të cilët vunë në dukje mrekullitë e Jezusit a.s., që gjithashtu shfaqeshin në Kuran *si dëshmi e autoritetit të tij dhe favorit të Zotit*. Ata kërkonin mrekullitë e Muhamedit a.s. që do të argumentonin profetësinë e tij. Ideja gjeti mbështetje në vargjet kuranore që sfiduan njerëzit dhe xhinët që të përputheshin me madhësitinë e shkrimit të shenjtë, *le të sjellin një libër të ngjashëm me të, nëse ajo që thonë është e vërtetë*.³

Creswell nuk merret fare me përpjekjet më të hershme të përkthimit të tekstit kuranor në gjuhët perëndimore që kishin karakter armiqësorë kundrejt Islamit. Është për shembull përkthimi i Pjetrit të Nderuar të Klunit, i cili shërbente në manastirin e Klunit në Francë, dhe u kujdes vetë për botimin e përkthimit të parë latin të Kuranit në versionin latin nga Roberti i Kettonit (Robertus Kettonensis (1110-1160), bashkë me Hermannus Dalmata (? - 1160) ndërmjet viteve 1141 dhe 1147.⁴ Që të dy kishin ardhur në *botën Muhamedane* si dijetarë të interesuar për astronominë dhe matematikën.⁵ Si një abat erudit, ai imagjinonte se do t'i ndihmonte të krishterizonte myslimanët, të cilët i kishte shumë afër në Andalusi (Spanjë). Gjithçka mund të kuptohet nga një kopje e vitit 1162 të këtij përkthimi, që kishte një karikaturë të Muhamedit a.s., si një përbindësh.⁶ Ky përkthim qe fare i papërfillshëm përderisa për të

“Disa rrëfime tregojnë se të krishterë që nuk kuptonin asnjë fjalë arabisht, pranuan mesazhin kuranor vetëm duke e dëgjuar.”

nuk dinte as Marku i Toledos (v.1226), i cili ndërmjet vitit 1210 dhe 1211 përktheu “*Liber Alchorani*” me urdhër të Arqipeshkvit të Toledos - Rodrigo Jimenez de Rada (1170-1247), që po planifikonte një kryqëzatë në Andaluzi. Në grupin e komisionit të këtij përkthimi ishte edhe Rodrigo Jimenez de Rada (1170-1247) arqipeshkëv i Toledos dhe këshilltar i afërm i mbretit Ferdinand i III-të i Kastiles dhe Leonit (1199-1252).⁷ Në tekstin hyrës, Marku futi ato mite të mëparshme tipike të krishterëve perëndimorë kundër Islamit dhe myslimanëve dhe pikërisht me atë qëllim e përktheu, por së paku e pranoi se po përkthente një tekst nga një gjuhë shumë e vështirë (arabe) në një gjuhë gjithashtu të vështirë (latine),⁸ ndërkohë që përkthimi aspak i sinqertë i jepte mundësi lexuesit të devijojë fare nga origjinali. Dorën në zemër, në krahasim me përkthimin e Pjetrit, përkthimi i Markut ishte më i saktë dhe pak më reflektues në të kuptuarit e Islamit.⁹

Në Perëndim kishin lindur akuzat e vlerave të civilizimit të Evropës së krishterë kundrejt “vlerave pagane aziatike jocosivilizuese”. Debatet bazoheshin në përkthimet e teksteve të Ketton-it dhe të Ricoldo të Montecorce-s

“Përkthimet e hershme të Kuranit në gjuhët evropiane shpesh ishin më shumë projeksione ideologjike sesa përpjekje për të kuptuar Islamin.”

(1242-1320), përfshi edhe “*Cibratio Alchorani*” të Nicholas Cusa-s (1401-1464) si dhe “*Contra Principales errores perfidi Machometi*” të Juan Torquemada (1388-1468), të shkruara ndërmjet viteve 1400 dhe 1459, tekste që i përdorte Piusi i II-të (1405-1464)¹⁰, i cili vendosi t’i adresojë një letër direkte *Sulltanit turk* Muhamedit të II-të (1432-1481), duke i kërkuar atij të konvertohej në Krishterim. Cusa mendonte se përkthimi i Kuranit do t’u mundësonte të krishterëve të shohin vetë “një det kontradiktash e absurditetesh” dhe për këtë arsye gjeti Dinosuys Carthusian (1402-1471), i cili shkroi traktet “*Contra Alchonarum et estam machometicam*” dhe “*Cribratorio Alchora*”, të cilat sot janë më shumë në përdorim kundër Islamit se ç’kishin qenë në shekullin e XV.¹¹ Me këtë synim iu përvesh punës edhe Alexander Ross (1591-1664) i cili “*The Alcoran of Mahomet*” nuk e përktheu nga origjinali, por nga një përkthim i frëngjishtes nga Andre Du Ryer (1580-1660). Për Ross-in, konvertimet e të krishterëve në Islam ngjanin nga shtresa injorante, e cila jo vetëm që nuk i njihte “të mirat e krishterimit”, por as “të ligat e Islamit”. Ross tregoi në hyrje se po luftonte “*mashtresin e madh arab*” fjalët e të cilit pas njëmijë vjetëve ishin përkthyer thuajse në të gjitha gjuhët e krishterimit, kishin mbërrit në Angli dhe kishin filluar të flasin anglisht.¹² Ky ishte ai stili i Thomas Newtonit, i cili shkroi për “*paudhësitë*” e Muhamedit a.s.,¹³ të cilat i përdori edhe Martin Luteri (1483-1546).¹⁴ Në edicionin e vitit 1543 të përkthimit të Kettonit, Luteri shkroi se: “*kisha e Perëndisë duhet të hedhë poshtë gabimet e të gjithë armiqve të Ungjillit*”¹⁵ dhe armiq të Ungjillit këtu ishin pasuesit e Kuranit. Për Lutherin Kurani ishte si një “*libër i mbushur me fyerje kundër Zotit*”.¹⁶

Deri tani përkthimet e Kuranit dhe të teksteve të tjera islame, shpeshherë përfshinin edhe komente e shqyrtime nga autori ose përkthyesi, por brenda tekstit. Pavarësisht se cili ishte qëllimi i kësaj, teksti e kishte humbur origjinalitetin. Siç shpjegon Luise von Flotow, këto përkthime nuk kishte fare qëllim për të shpjeguar Islamin, ishin të ngarkuara me konfigurime të caktuara fetare e politike që sollën paragjykime ideologjike, teologjike dhe kulturore për Islamin,



Përmbledhje të traktateve të ndryshme në lidhje me myslimanët, duke përfshirë ndoshta edhe tekstin më të hershëm të përkthimit të Kuranit në latinisht nga Roberti i Ketton-it (1162).

të cilat në periudhën moderne i ka vërejtur çdo studiues i paanshëm.¹⁷

Natyrisht se lexuesit e çdo teksti të përkthyer kuranor nuk mund ta shijojnë bukurinë e Kuranit. Historiani Edward Gibbon (1737-1794), i cili kishte lexuar përkthimin e George Salle's (1734), që ishte përkthimi i parë në gjuhën angleze nga origjinali, e kishte kuptuar vështirësinë e kësaj pune. Ai shkruante se ky tekst “rrallë ngacmon ndjenjat” pasi: “herë zvarritet në pluhur dhe herë humbet në re.”¹⁸ Ky lloj skepticizmi është ende aktual. Në një përpjekje për t'i dhënë kuptim shkrimeve të shenjta myslimane nga një këndvështrim katolik, Garry Wills shkroi: “Më duhet të pranoj se Kurani fillimisht nuk është një lexim tërheqës.”¹⁹ Wills e lexoi përkthimin e Kuranit në anglisht nga M.A.S. Abdel Haleem²⁰, ndërkohë që autoritetet islame besonin dhe deklaronin se Kurani, si fjalë e Zotit që i është shpallur Muhamedit a.s., përmes engjëllit Xhebrail, është i papërthyeshëm dhe çdo tekst i tij që nuk është arabisht, nuk është Kuran. Edhe në rastin kur lëmë anash çështjet teologjike, Kurani nuk është libër që myslimanët e kanë hasur historikisht vetëm përmes leximit, ata e kanë recituar, e kanë

“Përkthimi i Kuranit jo vetëm që sfidon kufijtë gjuhësorë, por ngre edhe pyetje të thella për devocionin, kuptimin dhe përkatësinë fetare.”

memorizuar dhe e kanë përdorur në praktika devotshmërie – thotë Creswell. Përkthimet dhe botimet e hershme të Kuranit në gjuhët evropiane ishin haptazi antagonistë ndaj Islamit.

Kur protestantët në Bazel debatuan nëse do të shtypnin përkthimin e Kuranit të Robertit të Ketonit, Martin Luteri, doli në favor “për shkak se turqit po afrohen” dhe se ishte e rëndësishme që “pastorët të kenë prova të besueshme për predikimin e neverisë së Muhamedit”. Ludovico Marracci (1612-1700), rrëfimtari i Papa Inocentit të XI-të (1611-1689), botoi përkthimin e tij latinisht në Padovë në vitin 1698. Marracci një lloj kishte për qëllim përgënjeshttrimin e vargjeve kuranore me qëllim që “të therte Mahometin me shpatën e tij për aq sa kam mundësi”.

Ndryshe nga dy të parët, avokati dhe orientalisti anglez George Salle (1697–1736), megjithëse nuk ishte mik i Islamit, si përkthyes ishte më i kujdesshëm. Duke u mbështetur pjesërisht në përkthimin e Marracci-it, edhe Salle e quajti Kuranin një “falsifikim” dhe priste me padurim “përmbysjen e lavdisë së tij”, por ndryshe nga të tjerët, mendoi se përgënjeshttrimet e katolikëve ishin të padobishme dhe madje “të paturpshme”. Në vështrimin e tij, përkthimi që u admirua nga Gibbon dhe Volteri, do të shërbente si studim laik i të drejtës krahasuese për të njohur ligjet e ndryshme të kombeve të qytetëruara. Ishte një kopje e këtij përkthimi që Thomas Xhefersoni e bleu në Williamsburg në vitin 1765 dhe që Keith Ellison, e përdori për ceremoninë e tij të betimit.²¹ Ky botim në anglisht që shënoi një pikë kthese, do të mbetet më i popullarizuar për 200 vjet. Ndryshe nga të tjerët para tij, që gjatë përkthimit e shndërronin Kuranin në “një libër lavdërimi pagan në një tropikë fyese” dhe të pakuptimtë, Salle u detyrua të pranojë publikisht se “Stili i Kuranit është përgjithësisht i bukur dhe i rrjedhshëm... dhe në shumë vende, veçanërisht aty ku përkthuhet atributet dhe madhështia e Zotit, është sublim dhe madhështor”.

Shumë mendimtarë të shekullit të XIX ndoqën drejtimin e tij. Në leksionet e tij popullore mbi heronjtë, Thomas Carlyle, i cili e kishte lexuar përkthimin e Salle-s, jo më



Biblioteka Mbretërore, Danimarkë - faqe kushtimi të një Kurani në persisht, turqisht dhe latinisht, dhënë mbretit Frederik të III të Danimarkës nga orientalisti Theodor Petraeus (1664).

kot e vlerësoi Muhamedin a.s. si një vizionar dhe një gjeni, ndërsa tekstin kuranor që edhe në përkthim “*mund ta quajmë pothuajse poezi*”. Por, vetë myslimanët ende diskutonin nëse përkthimi i tekstit kuranor mund të përdorej për qëllime devotshmërie, një pyetje që nuk i interesonin as Luterit, as Marracit dhe as Salle-s, por që u debatuan nga juristët myslimanë sapo nisi përhapja e Islami përtej vendeve arabisht folëse, aq më tepër kur shumica e botës myslimane u bë e tillë.²²

Komuniteti i parë i konsiderueshëm i myslimanëve anglofonë u shfaq në Indinë Britanike të shekullit XIX dhe përkthyesit më të hershëm myslimanë të Kuranit në anglisht erdhën nga kjo popullsi, për të cilët anglishtja ishte më shumë gjuhë elitare dhe e shkollës sesa që flitej në shtëpi. Ata i njihnin mirë përkthimet e mëparshme orientaliste dhe mënyrën e tyre armiqësore, prandaj ishin të mendimit që për hir të dinjitetit dhe besimit të prodhonin versionet e tyre të shkrimeve të shenjta në anglisht. Creswell thotë se nga më të hershmit e tyre ishte ai i vitit 1917 nga Maulana Muhamed Ali (1874-1951), një udhëheqës i lëvizjes Ahmadi, i cili ndoqi mësimet e Mirza Ghulam Ahmadit (1835-1908), një reformator fetar pro-anglez i vetëshpallur *mesia*,²³ që predikoi “*xhihadin e penës*”²⁴. Megjithatë ne kemi një përkthim të mëhershëm, atë të dr. Muhamad Abdul Hakim Khan “*The Holy Quran With A Commentary*” (1905) dhe atë të Mirza Abul Fazl “*The Quran Arabic Text And English Translation*”. (1910). Në vitin 1930 e përktheu Muhamed Marmaduke Pickthall (1875-1936) si “*The Meaning of the Glorious Koran: An Explanatory Translation*”. Pickthall ishte një britanik i konvertuar në Islam (1917) dhe autor i njohur, të cilin E.M. Forster e quajti “*i vetmi romancier bashkëkohor anglez që kupton Lindjen e afërt*”.²⁵ Pickthall ishte shok shkolle me Çurçilin dhe mik i ngushtë i Gandit. Duke qenë se përkthimi i Muhamed Aliut anglezëve u dukej i pakuptimtë, ai iu përvesh punës për ta përkthyer vetë. Creswell thotë se në vitin 1929 Pickthall iu drejtua autoriteteve të Al Azharit në Kajro, por klerikët ende nuk ishin të sigurt nëse përkthimet e Kuranit ishin fare të lejueshme. Katër vite më parë (1925) Al Azhar kishte nxjerrë fetvanë që kërkonte të digjej përkthimi i Muhamed Aliut (1917), një dekret i jashtëzakonshëm, pasi Kurani i shenjtë përfshinte edhe tekstin arab. Ndërsa autoritetet e krishtera kishin pasur frikë nëse përkthimet e Kuranit mund të dëmtonin kopenë e tyre, tani të njëjtin shqetësim e kishin sheikët myslimanë.

“Për myslimanët anglishtfolës të shekullit XIX, përkthimi i Kuranit nuk ishte thjesht një akt gjuhësor, por një mjet për të ruajtur dinjitetin dhe për të përballuar keqinterpretimet armiqësore.”

Me kalimin e kohës, dijetarët myslimanë ranë dakord se përkthimi i Kuranit mund të ishte vetëm një përpjekje për të interpretuar kuptimet e origjinalit të arabishtes dhe jo për të siguruar një zëvendësim të fjalëve të Perëndisë. Pickthall shkroi në hyrje të versionit të tij, se “*Kurani nuk mund të përkthehet*” kurse vetë përkthimin e titulloi: “*Kuptimi i Kuranit të lavdishëm - një përkthim shpjegues*”. I vetmi përkthim i krahasueshëm për nga popullariteti është “*The Holy Qur'an - Text, Translation and Commentary*” i Hafiz Abdullah Jusuf Aliut (1872-1953), i botuar në Lahore midis viteve 1934 dhe 1937. Në parathënien e versionit të tij, Jusuf Aliu qartësoi ambicien e tij “*për ta bërë vetë anglishten një gjuhë islame*”, por kritikët mendojnë se bëri të kundërtën. Në fakt, ata u përpoqën që për lexuesit Kurani të dukej dhe të tingëllonte si shkrim i shenjtë i Biblës të versionit të Mbretit Xhejms, me gjuhën e tyre të matur, formale, me vetëdije arkaike. Gibbon dhe Carlyle morën Biblën si një normë dhe prisnin të lexonin diçka të ngjashme, mirëpo Kurani është një tekst shumë i ndryshëm nga “*Dhiata e Vjetër*” dhe “*Dhiata e Re*” që përfshin një kastë të lidhur personazhesh (si Abrahami, Noeu, Moisiu, Jakobi, Jezusi, etj.) dhe një mesazh të njohur të monoteizmit, pa rrëfime të gjata (nëse përjashtohet historia e Jusufit), ndërkohë që referencat për popujt dhe ngjarjet historike janë të shkurtra dhe shpesh eliptike, pa ndonjë rregull kronologjik. Siç e shpjegon M.A.S. Abdel Haleem, Kurani është më tepër një “*libër udhëzimi*” për rikujtimin e Zotit, për Ademin a.s., për engjëjt, për djallin, për Ditën e Gjykimit, për ekzaltimet e plotfuqisë së Zotit, për rrëfimet e profetëve të mëparshëm, për largqëndrueshmërisë nga idhujtaria, për udhëzime rreth lutjes, agjërimit, pelegrinazhit, divorcit dhe marrëdhënieve me hebrenjtë dhe të krishterët.

Ai që do të vendos një theks të ri mbi elementët letrarë të veçantë të Kuranit ishte Arthur J. Arberry (1905-1969), i cili në vitin 1955 do të publikojë “*The Koran Interpreted*”. Arberry nuk ishte mysliman, por si një studiues dhe përkthyes i poezisë arabe paraislamike, klasike dhe mistike, u mundua të nxjerrë “*ato modele retorike dhe ritmike që janë lavdia dhe madhështia e Kuranit*”, pasi siç shkruan vetë ai: “Çdo sure është një rapsodi”, megjithëqë përpjekjet e tij për rapsodi shpesh humbasin. Qasja e Arberry-t ishte pjesërisht fryt i përvojës personale, siç tregon në parathënien e tij, ishte frymëzuar nga kujtimet e netëve të Ramazanit në Egjipt, kur për dy vite dha mësim në Universitetin e Kajros dhe ku nga



Roberto Totolli - transkriptimi i Ludovico Marracci-t i një komenti kuranor nga Ibën Ebi Zamani në fillim të sures 18 (vargjet kuranore të nënvizuara); në margjina është drafti i parë i përkthimit të tij, rreth vitit 1650

veranda e tij dëgjonte i magjepsur shehun e vjetër mjekërbardhë, i cili recitonte Kuranin: “për kënaqësinë e devotshme të fqinjit tim”. Ishin ato recitime – thoshte ai: “që unë, i pafë, mësova të kuptoja dhe të reagoja ndaj ritmeve emocionuese të Kuranit”.

Një qasje të tillë e pati edhe Michael Sells, një tjetër studiues dhe përkthyes i poezisë mistike, i cili nuk e përktheu të gjithë Kuranin, por i përmbloodhi kryesisht ato që njihen si suret e hershme mekase dhe i botoi në vitin 1999 nën titullin: “Approaching the Qur’ān”. Shumë prej këtyre sureve – thotë ai – drejtohen çështjeve të besimit dhe shpëtimit personal, u kujtojnë besimtarëve hirin e Zotit, ndërsa ato evokojnë vazhdimisht, me një gjuhë goditëse dhe ndonjëherë hermetike për Ditën e Llogarisë. Zëri që dëgjon në suret e hershme është një zë që qëndron në mes “intimitetit dhe frikës”. Sells ka parasysh vështirësitë e përkthimit të tekstit të arabishtes në anglisht. Në kohën e shpalljes, arabët paganë besonin se poetët frymëzoheshin nga prania e padukshme - xhinët ose demonët. Muhamedi a.s., gjithashtu u frymëzua nga një prani e padukshme dhe fjalimi i tij ishte tingëllues, shpesh i rimuar, me një puls të fortë ritmik, kështu që ai ngjante me njerëzit

“Ndryshe nga përkthyesit që i qasen Kuranit si tekst i shkruar, Toorawa e rikthen ndjesinë e gjallë të recitimit, ku rima, ritmi dhe përkushtimi bashkëshkruajnë një përvojë shpirtërore.”

që arabët njihnin si poetë. Por fjalët e Profetit u diktuan nga një frymë hyjnore, jo nga një shpirt djallëzor, ndërkohë që pranimi i atij dallimi shënoi ndryshimin midis besimit dhe mosbesimit.

Në botimin e tyre të ri të Kuranit “A Verse Translation”, studiuesit M.A.R. Habib dhe Bruce Lawrence pohuan se Kurani në përkufizim nuk është poezi, por megjithatë është “thellësisht poetik” dhe madje “më shumë se poezi”. Ata tregojnë se përdorimi i rimës dhe ritmit nga origjinali, bashkë me metaforat dhe alegoritë e tij, në prozë nuk mund të jenë besnike në asnjë kuptim të fjalës. Në shpjegimin e tyre, tipari formal që u intereson më shumë është sistemi i pauzave të Kuranit: ndërprerjet midis vargjeve të shënuara me numra në tekstin arab dhe pauzat brenda vargjeve - një veçori e theksuar nga recitimi, ku pauzat lejojnë frymëmarrje. Ndërprerjet e rreshtave të një përkthimi të vargjeve, argumentojnë ata, mund të regjistrojnë këtë ritëm të ndërlikuar që është bazë për mënyrën e kuptimit dhe fuqisë estetike të Kuranit. Në një përkthim në prozë, përkundrazi: “të gjitha pauzat zhduken”. Në këtë kontekst, poetika kuranore është kryesisht gojore dhe nga natyra një tekst për recitim, pasi – siç thonë ata: “Kurani është menduar të lexohet me zë të lartë”. Për këtë arsye: “përkthimi i Kuranit në anglisht duhet të jetë i ndjeshëm ndaj performancës”. Ai i udhëzon besimtarët që të recitojnë fjalët e tij “ngadalë dhe qartë”, ose, në versionin e Habibit dhe Lawrence: “në masë të qartë dhe ritmik”. Ky ritëm i qëllimshëm dhe i qëndrueshëm – pa rapsodi drithëruese këtu – është ajo që krijon disponimin karakteristik të Kuranit në “madhësinë e arabishtes”.

Creswell thotë se shfaqjet arabe të Kuranit ndjekin rregullat komplekse të texhvidit, artit të recitimit, i cili rregullon shqiptimin, timbrin vokal, gjatësinë e zanoreve dhe vendosjen e pauzave. Natyrisht, përkthimet në anglisht nuk kanë rregulla të tilla, dhe ndërprerjet në versionin e Habibit dhe Lawrence janë relativisht të hapura për interpretim. Në rastin kur ndërprerjet e rreshtave sinjalizojnë gjithmonë një pauzë në lexim, atëherë ata nuk do të kishin nevojë për presje në skajet e rreshtave të caktuara. Shenjat e

pikësimit tregojnë për një problem më të madh. Megjithëse Habib dhe Lawrence punojnë shumë për të gjetur një ekuivalent në anglisht me poetikën gojore të Kuranit, vetë lidhja e tyre me poezinë – si ajo e shumicës së studiuesve bashkëkohorë – varet nga fjala e shkruar dhe jo nga ajo e folur. Kjo është e dukshme gjatë gjithë përkthimit të tyre, por veçanërisht në aparatën editorial. Në suret më të gjata, për shembull, ato përfshijnë seksione të numëruara për të shënuar ndryshimet e temës. Kjo e bën më të lehtë leximin, megjithëse origjinali nuk ka seksione të tilla. Për më tepër, teksti origjinal kuranor është i mundur të memorizohet edhe për ata që nuk e kuptojnë arabishten, ndërkohë që përkthimi në një gjuhë tjetër nuk është!

Creswell pastaj analizon *“The Devotional Qur’an – Beloved Surahs and verses”* të Shawkat Toorawā, i cili në fëmijërinë e tij në Paris kishte marrë mësim për Kuranin nga një mësues senegalez dhe më pas në Singapor një dijetar tamil e udhëzoi në artin e *taxhvidit*, në kuptimin *“për të përsosur, për të zbukuruar ose për të përmirësuar”*, kurse më pas u bë vetë akademik, duke dhënë mësim letërsinë klasike arabe në Universitetin “Yale”. Në vitin 1996, ndërsa jetonte në Mauritius ai përktheu disa punime, përfshirë edhe suren *“Ja Sin”*, mjaftueshëm për ta inkurajuar të ndërmarrë një punë më të vështirë dhe më të gjatë. Kështu lindi një libër i pazakontë *“The Devotional Qur’an”* një përmbledhje suresh dhe pjesësh të recituara për adhurime të rregullta. Tekstet janë të radhitura përafërsisht në sekuencën që hasin myslimanët dhe i mësojnë përmendësh ato, përkatësisht në favor të sureve më të shkurtëra dhe më të lehta për t’u memorizuar. Me fjalë tjera, nuk përfshihen pjesët që zakonisht u interesojnë studiuesve. Ai është një ekspert nga trajnimi, por një eksperimentalist nga prirja që nuk bën përpjekje për ta bërë Kuranin të pranueshëm për ndjeshmëritë liberale. Përkthimi i tij përmban një gamë të jashtëzakonshme notash nga entuziazmi te ashpërsia. Ne mund të shohim tri krahasime përkthimesh për të njëjtin verset, ku Toorawa i jep këtë kuptim: *“A nuk të qetësova zemrën, kur ishe i rënduar?”*; Habibi dhe Lawrence: *“A nuk e kemi bërë zemrën më të gjerë se më parë?”* Kurse te Salles qëndron *“A nuk e hapëm zemrën tënde?”* Ndërsa Salles nuk u përpoq të rimonte dhe nuk mund të kuptonte përse *“arabët janë kaq të kënaqur me këtë tingëllimë”*, Toorawa bëri të kundërtën, duke menduar se pikërisht kjo është mrekullia e tekstit. Ai citon poetin A.E. Stallings: *“Përkthyesit që përkthejnë poezi me rimë në poezi që nuk rimojnë vetëm sepse pretendojnë se mbajtja e rimës është e pamundur, i kanë bërë dhunë poezisë”*. Rima e tij është po aq eksperimentale sa edhe vargjet, aty ku një rimë bie, një tjetër hapet. Në versionin e tij të Jasinit, duke qenë një sure që i recitohet shpesh një personi në shtratin e vdekjes, ndjejmë lumturinë e një jete që do të vijë: *“Atë Ditë, banorët e kopshtit do të jenë të zënë me gëzimin e tyre. Ata dhe bashkëshortet e*

tyre do të mbështeten në kolltukë, në hije dhe në freski. Ata do të kenë fruta dhe çfarëdo që të kërkojnë me bollëk. I Gjithëmëshirshmi do t’i përshëndesë me një përshëndetje paqeje”.

- 1 Robyn Creswell: *“Bewildered Rhapsodies – The difficult history of translating a miraculous text”*, The New York Review, 13 shkurt 2025.
- 2 M.A.R. Habib dhe Bruce B. Lawrence: *“The Qur’an – A Verse Translation”*, Liveright 2024 dhe *“The Devotional Qur’an – Beloved Surahs and Verses”*, zgjedhur dhe përkthyer nga Shawkat M. Toorawa, Yale University Press 2024.
- 3 Kuran, 52:34
- 4 C.H.Haskins: *“Studies in the history of mediaeval science”*, 2 qershor 2014, f.122.
- 5 Richard W. Southern: *“The Making of the Middle Ages”*, London 1953, f.39-40.
- 6 Jacques Le Goff: *“Medieval Civilization 400-1500”*, në anglisht e përkthyer nga Julia Barrow, Nju Jork 1988, f.145.
- 7 John V. Tolan: *“Saracens – Islam in the Medieval European Imagination”*, New York 2002, f.183.
- 8 David Thomas & Alex Mallett (ed): *“Christian – Muslim Relations – A Bibliographical History”*, Vëllimi i IV (1200-1350), Brill 2012, f.151-158.
- 9 Jo Ann Hocppncr Moran Cruz: *“Popular Attitudes Towards Islam in Medieval Europe”*, verzioni i prezentuar në Konferencën: *“Images of the Other: Europe and the Muslim World before 1700”*, pranë Universitetit Amerikan në Kajro, Pranverë 1995.
- 10 Franco Cardini: *“Europe and Islam – The Making of Europe”*, përkth. angl. Caroline Beamish, Malden 1999, f.143.
- 11 Po aty, f.144.
- 12 Ian Jenkins: *“Writing Islam: Representations of Muhammad, the Qur’an and Islamic Belief and the Construction of Muslim Identity in Early Modern Britain”*, A Thesis Submitted in Candidature for the Degree of Doctor of Philosophy, Cardiff University 2007.
- 13 Thomas Newton: *“A notable historie of the Saracens”*, London 1575, f.3.
- 14 Ian Jenkins, Po aty.
- 15 Martin Luther: *“Preface to the Qur’an of Dr. Martin Luther, Professor of Theology And Pastor of the Church at Wittenberg”* në: Sarah Henrich & James L. Boyce (përkth. dhe ed.): *“Martin Luther - Translation of Two Prefaces on Islam”*, Word & World, XVI, Nr. 2, Pranverë 1996, f.263.
- 16 George W.Forell: *“Luther and the War Against the Turks”* në *“Church History”* #4/1945, f.259, 263.
- 17 Luise von Flotow: *“Translation in the Politics of Culture”*, në Renate Blumenfeld-Kosinski, Luise von Flatow & Daniel Russell (ed.): *“The Politics of Translation in the Renaissance and the Middle Ages”*, Ottowa 2001, f.9.
- 18 Edward Gibbon: *“The History of the Decline and Fall of the Roman Empire”*, Edicioni I III-të, 1777.
- 19 Garry Wills: *“What the Qur’an Meant - And Why It Matters”*, Viking, 2017.
- 20 M.A.S. Abdel Haleem: *“The Qur’an - a new translation”*, Oxford Press 2004.
- 21 Keith Ellison ishte anëtar i parë mysliman i Kongresit të SHBA-së [Minnesota], dhe e përdori këtë kopje të Kuranit në ceremoninë e tij të betimit në vitin 2007. Shkrimi im *“Bota e diversiteteve dhe Kurani i Tomas Xhefersonit”* që e ka botuar revista “Shenja” në mars të vitit 2014, ka të bëjë me studimin e Denise A. Spellberg: *“Thomas Jefferson’s Qur’an – Islam and the Founders”*, të botuar në Nju Jork në vitin 2013.
- 22 Sot vetëm 422 milionë myslimanë flasin arabisht nga popullata e përgjithshme e botës myslimane prej 25% e popullatës së përgjithshme të botës ose zyrtarisht 1.9 miliardë njerëzish sipas të dhënave të vitit 2020.
- 23 Takvim, Sarajevë 1976.
- 24 Për më shumë *“Përpjekja Jonë”*, nr. 19, shkurt 1995.
- 25 E.M. Forster: *“Abinger Harvest”*, London 1961.

Jeta e fakihut të njohur hanefi Imam Serahsiut (v. 483/1090)

• **Blerton Bahtiri**

EMRI DHE PREJARDHJA

Muhamed b. Ahmet Ebi Sehl es Serahsi (v. 483/1090) është njëri prej juristëve islam më të njohur hanefi. Imam Serahsiu, i njohur si “Shemsu’l-eimme” (dielli i imamëve), është dijetar i usulit, dijetar i kelamit dhe dijetar argumentues-referencë (huxh-xheh).¹ Siç mund të kuptohet nga emri i tij, ai lindi në Serahs² ose rrethinat e tij në vitin 483/1090, u shkollua në Buhara, mësoi atje, shkroi veprat e tij në burgun Ozkent dhe kaloi vitet e fundit dhe të lira të jetës së tij pas vitit (480) në një rajon turk. Studiuesi i quajtur Hamidullah është gjithashtu i mendimit se shenjat që tregojnë se imam Serahsiu

është me prejardhje turke janë të forta, pasi ai e kaloi kohën në Ferganë (Merginan) dhe përmend veçanërisht turqit dhe adoleshencën e tyre në veprat e tij.³

EDUKIMI DHE PERSONALITETI SHKENCOR

Kur imam Serahsiu ishte vetëm një fëmijë (10 vjeç), ai shoqëroi të atin në Bagdad për qëllime tregtare. Pas këtij udhëtimi, ai shkoi te juristi i madh Shemsu’l-eimme el Halvani (v.448/1057), i cili jepte mësim në Buhara. Ai shkoi tek ai dhe filloi të studionte shkencën. Imam Serahsi, i cili ishte shumë punëtor dhe i ndritur, u dallua në një kohë të shkurtër.

Lindi në Serahs² ose rrethinat e tij në vitin 483/1090, u shkollua në Buhara, mësoi atje, shkroi veprat e tij në burgun Ozkent dhe kaloi vitet e fundit dhe të lira të jetës së tij pas vitit (480) në një rajon turk.



Mësuesi i tij Halvani, i cili e admironte suksesin e tij, i dha tapetin (lëkurën) në të cilën ai ishte i ulur dhe jepte mësimin. Imam Serhasiu, i cili vazhdoi shkollimin te mësuesi i tij Halvani derisa u bë imam i dalluar i kohës, më vonë trashëgoi pseudonimin e mësuesit të tij, Shemsu'l-eimme (dielli i imamëve). Ai u bë ndër të rrallët e kohës së tij në filozofi dhe logjikë dhe filloi të shkruante vepra dhe të bënte komente. Si rezultat i studimeve dhe debateve të tij, reputacioni i tij u përhap në mbarë botën islame.⁴

Dy figura të rëndësishme që vdiqën në çerekun e fundit të shekullit të pestë, Fahu'l-Islam Pezdevi (v.482/1089) dhe vëllai i tij më i vogël Sadru'l-Islam Pezdevi (v.493/1100), dhe menjëherë pas imam Debusit (v.430/1039), Serhasiu ishte një nga tre figurat e ndritshme në fushën e fikhut. Në të njëjtën kohë, ai studioi me dijetarin e famshëm hanefi Fahu'l-Islam Pezdevi në shkollën e drejtuar nga mësuesi i tij Halvani.⁵ Halvani, i cili pa inteligjencën dhe talentin te nxënësi i tij, e bëri atë të shkruante veprat e quajtura “Sifat’u Eshratu’s-saat” dhe “Makamatu’l-kijame” kur ishte ende student. Siç përmendi imam Serhasiu në parathënien e veprës së tij “Sherhu’s-sijer’l-kebir” dhe siç do të përmendet më vonë, ai mori mësim edhe nga mësuesi tjerë.⁶

Serhasi, i cili përdor arabishten, gjuhën e përbashkët të botës islame, në veprat e tij, ndonjëherë përdor edhe gjuhë të tjera, veçanërisht persishten. Vihet re gjithashtu se ai ishte i mirë në matematikë dhe algjebër dhe kishte interesim të madh për poezinë.⁷ Kur iu përmend se Imam Shafiu (204/820) kishte mësuar përmendësh treqind traktate (risale) hadithi, ai tha: “Ai e mësoi përmendësh zekatin e asaj që mësova përmendësh” dhe i kujtoi bashkëbiseduesit se ai kishte mësuar përmendësh dymbëdhjetë mijë traktate.⁸

Edhe pse transmetimet që i atribuohen imam Serhasiut se ai mësoi përmendësh dyzet herë më shumë hadithe se sa imam Shafiu janë të dyshimta. Mirëpo për kujtesën e tij të fortë që e kishte tregon vetë fakti se pas djegies së librit të tij El Mebsut me plot tridhjetë vëllime, ai përsëri urdhëroi që të shkruhet ky libër ku të gjitha mendimet i tha përmendësh.⁹

Për nga vlera dhe cilësia shkencore e veprave të tij, Kemal Pashë Zade (v.940/1534), një nga dijetarët më të mëdhenj osmanë, imam Serhasiun e radhitë menjëherë pas imam Ebu Hanifes (v.150/767) dhe menjëherë pas imam Muhamed Shejbanit (v.189/805), së bashku me E Hassaf (v.261/874), Et Tahavi (v. 321/933), El Kerhi (v.340/952) dhe El Halvani

Imam Serhasi,
i burgosur
rreth
pesëmbëdhjetë
vjet, filloi t’u
jepte mësim
nxënësve dhe
të shkruante
libra në fund
të pusit, pasi
ashpërsia e
jetës së burgut
u zbut
gradualisht
dhe iu dha leja
për të dhënë
mësim në
burg.

(v.448/1056) e konsideron ndër muxhtehidët e rangut të tretë.¹⁰

Është e sigurt se imam Serhasiu, i cili iu përkushtua shkencës në moshë të re dhe trashëgoi titullin e mësuesit të tij Halvanit me inteligjencën e tij të shkëlqyer dhe përpjekjet e jashtëzakonshme dhe që prodhoi vepra të vlefshme për tema të ndryshme edhe gjatë viteve të tij studentore, mori mësim nga shumë dijetarë të mëdhenj. Ne do të kufizohemi në përmendjen e vetëm dy prej dijetarëve më të rëndësishëm nga të cilët ai mori mësim:

-El Halvani (v.448/1056), Shemsu’l-Eimme (Dielli i Imamëve) Ebu Muhamed Abdulaziz b. Ahmet b. Nasr b. Salih el Halvani.¹¹

-Es Sugdi (v.461/1069), Ruknu’l-Islam Ebu’l-Hasae Ali b. Muhamed.¹²

Disa nga studentët e tij më të famshëm janë:

Ebu Bekër Muhamed b. Ibrahim el Hasiri (v.500/1107), Rukneddin b. Hasan en Kusheni (v.520/1126), Abdulaziz b. Omer b. Maze (v.536/1141), Osman b. Ali b. Muhamed el Bejkandi (v.552/1157) dhe dijetarët të cilët mendohet se janë ndër dijetarët e të njëjtit shekull si Ebu Hafs Omer b. Habib dhe Mahmud b. Abdilaziz el Ozxhendi.¹³

PERIUDHA KUR JETOI DHE JETA NË BURG

Duke qenë se veprat e dijetarëve janë pasqyra që pasqyrojnë jetën e shoqërisë në periudhën e tyre, lidhja mes veprave dhe kohës është shumë e rëndësishme. Siç mund të kuptohet nga ajo që është shkruar për të dhe veprat e tij, periudha e imam Serhasiut ishte aktive dhe komplekse. Nga njëra anë, kryqëzatat, nga njëra anë, trazirat e padrejta tatimore në botën islame, nga ana tjetër, debatet teologjike midis sunitëve dhe kundërshtarëve të tyre, mutezilitëve, të cilat ishin të zakonshme në epokën e Karakhanidëve (840-1222) dhe ndryshimet e shpeshta në pushtet ishin problemet kryesore të kësaj periudhe.¹⁴

Imam Serhasiu ishte dëshmitar i periudhës Karakhanid,¹⁵ e cila u desh t’i linte vendin selxhukëve pas një kohe të shkurtër dhe e vetmja ngjarje e njohur e jetës së tij është burgimi i tij për një kohë të gjatë në qytetin e Ozkentit. Ky burgim zgjati nga viti 466/1073 apo më herët deri në vitin 480/1087. Sa i përket arsyes së burgosjes së tij, edhe pse nuk ka informacion specifik, arsyeja më e fortë është se ai fliste të drejtën.¹⁶ Pas kësaj, udhëheqësi i asaj kohe e arrestoi dhe e hodhi në një nga pusët e kështjellës së kryeqytetit në Ozkentit.

Imam Serahsi, i burgosur në këtë vend të turpshëm për rreth pesëmbëdhjetë vjet, filloi t'u jepte mësim nxënësve dhe të shkruante libra në fund të pusit, pasi ashpërsia e jetës së burgut u zbut gradualisht dhe iu dha leja për të dhënë mësim në burg.¹⁷

Një arsye tjetër janë fjalët e tij këshilluese drejtuar udhëheqësit të asaj periudhe, ose duke i thënë udhëheqësit që vendosi të martohej me konkubinën (xharije) e tij të liruara para përfundimit të periudhës së pritjes së saj se kjo nuk ishte e lejueshme. Ata që kanë shkruar përkthimin e shtetit të tij janë të mendimit se kjo ngjarje e fundit ka ndodhur pasi ai doli nga burgu dhe se duhet të ketë pasur arsye më të rënda sesa të martohej me një konkubinë për një jetë burgu që vazhdoi për rreth pesëmbëdhjetë vjet gjatë mbretërimit të tre sundimtarëve të ndryshëm.

Në thelb, arsyeja për burgosjen e imam Serahsiut është besimi se ka pasur një mosmarrëveshje me kundërshtarët e tij, mutezilitë, rreth teologjisë dhe jo fikhut. Në fakt, imam Serahsi përdori këto shprehje për veten e tij në veprat e tij të shkruara në burg: “Një shërbëtor larg përçarjes, një ndriçues dhe një tregues i së vërtetës, prandaj ai u burgos si një i burgosur” ose “Ai donte për të eliminuar të pavërtetën e vërtetuar dhe për

këtë arsye u internua dhe u burgos” pohon edhe këtë mendim.¹⁸


VEPRAT E TIJ

Veprat e tij më të vlefshme, si për nga përmbajtja ashtu edhe nga vëllimi, imam Serahsiu i ka shkruar gjatë kohës që ishte në burgun e Ozkentit, ku qëndroi për afro pesëmbëdhjetë vjet (466/1073-480/1087). Në burime dhe në disa pasazhe në veprat e tij thuhet se imam Serahsiu gjatë burgimit pesëmbëdhjetëvjeçar nuk kishte me vete asnjë libër e fletore dhe edhe pse i privoheshin nga të gjitha mundësitë, i kishte vënë nxënësit të shkruanin librat e tij ku të gjitha ato libra i tha dhe ia diktoi përmendsh nxënësve të tij.

VEPRAT E TIJ TË ASAJ PERIUDHE DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE TË SHKURTRA

a. Kitabu'l-mebsut (I-XXX): Pasi imam Serahsiu u burgos në Ozkent, ai pranoi të merrej me arsim me kërkesën e disa miqve të tij dhe zyrtarëve të burgut. Ai e filloi mësimin dhe shkrimin e tij duke komentuar veprën e quajtur “El Muhtasar” nga El Mervezi (v.334/945), e cila ishte një kopje e shkurtër e veprës së quajtur “El Asl” e imam Muhamed esh Shejbanit (v.189/805). Dijetari i madh

Veprat e tij më të vlefshme, si për nga përmbajtja ashtu edhe nga vëllimi, imam Serahsiu i ka shkruar gjatë kohës që ishte në burgun e Ozkentit, ku qëndroi për afro pesëmbëdhjetë vjet (466/1073-480/1087).



Kjo vepër e imam Serahsiut e quajtur “Mebsut” është një koment tridhjetë vëllimesh i “Muhtesarit” të Hakim el Merveziut dhe kjo vepër madhështore është vepra e cila me argumentet e saj e studion edhe vetë medhhebin hanefi.

hanefi El Mervezi e përpiloi veprën e tij të quajtur “El Kafi” nga veprat e Shejbanit për lehtësinë e studentëve. Kjo vepër e imam Serahsiut e quajtur “Mebsut” është një koment tridhjetë vëllimesh i “Muhtesarit” të Hakim el Merveziut dhe kjo vepër madhështore është vepra e cila me argumentet e saj e studion edhe vetë medhhebin hanefi. Në fikhun hanefi, kur përmendet “Shemsu’l-eimme” (dielli i imamëve) duhet kuptuar imam Serahsiu, e kur përmendet “El Mebsut” duhet kuptuar libri “Mebsutu’s-Serahsi”¹⁹

b. Usulu’s-Serahsi (I-II): Pasi kishte shkruar më lart veprën e tij madhështore dhe të detajuar të quajtur “El Mebsut”, imam Serahsiu vendosi të shkruante veprën e tij me dy vëllime të quajtur “Usul” si një parahyrje për librin e lartcekur.

c. Sherhu’s-sijeri’l-kebir (I-IV): Ky është komenti i veprës së Imam Muhamed esh Shejbanit (v.189/805) të quajtur “Sijeru’l-kebir”. Imam Serahsi filloi të shkruante veprën e tij në ditët e para të muajit Dhulkade të vitit 479/1086 derisa imam Serahsiu ishte në burg në Ozkent. Kur ishte fjala për kapitullin “Shurut”, imam Serahsi u lirua, pastaj shkoi në Fergane (Merginan) dhe përfundoi vazhdimin e punës me nxënësit e tij.²⁰

d. Sherhu zijadati’z-zijadat (en Nuket): Sipas deklaratës së vetë Serahsiut, është një koment që ai kishte shkruar mbi frazat dhe shenjat e përmendura në librin e imam Muhamedit “Zijadatu’z-zijadat” derisa ishte në burg në Ozkent.

VDEKJA E TIJ

Nëse i hedhim një vështrim të përgjithshëm historisë së shkencave, shohim se njerëzit që përfaqësojnë shkencën kanë qenë herë pas here në situata shumë të vështira, por megjithatë vazhdojnë aktivitetet e tyre shkencore që ata besojnë se janë të drejta. Në librat e historisë, data e vdekjes së tij përmendet si 483, 490, 500 hixhri. Autori i librit i Keshfu’dh-Dhunun, Katip Çelebiu, shënon datën e vdekjes së tij si 483/1090.²¹

1 Omer Riza, Kehhale, *Mu’xhemu el-Muellifin*, Damask, 1957, vëll. VIII, f. 267.; Hajruddin, ez-Zirikli, *el-A’lam*, Bejrut, 1969, vëll. VI, f. 208.

- 2 Abdulhej, el Leknevi, *El Fevaidu el Behijje fi Teraxhim el Hanefijje*, Egjipt, 1906, f. 158.; Ahmet, Özel, *Hanefi Fikih Âlimleri*, TDV Yay, 1990, Ankara, f. 42.
- 3 Yusuf Ziyâ, Kavakçı, *XI. ve XII. Asırlarda Karahanlılar Devrinde Mâveraü’n-nehr İslâm Hukukçuları*, Atatürk Üniversitesi Yay, 1976, Ankara, f. 56.
- 4 Muhammed, Hamidullah, *Serahsi’nin Devletler Umûmi Hukukundaki Hissesi, Serahsi Armağanı*, Atatürk Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Yay, 1965, Ankara, f. 16.
- 5 Ömer Nasûhî, Bilmen, *Hukûkî İslâmiyye ve Istilâhât-ı Fikhiyye Kâmusu*, 1967, İstanbul, vëll. I, f. 362.
- 6 Schacht, *Serahsi’nin Hayatı ve Eserleri Hakkında Bazı Notlar, Serahsi Armağanı*, f. 7.
- 7 Muhammed, Hamidullah, *Serahsi Armağanı*, f. 24.
- 8 Ahmet b. Mustafa, Tashkopruzade, *Miftah es-Saade*, Kajro, vëll. II, f. 186.
- 9 Schacht, *Serahsi’nin Hayatı ve Eserleri Hakkında Bazı Notlar, Serahsi Armağanı*, f. 11.
- 10 Abdulhej, el Leknevi, *El Fevaidu el Behijje fi Teraxhim el Hanefijje*, Egjipt, 1906, f. 158.
- 11 Ahmet, Özel, *Hanefi Fikih Âlimleri*, TDV Yay, 1990, Ankara, f. 39.; Yusuf Ziyâ, Kavakçı, *XI. ve XII. Asırlarda Karahanlılar Devrinde Mâveraü’n-nehr İslâm Hukukçuları*, Atatürk Üniversitesi Yay, 1976, Ankara, f. 57, 40-42.
- 12 Omer Riza, Kehhale, *Mu’xhemu el Muellifin*, Damask, 1957, vëll. VII, f. 79.
- 13 Ahmet, Özel, *Hanefi Fikih Âlimleri*, TDV Yay, 1990, Ankara, f. 42.; Yusuf Ziyâ, Kavakçı, *XI. ve XII. Asırlarda Karahanlılar Devrinde Mâveraü’n-nehr İslâm Hukukçuları*, Atatürk Üniversitesi Yay, 1976, Ankara, f. 57.
- 14 Salih, Tuğ, *Eserlerinde Rastlanan İfâdelerine Göre İmam Serahsi’nin Hapis Hayatı, Serahsi Armağanı*, f. 49.
- 15 Muhammed, Hamidullah, *Serahsi Armağanı*, f. 16.
- 16 Schacht, *Serahsi’nin Hayatı ve Eserleri Hakkında Bazı Notlar, Serahsi Armağanı*, f. 9.
- 17 Salih, Tuğ, *Eserlerinde Rastlanan İfâdelerine Göre İmam Serahsi’nin Hapis Hayatı, Serahsi Armağanı*, f. 43.
- 18 Schacht, *Serahsi’nin Hayatı ve Eserleri Hakkında Bazı Notlar, Serahsi Armağanı*, f. 9-10.
- 19 Katip, Çelebi, *Keshf edh Dhunun an Asam el Kutub ve el Funun*, 1943, İstanbul, vëll. II, f. 1580.
- 20 Ahmet b. Mustafa, Tashkopruzade, *Miftah es-Saade*, Kajro, vëll. II, f. 186.
- 21 Muhammed, Hamidullah, *Serahsi Armağanı*, f. 16.; Abdulhej, el Leknevi, *El Fevaidu el Behijje fi Teraxhim el Hanefijje*, Egjipt, 1906, f. 158.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, Z. ALBIN KURTI, SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ

Më 13 mars 2025, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga disa ministra të kabinetit të tij qeveritar, shtroi iftar për kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij.

Kryeministri Kurti me këtë rast u uroi të gjithë besimtarëve myslimanë muajin Ramazan, duke u uruar agjërime të lehtë dhe të pranuar.

Ai gjithashtu falënderoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për rolin dhe kontributin e tyre të rëndësishëm dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFEN E UNMIK-UT NË KOSOVË, ZNJ. CAROLINE ZIADEH



movimin e tolerancës ndërfaqetare dhe harmonisë sociale në vend.

Myftiu Tërnavë theksoi kontributin e BIK-ut në ruajtjen e bashkëjetesës fetare dhe përkushtimin për ndërtimin e urave të mirëkuptimit mes komuniteteve. Ai falënderoi UNMIK-un për bashkëpunimin në promovimin e dialogut ndërfaqetar.

Znj. Ziadeh vlerësoi rolin e BIK-ut në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë, duke nënvizuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit me institucionet fetare për forcimin e kohezionit social dhe respektit ndërkomunitar.

Më 18 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim shefen e

Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), znj. Caroline Ziadeh. Ata diskutuan për rolin e BIK-ut në pro-

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ATASHEUN PËR ÇËSHTJE FETAR TË ARABISË SAUDITE, AMER ALANAZI

Më 4 mars 2025, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, priti në takim atasheun për Çështje Fetare nga Ministria saudite, z. Amer Alanazi.

Në takim u diskutua për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve fetare të Kosovës dhe Arabisë Saudite, me theks në shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e lidhjeve vëllazërore.

Myftiu Tërnavë falënderoi Arabinë Saudite për mbështetjen e vazhdueshme humanitare, fetare dhe arsimore, duke shprehur shpresën për bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen.



Z. Alanazi rikonfirmoi mbështetjen e Arabisë Saudite dhe rëndësinë e

projekteve të përbashkëta në fushën e edukimit fetar.

U INAUGURUA PROGRAMI PËR SHPËRNDARJEN E IFTAREVE DHE HURMAVE I MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE

Më 4 mars 2025, në ambientet e Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë, me pjesëmarrjen e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, bashkëpunëtorëve të tij, profesorëve të Medresesë dhe Fakultetit të Studimeve Islame, si dhe atasheut për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, z. Amer Alanazi, dhe konsulit saudit, Sultan es Sehli, u inaugurua programi i shpërndarjes së iftareve dhe hurmave i Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Myftiu Tërnavë falënderoi Arabinë Saudite për ndihmën e vazhdueshme ndaj Kosovës dhe BIK-ut, duke theksuar përkushtimin për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Atasheu Alanazi u shpreh i lumtur për nisjen e programit në Kosovë,

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MYFTIUN E TIRANËS, GAZMENT EF. TEQJA

Më 11 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim vëllazëror myftiun e Tiranës, njëherësh imamin e Xhamisë së Namazgjasë, Gazment ef. Teqen.

Gjatë këtij takimi Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi për marrjen e detyrës si imam i Xhamisë së Namazgjasë, duke i dëshiruar suksese në këtë përgjegjësi të rëndësishme fetare dhe shoqërore.

Myftiu Tërnavë dhe myftiu Teqja, shprehën gatishmërinë për të forcuar bashkëpunimin mes institucioneve fetare në Kosovë dhe Shqipëri, me

KRYETARI I AAK-SË, RAMUSH HARADINAJ, SHITROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ

Më 11 mars 2025, për nder të muajit të bekuar Ramazan, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, shitroi iftar për kryetarin e



duke uruar fillimin e Ramazanit dhe lutur për pranimin e veprave të mira të besimtarëve gjatë këtij muaji.

Në fund, për të pranishmit u shtrua iftari i parë i këtij projekti, i cili këtë vit realizohet në mbi 102 shtete.



synim të përmirësimit të jetës fetare dhe kultivimin e vlerave islame në të dy vendet. Ata theksuan rëndësinë e koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta në shërbim të besimtarëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Takimi u zhvillua në frymën e vëllazërisë dhe respektit të ndërsjellë, duke konfirmuar angazhimin për të vijuar rrugën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në dobi të besimtarëve myslimanë.



Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij. “Në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, tradita jonë e iftareve të përbashkëta vazhdon. Sonte, selia e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës u nderua sërish nga prania e Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorëve nga Bashkësia Islame e Kosovës. Këto

ngjarje, simbolizojnë mirënjohjen tonë për kontributin e Bashkësisë Islame në të gjitha etapat e rrugëtimit tonë drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Të gjithë besimtarëve, ju dëshiroj agjërime të lehtë përgjatë ditëve të mbetura të Ramazanit” – thuhet në postimin e kryetarit Haradinaj.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA KËSHILLI I BI-SË SË GJILANIT



Më 14 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në

iftarin tradicional “Iftari na bashkon”, i cili u shtrua nga Këshilli i Bashkësisë Islame i Gjilanit.

Në këtë iftar, përveç besimtarëve të shumtë, mori pjesë edhe kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, deputetë të Kuvendit të Kosovës, familjarë të dëshmorëve, veteranë, pjesëtarë të FSK-së, KFOR-it turk, imamë dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme të Gjilanit.

Nga një fjalë përshëndetëse para të pranishmëve e mbajtën kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu dhe kryetari i Gjilanit, z. Alban Hyseni, teksa fjalimin kryesor e mbajti Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili përcolli mesazhet dhe porositë që duhet ta shoqërojnë besimtarin gjatë muajit Ramazan.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA KËSHILLI I BI-SË SË GJAKOVËS

Më 15 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në iftarin e shtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame i Gjakovës, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve dhe partive politike, personalitete nga fusha të ndryshme, si dhe qytetarë dhe xhamatlinj nga të gjitha xhamitë e Gjakovës.

Në emër të nikoqirit, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës, dr. Valon ef. Myrta, i përshëndeti të pranishmit dhe, pasi i falënderoi për pjesëmarrjen në këtë iftar madhështor, foli shkurtimisht për vlerat morale dhe shpirtërore që ky muaj i begatë kultivon si në aspektin personal të individit ashtu edhe në atë shoqëror.

Me një fjalë rasti të pranishmëve i drejtua edhe Myftiu Tërnavë i cili ndër të tjera tha: “Ne duhet të jemi gjithërë krenarë që i takojmë këtij atdheu dhe




këtij kombi, sepse kjo ka qenë dhe është dëshirë dhe vullnet i të Madhit Zot, duke pasur parasysh se ne e kemi dinin e të Madhit Zot, i përkasim Islamit me shumicë, mirëpo respektojmë dhe nderojmë edhe besimet tjera të vëllezërve dhe motrave tanë duke e ruajtur në vazhdimësi kom-

paktësinë e vëllazërinë dhe bashkërisht duke quar përpara proceset për të cilat ka shumë nevojë vendi ynë dhe kombi ynë.”

Iftari përfundoi me një lutje të përbashkët nga të pranishmit.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT



Në rend të ditës për këtë mbledhje Kryesia shqyrtoi dhe miratoi raportin e Kryesisë për vitin 2024, shqyrtoi dhe miratoi pasqyrën financiare për vitin 2024, si dhe shqyrtoi dhe miratoi llogaritë përfundimtare të Këshillave të BI-së për vitin 2024.

Po ashtu, gjatë kësaj mbledhje u diskutua edhe për përgatitjet për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Më 16 mars 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, të kryesuar nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

MYFTIU TËRNAVA SHTRIOI IFTARIN TRADICIONAL PËR NDER TË FITORES SË BEDRIT

Më 16 mars 2025, për nder të ditës së fitores së Bedrit, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shtrioi iftar për administratën e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ky iftar tashmë tradicional shtrohet për ta kujtuar rëndësinë e kësaj dite, por edhe për t'u njohur me sukseset, punët dhe angazhimet përgjatë muajit Ramazan.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me këtë rast falënderoi administratën e Këshillave për punën dhe angazhimin e treguar gjatë gjithë vitit, por në veçanti gjatë muajit Ramazan. Ai mes



të tjerash kujtoi edhe rolin dhe rëndësinë e veçantë që kanë imamët në kumtimin e fjalës së Zotit, duke i

porositur ata që ta ruajnë unitetin dhe të jeni gjithnjë të bashkuar.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË INAUGURIMIN E PROJEKTIT TË XHAMISË SË GURIT NË MALISHEVË

Më 19 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin e organizuar nga Këshilli i BI-së së Malishevës, ku u bë edhe inaugurimi i projektit të Xhamisë së Gurit, që pritet të ndërtohet në qendër të qytetit.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin e Malishevës, z. Ekrem Kastrati, për bashkëpunimin me Këshillin e BI-së së Malishevës dhe gjithashtu administratën e këtij

Këshilli për realizimin e projektit, që ai e quajti tejet madhështor.

Ai theksoi se sipas mësimëve kur'anore dhe haditheve profetike, përkujdesës të xhamive janë besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin. Që nga momenti kur hapen themelet e kësaj xhamie – tha ai – për ata që kontribuojnë, do të hapen themelet e shtëpive të tyre në Xhenet.

Kryetari Kastrati përgëzoi Këshillin për projektin dhe shprehu gëzimin institucional për këtë iniciativë, duke

theksuar se presin me padurim përrurimin e xhamisë.

Kryetari i Këshillit të BI-së, Sead ef. Paqarizi, falënderoi të gjithë kontribuesit, me mirënjohje të veçantë për bizneset për përkrahjen e vazhdueshme.

Fjalë rasti mbajti edhe drejtori i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", i cili uroi besimtarët dhe njoftoi se Shoqata do të kontribuojë me 100.000 euro për projektin.

Në fund, pas paraqitjes vizuale të projektit, u bë e ditur edhe mbështetja e disa bizneseve dhe individëve.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI PËR NGUSHËLLIME FAMILJEN THAÇI

Më 20 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi familjen e ish-presidentit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për t'iu shprehur ngushëllime me rastin e vdekjes së babait të ish-presidentit, bacës Haxhi Thaçi.

Myftiu Tërnavë shprehu ngushëllime në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të saj, duke lutur Zotin që rahmetliun ta ketë



marrë në mëshirën e Tij, si dhe ta ketë shpërblyer me të mirat e Xhenetit.

Ai më pas shkroi disa fjalë për bacën Haxhi edhe në librin e ngushëllimeve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË VAKËFEVE TË TURQISË

Më 20 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë, më konkretisht z. Yılmaz Kılınç, drejtorin e Regjionit të Konyas dhe z. Haluk Yıldız, drejtorin e Regjionit të Bursës.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnavë ka shprehur mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të ofruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë për projektet humanitare dhe fetare në Kosovë. Ai ka vlerësuar sidomos ndihmat e dhëna për komunitetin, si dhe



organizimin e iftareve gjatë muajit të bekuar Ramadan.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit turq kanë ritheksuar gatishmërinë e tyre për të vazhduar bashkëpunimin dhe

për të mbështetur projektet që kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË TRYEZËN E DIALOGUT NDËRFETAR “DIALOGU NDËRFETAR SIPAS MODELIT SHQIPTAR”



Më 21 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në Tryezën e dialogut ndërfetar “Dialogu ndërfetar sipas modelit shqiptar”, të organizuar nga Fondacioni “Drita”.

Në hapje të Tryezës morën pjesë prijësit e komuniteteve fetare në Kosovë dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme vendore.

Myftiu Tërnavë në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve çmoi lart rolin e prijësve fetar ndër shekuj të shqiptarët, të cilët, sipas tij, përdorën fenë për të mbrojtur popullin nga orvatjet e armiqve. Ai tha se: “Një meritë e veçantë e parisë sonë fetare, e insti-

tucioneve tona fetare është ruajtja e besimtarëve dhe e popullit tanë nga orvatjet e armiqve tanë që besimet tona t’i përdornin si mjete për t’i përçarë shqiptarët. Këtë hile e këtë mision të kobshëm për ne, paria jonë fetare arriti që ta parandalojë dhe të dështojë që në zanafillë të tij, e në vend të grackave të armiqve, ata kultivuan drejt mësimet e feve, me këtë rast, këtu kujtoj haxhi Ymer Prizrenin, haxhi Vehbi Dibrën, dom Nikollë Kaçorrin, Gjergj Fishtën, hafëz Ali Korçën, Fan Nolin, mulla Idriz Gjilanin e deri të hafëz Sabri Koçi e at Zef Pllumbli.”

Duke folur për harmoninë ndër-fetare, Myftiu tha se këto janë vlera të njohura botërisht dhe të çmuara si në

Lindje ashtu edhe në Perëndim, përfshirë Mekën, Vatikanin dhe Jerusalemin.

Ai përmendi kontributin e çmuar të dr. Rexhep Bojës dhe ipeshkvit Mark Sopi, të cilët kultivuan kohezionin shoqëror në kohë të vështira, duke promovuar bashkëjetesën ndërfetare.

Në përmbyllje, Myftiu theksoi se këto vlera u vunë në funksion edhe në vitet ’90 gjatë okupimit serb: “Asokohe që një mobilizim i përgjithshëm, për të refuzuar nënshtrimin dhe okupimin. Edhe në këtë rast rol të rëndësishëm kanë pasuar dy bashkësitë tona fetare, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Kisha Katolike, të cilat qenë në ballë të popullatës për t’i udhëzuar dhe për ta përballuar situatën e krijuar. Infrastruktura e dy bashkësive fetare, xhami e kisha, u vunë në funksion të çështjes kombëtare e në shërbim të popullit për të mbijetuar e për të realizuar projektin që sot e kemi realitet – vendin tonë të lirë e demokratik.”

Gjatë seancës, fjalë rasti mbajtën edhe ipeshkvi Dodë Gjergji, pastori Artur Krasniqi dhe përfaqësuesi hebre, z. Hysen Hyseni. Në përmbyllje, prijësit fetarë nënshkruan deklaratën e përbashkët.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN MADHËSHTOR NË DEÇAN

Më 22 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në iftarin madhështor, në të cilin morën pjesë mbi 1000 besimtarë, dhe i cili u organizua nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Deçan, në bashkëpunim me Komunën e Deçanit.

Ky tubim i madh u mbajt në një atmosferë të ngrohtë fetare dhe vëllazërore, duke bashkuar qytetarë nga e gjithë zona dhe personalitete të ndryshme të kësaj komune.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se iftaret e tilla ofrojnë një ndjenjë vëllazërie dhe unitetit.



Në këtë iftar i pranishëm ishte edhe ish- kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili u shpreh i lumtur për këtë organizim vëllazëror.

Një fjalë përshëndetëse drejtuar të pranishmëve mbajti edhe kryetari i Këshillit të BI-së së Deçanit, Naser ef. Tolaj, i cili falënderoi të pranishmit

dhe njëkohësisht falënderoi edhe kryetarin e Deçanit, z. Bashkim Ramosaj për bashkëpunimin dhe për këtë iftar të përbashkët.

Pas iftarit të përbashkët u mbajt një program i bukur me lexim Kurani, ilahi dhe pika të ndryshme artistike.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DR. HASAN AL ARISHIN

Më 25 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim doktorin e Tefsirit dhe Shkencave Kuranore, dr. Hasan al Arishin, i cili ka qenë për vizitë gjatë muajit Ramazan si imam në xhami të ndryshme të Kosovës.

Myftiu Tërnavë shprehu falënderimet e tij për dr. Al Arishin, për këtë vizitë, e përmes tij falënderoi edhe Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite për këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Nga ana e tij, dr. Al Arishi, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për



mundësinë që ai të jetë në shërbim të besimtarëve kosovarë gjatë muajit Ramazan. Ai tha se kjo ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme dhe se

është ndarë tejet i kënaqur me mikpritjen e besimtarëve në xhami të ndryshme të Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA KRYETARI I PDK-SË, Z. MEMLI KRASNIQI



Më 25 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në

iftarin e shtruar nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Memli Krasniqi.

Në postimin e kryetarit Krasniqi thuhet se Ramazani është një periudhë e çmuar e vitit që na kujton vlerat e solidaritetit, mirësisë dhe unitetit – parime këto që na bëjnë më të fortë si shoqëri. “Muaji i bekuar Ramazan është kohë reflektimi dhe afrimi me njëri-tjetrin, për të ndarë jo vetëm bukën, por edhe përkushtimin për një të ardhme më të mirë për vendin tonë” – thuhet ndër të tjera në postimin e kryetarit Krasniqi.

KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 27 mars 2025, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i Kuvendit, dr. Ajni ef. Sinani.

Kuvendi gjatë kësaj mbledhje shqyrtoi raportin e punës së Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për periudhën 1 janar 2024 – 31 dhjetor 2024, më pas shqyrtoi raportin e Komisionit Financiar të Kuvendit të BIK-ut, si dhe shqyrtoi raportin e



Pasqyrës për të hyrat dhe të dalat e Kryesisë (llogaria përfundimtare) për vitin 2024.

Pas diskutimeve të përgjithshme nga anëtarët e Kuvendit të BIK-ut, këto raporte u miratuan me votat e anëtarëve të Kuvendit.

Gjatë kësaj mbledhje, një fjalë rasti para anëtarëve të Kuvendit e mbajti

edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili paraqiti një raport të përgjithshëm mbi mbarëvajtjen e punëve të Bashkësisë Islame të Kosovës, veçanërisht gjatë këtij muaji të bekuar Ramazan.

Në fund të mbledhjes, me propozimin e Myftiut Tërnavë, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, shprehu

shqetësimin e tij për rastet e fundit të vrasjeve që ndodhën në vendin tonë, duke bërë apel që të ndalen rastet e tilla. Myftiu Tërnavë u shprehu ngushëllime familjarëve të të vrarëve, duke lutur Zotin që këto të jenë rastet e fundit të vrasjeve në vendin tonë.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA KRYETARI I LDK-SË, Z. LUMIR ABDIXHIKU



Më 29 mars 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë

në iftarin e shtruar nga kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Lumir Abdixhiku.

Kryetari Abdixhiku në postimin e tij tha se ky muaj duhet të na shërbejë si mësim për rikujtim për më shumë solidaritet, tolerancë dhe paqe në vendin tonë.

“Le të shërbejnë ky muaj, si mësim e rikujtim për më shumë solidaritet, tolerancë e paqe në vendin tonë. Qytetarët tanë gjithmonë janë shquar për vlera humane e vëllazërore duke u dëshmuar si shoqëri që respekton njëri-tjetrin e ndanë me ata në nevojë – prandaj, le të mirëmbajmë këto vlera dhe përtej këtij muaji të shenjtë” – thuhet në postimin e kryetarit Abdixhiku.

BESIMTARËT MYSLIMANË FESTUAN FESTËN E FITËR BAJRAMIT

Më 30 mars 2025, besimtarët myslimanë në Kosovë festuan festën e Fitër Bajramit. Kjo festë vjen si një dhuratë shpirtërore pas muajit të bekuar Ramazan, gjatë të cilit besimtarët agjërojnë dhe shtojnë adhurimet e tyre.

Manifestimi qendror për festën e Fitër Bajramit u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Ky manifestim filloi me faljen e namazit të sabahut, të cilit i priu kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, për të vazhduar më pas me programin artistik, me ilahi dhe pjesë nga Kurani. Ligjëratën tematike kushtuar kësaj feste e mbajti Agim ef. Hyseni, anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Manifestimi vijoi më pas me faljen e namazit të Bajramit, të cilit i priu kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti.



Hytben e Fitër Bajramit e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili përmes saj përcolli mesazhet për paqe, dashuri, harmoni dhe tolerancë ndërmjet njerëzve. Në veçanti Myftiu Tërnavë foli për rëndësinë që Islami i jep familjes dhe prindërve.

“Normat të cilat burojnë nga Kurani dhe hadithet e Muhamedit a.s., saktojnë se një qift bashkëshortor – burri dhe gruaja, janë themel i familjes. Po ashtu, prindërit janë edhe edukatorët e parë të fëmijëve, duke i pajisur ata me edukatë dhe moral të lartë, me qëllim që të kemi familje dhe shoqëri të formuar mirë, në rrugën e Zotit dhe në shërbim të familjes, rrethit dhe shoqërisë. Sipas Islamit, fëmijët janë një amanet nga Zoti, e që ne si prindër, e kemi për obligim të kujdesemi, t'i ruajmë, t'i edukojmë, t'i shkollojmë e t'i formojmë si qenie fisnike, duke ua mbjellë në zemrat e tyre dashurinë për njëri-tjetrin, familjen, atdheun dhe shoqërinë.”

Myftiu Tërnavë përveç kujdesit që duhen të kenë prindërit ndaj fëmijëve, foli edhe për përkujdesjen që duhet të kenë fëmijët ndaj prindërit, sidomos kur ata të kenë arritur moshën e shtyrë.

“Përveç kësaj, edhe prindërit janë amanet i fëmijëve, në veçanti atëherë kur ata kanë arritur moshën e pleqërisë, apo kanë kërkesën më të madhe për përkujdesje dhe ndihmë nga ana e fëmijëve të tyre. Islami urdhëron për ruajtjen e lidhjeve familjare dhe fafëfisnore, urdhëron për përkujdesje të vazhdueshme dhe të drejtë ndaj prindërve, sidomos kur ata janë në moshë të shtyrë”, tha Myftiu Tërnavë.

Në fund të kësaj hytbeje, Myftiu Tërnavë apeloj të ndalën vrasjet dhe t'i kushtohet rëndësi jetës së njeriut duke marrë shkas rastet e fundit në Kosovë. Ai tha se Islami na mëson ndryshe.

“Pavarësisht motiveve dhe rrethanave, në Islam, vrasja është një akt i ndaluar dhe është një nga gjynahet më të mëdha. Feja islame i jep shumë rëndësi jetës së njeriut dhe mbrojtjes së saj. Kurani e potencon qartë ndalimin e vrasjes së tjetrit, për se në të thuhet:



“Kush vret një njeri pa të drejtë, është sikurse të ketë vrarë të gjithë njerëzimin. Dhe kush shpëton një jetë, është sikurse të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin.” (Kuran, 5:32)

Andaj, edhe njëherë apelojmë për respektimin e jetës së çdo individi dhe për ndalimin e dhunës ndaj të pafajshmëve”, tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

KRYESIA E BIK-UT HAP DYERT PËR URIMET E FITËR BAJRAMIT

Më 30 mars 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, hapi dyert e selisë qendrore me rastin e festës së Fitër Bajramit, duke pranuar urime nga liderët shtetërorë, përfaqësues të partive politike dhe komuniteteve fetare.

Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti vizituan selinë e BIK-ut për të përcjellë

urimet e tyre për Myftiun e Kosovës, Naim Tërnavë dhe besimtarët myslimanë, duke theksuar rëndësinë e harmonisë dhe solidaritetit mes qytetarëve.

Për të urrear Myftiun Tërnavë dhe besimtarët myslimanë të pranishëm qenë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, kryetari i

Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj.

Ndër të parët që vizituan selinë e BIK-ut për të urrear Fitër Bajramin ishte Ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës, Dodë Gjergji.



Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani



Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti



Kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama



Kryetari i PDK-së, z. Memli Krasniqi



Kryetari i LDK-së, z.Lumir Abdixhiku



Kryetari i AAK-së, z.Ramush Haradinaj.



Kryetari i PD-së, z.Ferid Agani



Ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës, z.Dodë Gjergji



KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESE NË MANIFESTIMIN KURANOR NË FERIZAJ



Me rastin e Muajit të Bekuar të Ramazanit, në Xhaminë e Madhe të Ferizajt u mbajt manifestimi Kuranor “Me zërat e Ferizajt në Muajin e Zbritjes së Kuranit”, organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame i Ferizajt.

Ky manifestim, u hap me një fjalë rasti dhe mirëseardhje nga imami i kësaj xhamie, Mustafë ef. Ahmeti.

Në këtë tubim mori pjesë kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, i cili foli për zbritjen e Kuranit në Ramazan dhe

rëndësinë e Fjalës së Zotit në jetën e besimtarëve.

Në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt, fjalën përshëndetëse e mbajti kryeimami i Këshillit, Ibrahim ef. Beqiri, i cili vlerësoi lart lexuesit ferizajas të Kuranit, duke theksuar se Kurani është dritë për zemrat e sinqerta dhe përhapet përtej kohës dhe hapësirës..

Pjesë e programit ishin lexuesit e mirënjohur ferizajas:

Hfz. Egzon Ibrahim

Hfz. Armend Beqiri

Hfz. Albion Çerkini

Ata e pasuruan programin duke lexuar pjesë nga Kurani Fisnik.

U MBAJT KONFERENCA GLOBALE ME TITULL “NDËRTIMI I URAVE NDËRMJET MEDHHEBEVE DHE SEKTEVE”

Nën patronazhin e Kujdestarit të Dy Xhamive të Shenjta, Mbretit Selman bin Abdulaziz al Saud, në Meke, u mbajt edicioni i dytë i Konferencës Globale me titull “Ndërtimi i urave ndërmjet medhhebeve dhe sekteve”, e organizuar nga RABITA.

Ky edicion u konsideruar një hap domethënës në forcimin e unitetit islam. Fokusi i kësaj Konference ishte të shkonte përtej dialogëve të përsëritur dhe të përqendrohej në programet praktike për zbatimin e Kartës së ndërtimit të urave ndërmjet shkollave të mendimit islam dhe sekteve.

Në këtë Konferencë nga Bashkësia Islame e Kosovës, në emër të Myftiut Naim ef. Tërnavë, mori pjesë shefi i kabinetit të tij, mr. Besim ef. Mehemeti. Kjo Konferencë përreth vetes mbledhi më shumë se 500 delegatë, dijetarë të botës islame, liderë fetarë, myftinj, ministra dhe intelektualë nga më shumë se 90 shtete.

Në hapjen e Konferencës, pas leximit të Kuranit nga imami i Qabesë, Abdullah el Xhuheni, sekretari i Për-



gjithshëm i RABITA-s, dr. Muhamed Abdulkarim el Isa, në fjalën e tij, ndër të tjera tha:

“Ne, në Ligën Botërore Myslimane, vlerësojmë sponsorizimin dhe mikpritjen bujare nga Kujdestari i Dy Xhamive të Shenjta, mbretit Selman bin Abdulaziz al Saud. Jemi të nderuar të mirëpresim dijetarët kryesorë të ymetit, përfaqësues të të gjitha sekteve dhe shkollave islame, në vendin e shenjtë, te kibra e tyre universale, të vendosur së bashku – me ndihmën e Zotit – për të arritur aspiratat e

myslimanëve anembanë botës nga kjo ngjarje e jashtëzakonshme dhe unifikuese. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se rrugët negative të debateve sektare nuk e kufizuan tragjedinë vetëm tek autorët e tyre, por më tepër shkëndijat e tyre u shtrinë dhe dëmtuan Islamit dhe myslimanët në incidente të dhimbshme, të cilat historia i regjistroi në faqet e saj të errëta, siç e cek ajeti kuranor: “Dhe kini frikë nga një sprovë që nuk do t’i godasë ekskluzivisht ata që kanë bërë padrejtësi mes jush.” (Kuran, 8:25).

U MBAJT AKADEMI KUSHTUAR HOXHËS FEJZULLA EF. SALIHU

Këshilli i Bashkësisë Islame në Preshevë, në bashkëpunim me Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, organizoi një akademi përkujtimore solemne në nderim të jetës dhe veprimtarisë së hoxhës së nderuar, mulla Fejzulla ef. Salihu.

Aktiviteti, i titulluar “Drita e diturisë - trashëgimia e efendi Fejzulla Salihut - mulla Fejza”, kishte për qëllim nderimin e kontributit të tij të çmuar në fushën e dijes dhe edukatës islame.

Akademia u hap me leximin e një pjese nga Kurani famëlartë.

Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, fjalën përshëndetëse e mbajti z. Vedat ef. Sahiti, kryeimam i BIK-ut, i cili vlerësoi lart kontributin e mulla Fejzës në përhapjen e dijes dhe në mbrojtjen e trashëgimisë fetare. Ai theksoi se mulla Fejza përfaqësonte një brez hoxhallarësh që, përveç dijes, kultivonin edhe urtësinë, modestinë dhe përkushtimin ndaj komunitetit.



Panelistët që morën pjesë në këtë ngjarje ishin: Nexhmedin ef. Ademi, kryetar i Këshillit të BI-së në Preshevë, Ramadan Shkodra, përgjegjës për botime pranë BIK-ut, dhe Isuf Zimeri, teolog nga Maqedonia e Veriut. Ata sollën para të pranishmëve kujtime dhe dëshmi të gjalla mbi jetën dhe veprën e mulla Fejzës, duke e vënë në kontekstin e zhvillimeve fetare dhe kombëtare të kohës së tij.

Gjatë aktivitetit, Këshilli i Bashkësisë Islame ndau mirënjohje post mortum për mulla Fejzën, si dhe mirënjohje për kontributin e mulla Shenasi Fejzullahut, hzf. Nexhat Jasharit nga fshati Geraj dhe mulla Sadri ef. Rahimit nga fshati Strezoc.

Në përmbyllje të ngjarjes, u shtrua një iftar tradicional vëllazëror, për rreth 150 musafirë të ftuar.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS SHTRIOI IFTAR NË KRAJË



Më 22 mars 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në kuadër të aktiviteteve të muajit Ramazan, shtrioi iftar për besimtarët krajan. Në këtë iftar morën pjesë përfaqësuesit Kryesisë së BI-së, drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra dhe përgjegjësi për vakëfe, Abedin ef. Sadriu.

Pas iftarit, të gjithë të pranishmit falën namazin e taravisë, i cili u drejtua

nga hafëzi Sulejman ef. Bugari, nga Rahoveci dhe nga Abedin ef. Sadriu i cili mbajti një ligjëratë të shkurt për rëndësinë e 10 ditëve të fundit të muajit të agjërimit.

Drejtori Shkodra shprehu mirënjohje për mikpritjen e ngrohtë nga bashkëvëllezërit krajan.

“Falënderoj vëllezërit krajan që iu përgjigjën ftesës tonë për iftarin e përbashkët, të organizuar nga Kryesia

e BI të Kosovës. Kam për nder e respekt që t’ua përcjell selam dhe përshëndetjet Kryesisë së BI e posaçërisht të myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavi. Sonte për ne është një moment i veçantë, ngase në sofën e iftarit jemi me vëllezërit e motrat tona të trevës së Krajës. Kujdesi e mbështetja e BI të Kosovës për vëllezërit tanë të këtyre trevave dhe jo vetëm do të jetë e vazhdueshmë. E kemi për obligim që të kujdesemi e të mbështesim njëri-tjetrit. Falënderoj gjithashtu drejtuesit e Mexhllisit të Krajës, kryeimamin Irfan ef. Kaca dhe kryetarin Sali Doda, për mikpritjen e ngrohtë dhe vëllazërore. Po ashtu, një falënderim të veçantë i shkon imamit veteran Tahir ef. Kaca, një prej talebeve të parë të Medresesë së Prishtinës, që na nderoi me praninë e tij”, tha ai mes të tjerash.

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS SHTROI IFTAR NË ULQIN



Më 22 mars 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës shtroi iftarin tradicional në Ulqin për imamët shqiptarë të Ulqinit, Krajës, Anës së Malit, mutevelitë e xhamive dhe aktivistët e këtyre Mexhliseve të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Malit të Zi.

Delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës përbëhej nga kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti dhe dekani i FSI-së, Islam Hasani, të cilët u pritën nga zëvendësreisi Omer ef. Kajoshaj.

Fjalën përshëndetëse e mbajti zëvendësreisi Kajoshaj, i cili falënderoi nikoqirin e këtij iftari, ndërsa

kryeimami Sahiti theksoi vëllazërinë dhe bashkëpunimin mes Bashkësisë Islame.

Ai përcolli përshëndetjet e Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe theksoi se Bashkësia Islame e Kosovës do të vazhdojë bashkëpunimin me Meshihatit të Malit të Zi dhe do të jetë mbështetëse e organizimit fetar islam atje.

Në këtë iftar morën pjesë zëvendësreisi dr. Behlul ef. Kanaqi, kryetari i Kuvendit të BI-së në Mal të Zi, Isa ef. Aloshi, kryetari i Mexhllisit Blerim ef. Bajraktari, si dhe ai i Malësisë, Shemsudin Lulanaj, kryeimami Ali ef. Bardhi, kryeimami i Malësisë Xhevahir ef. Arifaj, imamë, profesorë dhe xhematlinj.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS SHTROI IFTAR NË BUJANOC



Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës shtroi iftarin tradicional në Bujanoc për imamët dhe besimtarët e asaj pjese.

Delegacioni i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës përbëhej nga kryeimami Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga dekani i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë prof. Islam Hasani.

Në fjalën e tij kryeimami Sahiti përcolli përshëndetjet e Myftiut Naim ef. Tërnavë, duke theksuar se Bashkësia Islame do të jetë aktivisht mbështetëse e organizimit fetar Islam në Luginë.

Të pranishmeve iu drejtua edhe kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Bujanocit, Sulejman ef. Fejzullahu i cili i falënderoi të gjithë për pjesëmarrjen.

Në iftar morën pjesë kryetari Bujanocit, z. Arbër Pajaziti, kryetarët dhe administratat e KBI-së, të Gjilanit dhe Kamenicës, imamë, zyrtarë të institucioneve komunale dhe qytetarë nga Bujanoci.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS SHTROI IFTAR NË MEDVEGJË

Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në iftarin tradicional të shtruar në Medvegjë, një ngjarje e rëndësishme për besimtarët e këtij rajoni. Ky iftar ka bashkuar myslimanët e Medvegjës, duke ofruar një mundësi për ta thelluar

frymën e unitetit dhe solidaritetit gjatë muajit të bekuar Ramazan.

Në fjalimin e tij, kryeimami Sahiti theksoi rëndësinë e përkushtimit ndaj vlerave të Ramazanit, si dhe nevojën për të ruajtur traditat dhe lidhjen shpirtërore me besimin dhe

komunitetin. Ai uroi besimtarët për pranim të ibadeteve, si dhe theksoi se iftari është një mundësi e shkëlqyer për të forcuar lidhjet ndërmjet njerëzve dhe për të kontribuar në ndihmën e atyre që kanë nevojë.



Në këtë ngjarje, morën pjesë besimtarë të kësaj ane dhe më gjerë, duke treguar mbështetje për aktivitete të tilla që promovojnë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin mes besimtarëve të rajonit. Iftari i shtruar në Medvegjë është një prej aktiviteteve që pasqyron vlerat e Ramazanit dhe angazhimin e komunitetit për të krijuar një atmosferë paqeje dhe harmoni.

VIZITA E DREJTORIT TË DIASPORËS TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS NË ZVICËR



Më 14 mars 2025, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga imami i xhamisë “Mati 1”, Fadil ef. Musliu, realizuan një vizitë në Zvicër. Namazin e xhumasë, Ekrem ef. Simnica e fali në xhaminë “Paqja” në Cyrih-Schwamendingen, tek imami Fahredin Bunjaku, ndërsa Fadil ef. Musliu, e fali në xhaminë e Bulachut, tek imami i përkohshëm, Ali ef. Berisha.

Pas namazit, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës u bashkuan për iftarin e përbashkët në Xhaminë

Shqiptare në Cyrih, e cila është xhamia e parë shqiptare në Zvicër. Ata u pritën nga imami Nebih ef. Rexhepi, kryetari, anëtarët e Kryesisë dhe xhemati i kësaj xhamie.

Përfaqësuesit e BIK-ut, para namazit të jacisë mbajtën gjithashtu ligjërata me këshilla dhe mësimë rreth dhjetëditëshit të fundit të muajit Ramazan.

Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në ligjëratën e tij, theksoi rëndësinë e punës dhe veprimtarisë së institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai përcolli urimet dhe për-

gëzimet e Myftiut Tërnavë për muajin Ramazan, duke lutur Allahun që t’ua pranojë ibadetet dhe adhurimet që besimtarët po kryejnë gjatë këtij muaji. Gjithashtu, drejtori Simnica falënderoi të gjithë mërgimtarët për kontributin e vazhdueshëm që ata japin për atdheun, veçanërisht për Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai shprehu shpresën dhe bindjen se kjo mërgatë do të vazhdojë të kontribuojë në të ardhmen, sa herë që të jetë nevoja.

VIZITA E DREJTORIT TË DIASPORËS NË BELGJIKË

Më 21 mars 2025, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga kryeimami i Këshillit të BI-së së Klinës, Blerim ef. Musliu, vizituan Belgjikën, ku morën pjesë në iftarin e organizuar nga Federata Myslimane Shqiptare në Belgjikë, e udhëhequr nga kryetari Tasin Ramadani, së



bashku me disa imamë dhe shoqërues të tij.

Namazin e teravisë, Ekrem ef. Simnica e fali në xhaminë “Besimi” në Bruksel, pranë imamet Nuhi ef. Shaqiri, ndërsa Blerim ef. Musliu në xhaminë e “Xhumasë”, me imamin Tasin ef. Ramadani. Përfaqësuesit e BIK-ut mbajtën nga një ligjëratë me këshilla për dhjetë ditët e fundit të Ramazanit para namazit të jacisë.

Ekrem ef. Simnica, në ligjëratën e tij, theksoi rëndësinë e punës së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe përcolli urimet

e Myftiut Tërnavë për Ramazan, duke lutur Allahun për pranim të ibadeteve.

Më 22 mars, delegacioni vizitoi xhaminë “El Albani” në Bruksel për namazin e drekës, ku u pritën nga imami Hysni ef. Berisha dhe xhemati. Ata u njohën me aktivitetet e qendrës dhe shprehën gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm.

Të shtunën, ekipi vazhdoi vizitën në qytetin Huy, ku morën pjesë në iftarin e përbashkët me xhematin dhe imamin Irfan ef. Idrizi. Para teravisë, u mbajtën ligjëratë ku u përcollën përshëndetjet

e Kryesisë dhe u falënderua xhemati për kontributin dhe blerjen e një parcele për ndërtimin e xhamisë së re.

Gjithashtu, delegacioni vizitoi Qendrën Islame “Haxhi Zeka” në Namur, ku u pritën nga kryetari mulla Musë Mulaj, imami Avni ef. Dobra dhe xhematlinjtë. Ata vizituan edhe parcelën e blerë për xhaminë e re. Drejtori Simnica uroi drejtuesit për këtë arritje dhe siguroi përkushtimin e BIK-ut për ruajtjen e bashkëpunimit me çdo qendër islame në diasporë.

VIZITA E DELEGACIONIT TË BIK-UT NË SHTETET SKANDINAVE



Nga data 20.03.2025 deri më 24.03.2025, një delegacion i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, në përbërje të mr. Vedat Shabani, sekretar i FSI-së, dhe mr. Hysni Beka, profesor në Medresenë e Mesme “Alauddin” realizuan një vizitë në shtetet skandinave.

Delegacioni fillimisht u ndal në qytetin e Drammenit në Norvegji. Aty falën namazin e xhumasë te hoxha, z. Faton Bytyqi, ku Hysni Beka mbajti

ligjëratë para namazit të xhumasë, ndërsa hytben e xhumasë e mbajti Vedat Shabani.

Gjatë kësaj vizite në Norvegji, delegacioni i BIK-ut, ditën e premte për namazin e teravive vizitoi xhematet e xhamive në qytetet Sarsborg, tek imami z. Ardian Haliti, dhe qytetin Halden, te imami z. Blerim Maliqi. Ndërsa ditën e shtunë, për namazin e ikindisë, vizituan xhematin e Qendrës Islame Kulturore të shqiptarëve të

Norvegjisë në Oslo, ku imam ishte z. Berat Hashani, kurse për namazin e teravive ishte te xhemati i hoxhës Sabri ef. Jonuzi, po ashtu në Oslo.

Ditën e diel, delegacioni i BIK-ut, për namazin e drekës ishte në qytetin e Borås-it të Suedisë, ku imam për muajin e Ramazanit ishte z. Faruk ef. Sinani. Ndërsa për namazin e teravisë, prof. Hysni Beka ishte në Malmö të Suedisë, ndërsa prof. Vedat Shabani ishte në Kopenhag të Danimarkës te xhemati i Bashkësisë Islame Shqiptare, ku imam ishte z. Basri Kurtishi.

Në të gjitha vizitat delegacioni i BIK-ut është pritur shumë mirë dhe në çdo takim ka mbajtur nga një ligjëratë rreth vlerës së muajit të Ramazanit, me fokus në dhjetë netëshin e fundit, dhe ka përcjell te xhematet falënderimet në emër të BIK-ut për kontributin e vazhdueshëm që ata japin për atdheun, veçanërisht për Bashkësinë Islame të Kosovës.

BASHKËSIA ISLAME DHURON 75 MIJË EURO PËR 500 JETIMË

Më 26 mars 2025, në prag të festës së Fitër Bajramit, Bashkësia Islame e Kosovës, ka ndërmarrë një aksion të çmuar humanitar, duke dhuruar 75 mijë euro për 500 jetimë në të gjithë Kosovën. Çdo fëmijë ka marrë nga 50 euro, një shenjë e dashurisë dhe kujdesit që BIK-u shtrton për ata që



kanë nevojë më shumë, sidomos gjatë muajit të bekuar Ramazan dhe pas tij.

Besim Mehmeti, shefi i Kabinetit të Myftiut Tërnavë, njëherësh edhe menaxher i Projektit, thekson se ky projekt synon mbështetje financiare për jetimët, me nga 50 euro për secilin fëmijë çdo muaj. Pagesat për tre muajt e parë janë realizuar më herët, ndërsa sot, në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit, janë ekzekutuar pagesat për muajt e ardhshëm.

“Ky është një moment i rëndësishëm, pasi sot janë transferuar mjetet për jetimët. Kjo shumë simbolike prej 50 eurosh është një shenjë e dashurisë që BIK-u ofron në këtë periudhë festive, e cila është më shumë se një ndihmë financiare; është një mesazh i shpresës dhe solidaritetit për ata që kanë humbur prindërit”, shprehet Mehmeti.

Ky aksion humanitar është një përpjekje për të lehtësuar jetën e fëmijëve jetimë, duke iu ofruar mbështetje

financiare në një kohë të rëndësishme, kur shpirti i solidaritetit dhe bamirësisë është më i fortë se kurrë.

Ndihma për jetimët është një aspekt thelbësor i solidaritetit që i jep jetë shpirtit të Ramazanit, dhe ky projekt është një dëshmi e angazhimit të BIK-ut për të ndihmuar ata që janë më në nevojë në shoqërinë tonë.

DEPARTAMENTI I TË RINJVE SHITROI IFTAR PËR TË RINJ



Më 25 mars 2025, Departamenti i të Rinjve i Bashkësisë Islame të Kosovës organizoi iftar me të rinj nga profile të ndryshme. Në të morën pjesë deputetë

të Parlamentit të Kosovës, kadetë të rinj pranë Akademisë ushtarake të Kosovës, përfaqësues të Parlamentit Studentor nga Universiteti i Prishtinës,

përfaqësues nga Këshilli i nxënësve të Kosovës, si dhe të ftuar të tjerë.

Fillimisht të pranishmit i përshëndeti udhëheqësi i Departamentit, Fejsal Spahiu, i cili tha se institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës duhet ta shohim të gjithë si pjesë tonën, ngase gjithnjë kemi ndarë të njëjtin fat së bashku me popullin.

Me nga një fjalë përshëndetëse, të pranishmëve iu drejtuan edhe deputetët Valon Ramadani dhe Fitim Haziri, të cilët premtuan angazhim më të madh për t’iu ndihmuar të rinjve në realizimin e kërkesave të tyre.

600 DHURATA PËR FËMIJËT E PRISHTINËS



Në ambientet e Medresës “Alaud-din” në Prishtinë, Departamenti i Gruas pranë Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës organizoi shpërndarjen e dhuratave për 600 fëmijë që ndjekin mësimet fetare tek mualimet e këtij Këshilli. Kjo ngjarje u zhvillua në

kuadër të aktiviteteve edukativo-fetare me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit, duke sjellë një atmosferë të veçantë festive dhe shpirtërore për fëmijët.

Fëmijët u mbushën me gëzim dhe entuziazëm kur morën dhuratat, duke

shijuar çdo moment të surprizës me buzëqeshje në fytyrë dhe falënderime të sinqerta për organizatorët. Ky aktivitet përçoi një mesazh të dashurisë, solidaritetit dhe përkujdesjes për më të vegjëlit në komunitet.



Shoqata Humanitare Bamirëse "BEREQETI"
PËRMbledhje e Aktiviteteve
TË REALIZUARA GJATË RAMAZANIT 2025

21,350

Pako ushqimore

36,366

Iftare

29,089 euro

Para të gatshme

19950 kg

Mish

13,350 Persona
Veshmbathje

234,550 kg
Miell

2

Shtëpi të renovuara

1900 kg

Patate

2

Banesa

9,940

Dhurata për fëmijë

6300 kg

Qepë

8 Hapje

e puseve (bunarëve)

100

Ëmbëlsia (torte)

40 ton

Hurma

DITURIA ISLAME • Nr. 413 PRILL 2025